



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.2.2022, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Jorida Tabaku – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë me pyetjet e dëshmitarëve:

Ariola Kodra - Administratore e Inceneratorit Integrated Energy BV SPV

Viola Haxhiademi – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Loran Dusha - Administrator i Inceneratorit “Integrated Technology Waste Treatment Fier” (*Dëshmia jepet Online*)

Florian Muçaj – Ish-anëtar i Komisionit të Prokurimit të Inceneratorit të Fierit

Valbona Ballgjini – Ish-anëtare e Komisionit të Prokurimit të Inceneratorit të Tiranës.

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Antoneta Dhima, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Eduard Shalsi, Besion Ajazi, Etjen Xhafaj, Edmond Spaho, Dhurata Tyli (Çupi), Lefter Gështenja, Luçiano Boçi, Helidon Bushati, Ina Zhupa dhe Denis Deliu.

Mungojnë:

Ermonela Valikaj (Felaj) dhe Belind Këlliçi.

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Faleminderit për rikthimin në mbledhjen e komisionit hetimor për inceneratorët!

Rendin e ditës së sotme e kemi miratuar bashkërisht më parë dhe është njoftuar që në mbledhjen e fundit. Seanca fillon me zonjën Arjola Kodra, që duhet të vinte këtu në orën 9:00. Të gjithë e dëgjuan dëshminë e zonjës Kodra, së cilës iu komunikuar prezenca sot dhe kërkesa për disa dokumente shtesë. Megjithëse kemi 20 minuta që e presim, zonja Kodra nuk është paraqitur në komision. I kërkoj stafit të komisionit të vendosemi në kontakt me të, ta rithërrasim edhe njëherë në drekë dhe në qoftë se nuk paraqitet sërish, për zonjën Kodra do të marrim të njëjtat masa si për zotin Dusha, do të njoftojmë shërbimet e Policisë së Shtetit për ta sjellë këtu me forcë.

Zonja Arjola Kodra në dëshminë e saj solli disa fakte të rëndësishme, por për faktet e tjera kishte një amnezi të përkohshme. Ne hpresuam që pas 5 ditë reflektimesh, zonjës Kodra mund t'i kthehej memoria.

Kemi marrë, ndërkohë, fakte të tjera shtesë. Dua të informoj publikun që pas njoftimit për të bërë kallëzime për personat që nuk sjellin informacione, ne kemi një fluks të jashtëzakonshëm informacionesh, që sigurisht do t'i përdorim.

Njëkohësisht, e ripërsëris kërkesën e zotit Artan Rama, për të dëshmuar në këtë komision. Zoti Rama ka disa ditë që vjen në komision për të dëshmuar dhe shpresoj që Partia Socialiste të ketë reflektuar. E ripërsëris kërkesën për zotin Artan Rama.

Në orën 10:00 do të vijë sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, zonja Vjola Haxhiademi.

Në orën 12:00 do të lidhemi me administratorin e Fierit, zotin Loran Dusha.

Ndërkohë, në orën 12:00 -13:00 kemi dy përfaqësues të Komisionit të Koncesioneve, zotin Florian Muçaj dhe zonjën Valbona Ballgjini.

Do të kisha dëshirë që të procedonim sa më shpejt me dëshmitë.

Do t'u kërkoj gjithashtu të gjithë kolegëve, duke qenë se ne do të fillojmë me një grup personash, të cilët kanë edhe funksione publike, por njëkohësisht edhe funksione politike, që e kanë agjendën pak më të ngarkuar se dëshmitarët e parë, të koncentrojnë pyetjet dhe të mos

humbin kohën e dëshmitarëve, që ndoshta mund ta kenë kohën më të kufizuar se grupi i parë i dëshmitarëve.

U kërkoj edhe një herë kolegëve të Partisë Socialiste dhe i rikujtoj ata për prezencën e tyre gjatë dëshmisë së zotit Artan Rama. Unë do të kisha dëshirë që ta dëgjonim brenda ditës së sotme.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit!

Po e nis nga kjo e fundit, ju e dini që unë kam paraqitur një kërkesë për ta shqyrtuar këtë çështje në Këshillin për Rregulloren. Kërkesën e kemi paraqitur në këtë Këshill, i cili duhet të mbledhet dhe të vendosim se çfarë duhet të bëjmë për zotin Rama.

Jorida Tabaku - Pa kaluar te pika tjetër, do të doja t'ju bëja një pyetje: a e keni dorëzuar kërkesën me shkrim?

Arben Pëllumbi – Kërkesën me shkrim duhet ta bëjmë këtu në komision. Unë e kam bërë në seancë kërkesën.

Jorida Tabaku - Çdo kërkesë dërgohet me shkrim, ashtu siç na keni thënë ne në momente që kemi bërë kërkesa këtu në seancë, ju na keni thënë: “Bëjeni kërkesën me shkrim”. Për shembull, zonjës Arjola Kodra ne i kërkuam një sërë dokumentesh dhe prezencën e saj, pas kërkesës suaj që duhet ta bënim me shkrim këtë gjë.

Arben Pëllumbi – Atëherë, do ta bëjmë me shkrim këtë gjë.

Jorida Tabaku – Zoti Pëllumbi, keni humbur dy ditë me këtë! Ju lutem, t'i themi stafit që të procedojë më shpejt që të mos krijojmë ngërçe!

Arben Pëllumbi – Dakord!

E dyta, më bëri përshtypje kjo që thatë në lidhje me fluksin e dokumenteve. Unë nuk besoj se asnjë nga institucionet e Shqipërisë nuk ka frikë apo nuk trembet nga puna që bëjmë ne këtu. Sigurisht, kur ne drejtojmë disa kërkesa në një kohë të caktuar, ka një periudhë kur ato dokumente përgatiten dhe nisen kërkesat për një ditë. Është e natyrshme që në një periudhë të caktuar kohe do të vijnë përgjigjet e tyre. Mund të qëllojë që të vijnë të gjitha përgjigjet në një ditë, por kjo nuk do të thotë se qenkan trembur nga ajo që ne paskemi artikuluar këtu. Nuk e shikoj kështu dhe s'kemi pse ta trajtojmë si të tillë.

Për sa i përket zonjës Arjola Kodra, mendoj se ajo e dha dëshminë e saj, ka qëndruar këtu rreth dy orë e gjysmë, sigurisht ne i kemi kërkuar të rivijë sot bashkë me disa nga dokumentet,

edhe shkresa përkatëse nga komisioni besoj se i është dorëzuar zonjës Kodra. Megjithatë nuk më duket që mosprezenca e saj ka të bëjë me ndonjë arsye që s'do të vijë, sepse nuk do të kishte ardhur që herën e parë nëse do të ishte kështu. Ajo e dha dy orë e gjysmë dëshmi, ndoshta ka ndonjë moskuptim, kështu që do të insistoja që shërbimet e këtij komisioni të mund të vazhdonin kontaktin me zonjën, që ta kishim prezent edhe atë sot brenda ditës, sepse edhe ne kemi interes që të ridiskutojmë me disa të dhëna të tjera, për të cilat jemi vënë në dijeni pas dëshmisë që ajo ka dhënë në këtë komision.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Ka dikush nga kolegët diçka procedurale për të thënë? Unë, për shembull, jam vendosur në dijeni të shumë fakteve të reja të lidhjes së zonjës Arjola Kodra me pronarët e inceneratorit për lidhjet e hershme të biznesit me ta, për të cilët ajo në këtë komision, nuk po them se gënjeu, se ndoshta është akuzë e rëndë, ajo është juriste dhe e di mirë implikimin ligjor që mund të ketë dëshmia e saj, por tha të pavërteta në këtë komision, nuk i raportoi komisionit të vërtetat, ndërkohë që ne jemi duke pritur ende informacionin për pjesën financiare të kompanisë.

Unë do t'i kërkoja stafit të komisionit të vendosemi në kontakt me dëshmitaren e dytën, zonjën Vjola Haxhiademi, që të procedojmë sa më shpejt.

Sapo zonja të vijë do të mblidhemi në komision sërish. Ju siguroj që, ashtu siç vepruam herën e kaluar, pavarësisht çdo pengese, çdo problemi që mund të dalë, dhe ju tregoj angazhimin e plotë për t'i shkuar deri në fund dëshmive me dëshmitarët, siç e kemi planifikuar.

Bëjmë pak pushim, sa të vijë dëshmitari i dytë.

I kërkoj stafit të komisionit të nisin një shkresë tjetër për zonjën Arjola Kodra, në të kundërt, në drekë, po ju informoj, do të kërkoj ndihmën e Policisë së Shtetit që të sjellë me forcë zonjën Kodra në komision.

Faleminderit!

(Pas pushimit.)

Të nderuar kolegë, rifillojmë mbledhjen.

Në seancën e radhës kemi thirrur zonjën Viola Haxhiademi, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

E falënderoj zonjën për disponibilitetin, që erdhi pak më herët!

Dua t'ju kujtoj se zonja është sekretare e Përgjithshme i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe ndoshta ka agjendë të ngarkuar gjatë ditës, kështu që ju lutem, t'i koncentrojmë pyetjet dhe të jemi efektivë.

Zoti Boçi, ka kërkuar fjalën për procedurë dhe pastaj do të fillojmë direkt.

Luçiano Boçi – Dje ka pasur një protestë të punonjësve të inceneratorit të Elbasanit për shkak të mungesës së marrjes së pagave prej dy muajsh. Nga informacionet, protesta vazhdon edhe sot. Punonjësit kanë paraqitur para medieve, që censurohen një pjesë e tyre, fakte tronditëse që në inceneratorin e Elbasanit, krahas mbetjeve të tjera, që janë brenda parametrave të grumbullimit apo depozitimit, ka edhe mbetje spitalore dhe mbetje të tjera të rrezikshme.

Meqenëse ne e kemi për objekt hetimi mënyrën e funksionimit të këtij inceneratori, unë propozoj të bëjmë një vizitë tjetër si komision pranë tij, brenda afatit të mundshëm, të kontaktojmë edhe punonjësit dhe ndoshta të bisedojmë edhe për problematikat e tjera që ka ky incenerator në administrim dhe që ka pasur më parë.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Boçi!

Edhe unë ndaj shqetësimin tuaj. Në fakt, ne e pyetëm administratorin, zotin Arapi, për likuiditetin financiar dhe ai na konfirmoi që llogaritë janë zbrazur dhe nuk ka më asnjë fond në inceneratorin e Elbasanit.

Fatkeqësisht, është një situatë që ne e kishim paralajmëruar në këtë komision, që erdhi në vëmendjen tonë, pasi ishte prezent kryetari i bashkisë, që mund ta kishim diskutuar me të.

Gjithsesi, faleminderit që e ngritët si çështje!

Zoti Pëllumbi, për procedurë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, meqenëse u hap kjo temë, dua që t'i sqarojmë realisht disa gjëra, që të jenë të qarta edhe për publikun, por edhe për ata punonjësit atje.

Sot impianti i trajtimit të mbetjeve në qarkun e Elbasanit është në sekuestro preventive nga Gjykata e Posaçme, që do të thotë se nuk mund të kryejë asnjë aktivitet ekonomik, blerje, shitje dhe pagesa. Që nga ajo datë inceneratori është i fikur për këtë arsye, sepse nuk prokuron dot materialet ndihmëse për vazhdimin normal të punës. Jo, sepse nuk është në gjendje pune; jo, sepse nuk funksionon, por, sepse nuk prokuron dot materialet ndihmëse.

Besoj se kjo është edhe arsyeja që punonjësit e atij inceneratori nuk po paguhen.

Ndaj, kërkoj, (sigurisht nuk mund të imponojmë organin e akuzës, se ata e dinë vetë), në rast se ai ka mundësi të çlirohet, që të vazhdojë procedura e marrjes në pronësi nga shoqata që është ndërtuar për ta administruar atë, në mënyrë që të zhblokohet si çështja e trajtimit të mbetjeve në të gjithë qarkun e Elbasanit, ashtu edhe pagesat, detyrimet, të ardhurat dhe pagat e punonjësve.

Nuk shikoj arsye të rishkojmë aje. Në rast se ka një problematikë për mbetjet që trajtomë, ka organe përkatëse të specializuara që merren me atë punë. Nuk na takon ne të hyjmë në landfillin e mbetjeve, që të shohim se çfarë lloj mbetjesh hidhen në atë shesh.

Në rast tjetër, nëpërmjet këtij komisioni apo nëpërmjet një shkrese zyrtare, si ta gjykoni të arsyeshme, t'u drejtohem organeve përkatëse të na japin një përgjigje zyrtare nëse ka apo jo mbetje, që nuk duhet të jenë në atë landfill.

Jorida Tabaku – Unë nuk dua të harxhojmë kohën e zonjës me këtë çështje, dhe u kërkoj kolegëve, nëse kemi mundësi, ta rishohim. Zoti Boçi ngriti këtu një shqetësim shumë të drejtë, sepse kemi pasur këtu zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të inceneratorit, që kanë konfirmuar se kontrata zbatohet ashtu siç ishte vetëm me llojin e mbetjeve të përcaktuara në kontratë. Në qoftë se atje trajtohen mbetje spitalore, pa një leje jashtë objektit të kontratës, sigurisht që kjo është një shkelje shumë e rëndë, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, është edhe një kundërthënie në dëshminë e kryetarit të Bashkisë së Elbasanit.

Ju kërkoj ndjesë kolegë, por unë nuk dua të harxhojmë kohën e zonjës me debatet tona!

Kërkesën e zotit Boçi do ta ribëjmë. Le të fokusohemi te zonja, tani.

Arben Pëllumbi – Flet një nga kolegët, sigurisht flasim edhe ne, pastaj flisni dhe ju e kështu bëhemi dy ju, një ne. Fjala e fundit ngelet gjithmonë ajo juaja dhe kjo nuk është e drejtë. Ndaj në rast se...

Jorida Tabaku – E di zoti Pëllumbi, por nuk është e drejtë edhe që ne jemi në opozitë, edhe që flet Kryetarja e Kuvendit, por kështu janë ndarë këto gjëra!

Kaq hapësirë na kanë dhënë.

Arben Pëllumbi – Në rast se në atë impiant të trajtimit të mbetjeve depozitohen mbetje jashtë objektit të atij impianti, organet përkatëse të veprojnë. Ai impiant e ka të përcaktuar se çfarë mbetjesh do të trajtojë dhe si do t'i trajtojë. Impianti ka funksionuar deri ditën që është vënë nën sekuestro nga gjykata dhe ditën që gjykata do ta lirojë, do të rifillojë procedura e

marrjes në dorëzim nga bashkia dhe konsorciumi i bashkive dhe impianti do të rivihet në punë. Sa më shpejt të ndodhë kjo, aq më shpejt do të zgjidhen proceset.

Jorida Tabaku – Ta mbyllim këtë çështjen ose do të vazhdoj të flas edhe unë.

Zonja Haxhiademi, faleminderit, për disponibilitetin!

Fillojmë me dëshminë e zonjës. Zonja Haxhiademi, dua t’ju kujtoj se, sipas rregullores së brendshme të këtij komisioni, dëshmia juaj do të merret pas kryerjes së betimit. Betimi bëhet sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale dhe dua t’ju kujtoj që po sipas këtij neni, dëshmia e rremë dënohet deri në 6 vjet nga organet kompetente.

Ju lutem, përsërisni pas meje:

“Betohe se do të them të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë!

Betohe!”

Viola Haxhiademi – “Betohe!”.

Jorida Tabaku – Zonjë, a mund të bëni një prezantim të shkurtër të pozicionit tuaj aktual dhe çfarë përfaqësoni?

Viola Haxhiademi – Unë jam sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Mbjaj këtë pozicion që nga korriku i vitit 2019 dhe prej asaj periudhe deri më sot vijoj të jem në këtë pozicion.

Jorida Tabaku – Në cilin pozicion keni qenë më parë?

Viola Haxhiademi – Nga janari deri në korrik kam mbajtur detyrën e drejtorit të kabinetit po në Ministrinë e Infrastrukturës dhe më parë kam qenë drejtore administrative në Albkontroll.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Ju jeni emëruar në këtë detyrë nga titullari i institucionit, nga zonja ministre, nga sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë?

Viola Haxhiademi – Jam emëruar në këtë detyrë nëpërmjet një procesi konkurrues nga DAP-i si sekretare e Përgjithshme në ministri.

Jorida Tabaku – Ne kemi një komision hetimor për çështjen e inceneratorëve që nga viti 2017, me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, autoritet kontraktues është Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës.

Ju jeni zyrtari autorizues për Ministrinë e Energjetikës dhe Infrastrukturës dhe autorizoni të gjitha pagesat për çdolloj kontrate apo shërbimi të ministrisë. Autoriteti kontraktues ka, njëkohësisht, komunikim dhe marrëdhënie me koncesionarët. Koncesionarët e Fierit dhe i Tiranës, në mënyrë specifike, janë në procedurë hetimi nga ky komision.

A keni pasur komunikime me përfaqësues të koncesionarit që nga momenti i emërimit në detyrën tuaj deri më sot?

Viola Haxhiademi – Ne kemi pasur komunikime zyrtare institucionale me IZP-në, dua t’ju sqaroj se NJZP-ja është e njohur, edhe sipas kontratave koncesionare, edhe sipas ligjit për koncesionet, si strukturë e deleguar, e cila ndjek procesin e monitorimit të kontratave.

Jorida Tabaku – Ju lutem, a mund të na e thoni gjatë se çfarë është NJZP-ja?

Viola Haxhiademi – NJZP-ja është Njësia e Zbatimit të Projektit, e përcaktuar si e tillë edhe në kontratat koncesionare, që ju keni si objekt hetimi, ashtu edhe në ligjin për koncesionet.

Në këto 3 kontrata është NJZP shumë komplekse për nga kompleksiteti në vetvete edhe i veprave që ngrihen. Ka në përbërje të saj përfaqësues të Ministrisë Mjedisit, bashkive respektive dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Të gjitha komunikimet që kemi me NJZP-në janë institucionale, shkresore dhe zyrtare. Janë ata që mbajnë kontaktet me kompanitë dhe me supervizorin e kompanisë. Ne, në komunikimet e tyre vihemi në dijeni edhe kur kompania na drejtohet, vë patjetër në dijeni edhe NJZP në qoftë se ka një korrespondencë të tillë.

Jorida Tabaku – Pagesat i autorizoni ju, apo jo?

Viola Haxhiademi – Po.

Jorida Tabaku – A ka përgatitur institucioni juaj raporte monitorimi, raportet periodike, raportet të tjera në lidhje me zbatimin e kontratave koncesionare?

Viola Haxhiademi – Sipas përcaktimeve të kontratës, raportet periodike përgatiten si nga supervizori i kontratës, të cilët janë kompani supervizimi dhe kanë për detyrë dhe mbajnë përgjegjësi ligjore dhe profesionale për monitorimin e tyre dhe firmosjen e situacioneve dhe konfirmimin e punimeve të kryera në terren, ashtu sikundër nga NJZP-ja.

Këto janë dy shkallë hallka para se të mbërrijë në ministri verifikimi i punëve, detyrave apo i ndjekjes së kontratës.

Patjetër që është raportuar në mënyrë të vazhdueshme, sipas përcaktimeve të kontraktuale, si nga supervizori ashtu edhe nga NJZP-ja, raporte dhe memo, të cilat i janë bashkëlidhur secilës pagesë që ne ia kemi drejtuar thesarit për të kryer.

Jorida Tabaku – Përveç kësaj, neni 10, pika 5, ligji thotë: “Brenda 6- mujorit të parë të çdo viti autoriteti kontraktues dërgon në Ministrinë e Financave pasqyrat përgjegjëse vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të njësive koncesionare”.

Viola Haxhiademi – Janë dorëzuar nga koncesionari dhe i janë përcjellë Ministrisë së Financave sipas përcaktimeve. Besoj se një kopje të bilanceve ua kemi sjellë me shkresë zyrtare.

Jorida Tabaku – Unë i kam analizuar bilancet dhe ky ishte pikërisht shqetësimi që po ju drejtohem me këto pyetje. A jeni ju në dijeni të raporteve të KLSH-së të vitit 2019 dhe 2021, ky i fundit është raport paraprak, që është i vendosur në dijeni këtij komisioni. Shqetësimi është që të dyja raportet, ai i vitit 2019 dhe ai i vitit 2021 ngrenë shkelje shumë të rënda për koncesionarin nga pikëpamja e zbatimit të kontratës dhe nga pikëpamja e pagesave, por, nga ana tjetër, edhe të investimeve që duhet të bëjë koncesionari.

Viola Haxhiademi – Raporti i vitit 2019, në mos gaboj, nuk është i drejtpërdrejtë me Ministrinë e Infrastrukturës. Janë raporte që i janë drejtuar AKUM-it dhe Ministrisë së Financave. Ndërkohë, raporti i vitit 2021 është një drafraport përputhshmërie i bërë në Ministrinë e Infrastrukturës për inceneratorin e Tiranës, që ka ngritur disa shqetësime. Ne kemi bërë objeksione, si ne ashtu, edhe institucionet e tjera që janë audituar nga KLSH-ja dhe jemi në pritje të raportit përfundimtar.

Patjetër që me mbërritjen e raportit përfundimtar, do të marrim të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve që KLSH-ja ka vënë në dispozicion.

Jorida Tabaku – A jeni në dijeni të raportit të performancës së kontratave të koncesionit të PPP-së të vitit 2020 të Ministrisë së Financave?

Viola Haxhiademi – Jo!

Jorida Tabaku – Sipas këtij raporti, që unë e kam cituar disa herë në komision, kompania koncesionare në mënyrë specifike e Tiranës, që ka një formulë tjetër financimi ndryshe nga Fieri dhe Elbasani, nuk e ka zbatuar planin e biznesit. Vlera private e investimit për projektin në vitin e parë duhet të ishte 5,6 miliardë dhe është 1,1 miliardë; në vitin e dytë duhet të ishte 5,9 miliardë është 526; në vitin e tretë është 2,9 miliardë dhe është në masën 80%, por në të dyja vitet e para është në masën 20% dhe më pas 8% të zbatimit të investimit të privatit në shoqërinë koncesionare. Pra, kushtet e kontratës sipas këtij raporti monitorimi nuk janë zbatuar. Jeni në dijeni të këtij raporti?

Viola Haxhiademi – Nuk jam në dijeni të këtij raporti dhe nuk di cilës periudhë i referoheni me “viti i parë, viti i dytë” në inceneratorin e Tiranës.

Jorida Tabaku – Nuk i referohem unë! Po ju citoj një raport, ku i referohet Ministria e Financave bazuar në kontratën që keni në zbatim.

Viola Haxhiademi –Kontratës së Tiranës, thatë?

Jorida Tabaku – Po, të Tiranës, sepse dy të tjerat kanë një *fee* koncesionare që nuk kanë nevojë t’u monitorohet investimi i privatit. Në këtë rast është ndryshe.

Viola Haxhiademi – Siç jua bëra me dije, të gjitha strukturat, të gjitha punët, monitorimet, grafiku i punimeve dhe investimet ndiqen nga dy hallka të tjera para se të mbërrijnë në autoritetin kontraktor ose struktura menaxhuese, që janë supervizori, i cili ka përgjegjësi ligjore dhe profesionale ndjekjen e grafikut të punimeve dhe njoftimin për rregullim të shkeljeve, qoftë në drejtim të kontraktorit, qoftë në drejtim të autoritetit kontraktor për risqet, të cilat mund të parashikohen dhe mund të vijnë nga kjo.

Në dijeninë time, nuk jemi bërë me dije për ndonjë problematikë, por...

Jorida Tabaku – Ndjesë, se nuk do të doja t’ju ndërprisja!

Janë tri raporte të ndryshme, një i Ministrisë së Financave dhe dy të KLSH-së, që bëjnë fjalë për shkelje të rënda të koncesionarit. Keni objeksione për raportin e KLSH-së ia dërgoni dhe ka një procedurë tjetër.

Raporti i Ministrisë së Financave është një orientues për ju për zbatimin e kontratës dhe vendosjen e gjobave. Ne kishim këtu përfaqësues të koncesionarit, i cili na tha se nuk kemi marrë ndonjëherë gjobë, megjithëse nuk është zbatuar kontrata. Kontrata ka penalitete të rënda për sa i përket zbatimit të saj nga pikëpamja e investimeve, këtu po fokusohem tek investimi, pastaj të vazhdojmë me pjesën e shpenzimeve.

Viola Haxhiademi – Nuk po kuptoj se cilit raport i referoheni? Nëse i referoheni raportit...

Jorida Tabaku – I referohemi raportit vjetor të përmbledhur, “Performanca kombëtare e kontratave të koncesionit”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, viti 2020.

Viola Haxhiademi - Patjetër që në lidhje me inceneratorin e Tiranës është bërë një kërkesë për rishikim të zërave të punimeve dhe rregullimin e grafikut të punimeve, e konfirmuar nga supervizori i kontratës, e konfirmuar nga NJZP-ja dhe e miratuar prej tyre, pa shtyrë afatin e ndërtimit, këtë dua ta theksoj. Nëse afati i ndërtimit në kontratë ka qenë i parashikuar...

Jorida Tabaku - Unë nuk kam dijeni për ndryshimin e zërave. Kur është bërë ndryshimi i zërave?

Viola Haxhiademi - Në vitin 2021.

Jorida Tabaku - Unë i referohem raportit të vitit 2020. Ai nuk ka fuqi prapavepruese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Denaj, kur t'ju thërras për të dëshmuar, mund të flisni.

Nuk ka fuqi prapavepruese. Raporti mund të ndryshojë shpenzimet për periudhat në vijim, por nuk mund ndryshon dot faktin e asaj që ka ndodhur. Pyetja ime është: a i keni vendosur gjoba dhe penalitete koncesionarit që nuk e ka zbatuar kontratën me planin e investimit? A është në dijeninë tuaj si përfaqësuese?

Viola Haxhiademi – Në dijeninë time jo. Nuk i janë vendosur, sepse edhe llogaritja e gjobave në momentin që merret informacioni, u përcillet strukturave, të cilat e monitorojnë. Është e pamundur nga ana ime të llogaris se cila është gjoba, sepse janë strukturat që e monitorojnë, që japin ditët e vonesave, ku ka probleme me grafikun e punimeve për të bërë llogaritjen e saktë dhe për t'i siguruar koncesionarit gjobën dhe penalitetin, që do t'i vendoset atij për shkeljet e evidentuara.

Jorida Tabaku – Përveç rolit që ka Njësia e Zbatimit të Projektit, është detyrë e autoritetit kontraktues zbatimi kontratës. Pavarësisht mënyrës si propozohet dhe kush jua sjell ju, përgjegjësinë në fund të ditës e mbani ju që hidhni firmën për shpenzimet, ju që miratoni shpenzimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Denaj, ju lutem, me gjithë respektin maksimal që kam për ju, nëse keni gjë për të dëshmuar, unë ju thërras për të dëshmuar. Nuk ka fare intimidim.

Unë kam këtu buxhetin e shtetit, kam buxhetin e koncesioneve. Autoriteti përgjegjës për pagesat e ndërtimit të landfillit, inceneratorin, rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ Bashkia Tiranë. Pagesat nga buxheti i shtetit dalin nga institucioni i juaj.

Viola Haxhiademi - Dua t'ju korrigjoj, pasi dalin nga Bashkia e Tiranës. Tarifat paguhen prej tyre, institucioni ynë është institucioni transit, që i mban ato në nivelet e tavaneve buxhetore, transit për të kaluar nga buxheti i shtetit. Nuk bëhet asnjë pagesë nga institucioni, nga Ministria e Infrastrukturës për inceneratorin e Tiranës, asnjë.

Jorida Tabaku – Dakord. Edhe unë e kam të qartë dhe e di si funksionon, por për qëllimet e ligjit jeni autoritet kontraktues dhe buxheti në tavane është përgjegjësi e ministrisë suaj, ashtu siç është paraqitur të paktën në ligjin “Për buxhetin e shtetit”.

Viola Haxhiademi - Dua t’ju qartësoj: është mbështetje për Bashkinë e Tiranës për pagesat që bashkia bën për menaxhimin dhe përpunimin e mbetjeve. Nuk është pagesë për inceneratorin apo për ndërtimin e inceneratorit. Më lini t’ju sqaroj se Tirana është ndryshe nga kontratat e lidhura të Fierit dhe të Elbasanit. Besoj se ju jeni në dijeni që Elbasani dhe Fieri janë PPP, kurse Tirana është koncesion.

Jorida Tabaku – E përmenda, unë e di që ju keni shumë informacion që doni ta ndani, por të mos përsërisim. Besoj se të gjithë anëtarët e komisionit jeni të qartë besoj për këtë pjesë. Sa monitorime dhe inspektime keni bërë në objekt si autoritet kontraktues?

Viola Haxhiademi - Ne si autoritet asnjë, sepse është e pamundur, por patjetër nga ana e NJZP-së kryen inspektime të vazhdueshme. NJZP-ja, përveç se mblidhet çdo muaj, raporti që dorëzohet në autoritetin nënkontraktor, është i shoqëruar me detajet të punimeve të kryera gjatë asaj periudhe dhe me foto, të cilat vërtetojnë punimet e kryera. Këto janë raportet e monitorimit që dorëzohen muaj për muaj nga NJZP-ja.

Jorida Tabaku - Si pjesë e raportit të KLSH-së, por njëkohësisht edhe analizës dhe bilanceve të dorëzuara nga kompania janë vënë re një sërë shkeljesh të jashtëzakonshme. Në bilancin e dorëzuar në vitin 2019 për inceneratorin e Fierit janë 20 milionë euro për punime të përcaktuara, pra janë punime të përcaktuara, është e deklaruar në bilanc. Në bilancin e inceneratorit të Tiranës janë paraqitur shpenzime pa fund. Ju ka vënë në dijeni edhe KLSH-ja për nënkontraktimet. Pra, janë pothuajse 21 milionë euro nënkontraktime vetëm për kompanitë e zotit Klodian Zoto, nga 35 milionë euro të paguara nëpërmjet institucionit tuaj, tavaneve buxhetore, por të ekzekutuara nga Bashkia e Tiranës. Ka një masë të raportimit të shpenzimeve operative me investimet në masën 60-65 % në favor të shpenzimeve operative, krahas shpenzimeve për investime në të dy inceneratorët, por tek inceneratori Tirana është ende më e theksuar.

Ju, a keni pasur dijeni për të gjitha këto shkelje të rënda që kanë ndodhur nga pikëpamja financiare për inceneratorët?

Viola Haxhiademi - Ne jemi struktura, të cilat përcjellim bilancin pranë Ministrisë së Financave për të bërë këtë lloj auditit. Nuk futemi në detaje të auditit të bilanceve, të cilat janë të

përfunduara, të mbyllura, të dorëzuara në takime të certifikuar nga ekspertë kontabël dhe ua përcjellim strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre. Ju siguroj se ajo që depozitohet tek autoriteti kontraktor janë vetëm situacione, të cilat janë situacione punimesh, të konfirmuara, flas këtu për Fierin, sepse Elbasani ka qenë i mbyllur, pra dorëzohen vetëm situacione të konfirmuara, të mbyllura vetëm për volume punimesh, të sipas një grafiku të përcaktuar dhe të miratuar më parë. Nëse ka dalje nga grafiku, patjetër që jemi në faza aplikimesh të penalteteve.

Jorida Tabaku – Në inceneratorin e Fierit Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorja e Hetimit Tatimor kanë ndërmarrë një hetim, ku është vënë re një grup faturash fiktive për efekt të TVSH-së fiktive. A është vënë në dijeni Ministria e Infrastrukturës për këtë hetim, i cili ka qenë publik, informacioni ka qenë publik, edhe ne e kemi marrë vesh nga media?

Viola Haxhiademi- Nuk kam asnjë informacion, unë e kam dëgjuar nga media, siç e keni dëgjuar edhe ju, por unë nuk kam asnjë informacion.

Jorida Tabaku- Nuk mban përgjegjësi institucioni juaj për kryerjen e pagesave për kompani fiktive, për kompani të cilat nuk kryejnë realisht punime?

Viola Haxhiademi - Mbajnë përgjegjësi ligjore personat, të cilët certifikojnë bilancet dhe kontrollojnë punimet. Nuk mundet të mbajë autoriteti kontraktor përgjegjësi për shpenzimet, të cilat kruhen nga autoriteti kontraktor, të cilat nuk janë objekt i kontratës e cila monitorohet.

Jorida Tabaku - Janë objekt i kontratës, janë pjesë e objektit të kontratës, ligji e ka të përcaktuar çfarë përgjegjësish ka autoriteti kontraktues. Janë pjesë e funksionit tuaj si zyrtar autorizues, si nëpunës autorizues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës. Këtu po flasim se është bërë pastrim parash me fondet publike. Kjo është akuza që ka ngritur SPAK-u, dhe nuk është një akuzë që është ngritur nga ne, nuk mban përgjegjësi autoriteti kontraktues për pastrimin e parave që është bërë me kompani fiktive me fondet e buxhetit të shtetit?

Viola Haxhiademi - Nuk di t'ju them, nuk më duket se është ky rasti për sa kohë unë ndjek pjesën e situacioneve të punimeve, po jua përsëris edhe një herë, të cilat dorëzohen të firmosura nga të tëra strukturat, nga supervizori, që mban përgjegjësi ligjore pikërisht për këtë dhe unë merrem me pjesën e ndërtimit. Këtë ka marrë përsipër shteti për të paguar investimin dhe ajo më dorëzohet me situacionet, me faturat tatimore dhe për këtë përgjigjem. Unë nuk di aktivitetin që bën shoqëria jashtë këtyre punimeve të kryera.

Jorida Tabaku - Po në rastin e Fierit që është thënë se është dhënë pagesa për punime të pakryera, e thotë vetëm buxheti, ju e keni përcjellë vetë bilancin e kompanisë.

Viola Haxhiademi - Po jua përsëris edhe një herë, mua më dorëzohen situacione të punimeve të kryera, nuk kam në asnjë moment një situacion, i cili të thotë që kjo është vlera e punimeve

Jorida Tabaku – Po nuk ka situacion Fieri, po them, për tre vjet nuk është ndërtuar në Fier, në bilanci që ju i keni përcjellë Ministrisë së Financave e kanë deklaruar vetë 20 milionë euro punime të pakryera, punime të mbartura për vitin tjetër, ky është bilanc i dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit që i ka ardhur këtij komisioni zyrtarisht.

Viola Haxhiademi - Nuk e di se çfarë ka bilanci dhe po jua them prapë.

Jorida Tabaku – Si janë bërë pagesat pa pasur situacione, kur ju na deklaroni që bëhen gjithmonë mbi situacione?

Viola Haxhiademi - Ju lutem, mos keqinterpretoni. Po ju them që situacione ka dhe janë të dorëzuara, janë të certifikuara, të firmosura nga persona dhe struktura që janë përgjegjëse për certifikimin dhe ndjekjen e punimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ja ta përfundoj unë e me shumë kënaqësi do t'ju jap fjalën.

Kam edhe dy pyetje për zonjën.

Detyra e autoritetit kontraktues është gjithmonë njoftimi në rastin e ndryshimit të pronësisë së kontratës koncensionare, në koncensionin përkatës, për të cilin neve po flasim, ka ndodhur dy herë ndryshimi i pronësisë, në rastin e inceneratorit të Fierit kompania italiane, që ka marrë pronësinë, ia ka shitur asaj një javë më pas njoftimit të fituesit për kontratën koncensionare kompanisë “Ndërtim Montim Patos”, në dijeninë tuaj a ka një njoftim për transferimin e aksioneve dhe të pronësisë?

Viola Haxhiademi – Nuk kam dijeni për këtë, ka ndodhur përpara se të hyja, e kam dëgjuar si fakt, por nuk kam asnjë koment.

Jorida Tabaku – Po për ndryshimin e aksioneve që kanë ndodhur në datën 14.02.2022, që është regjistruar në QKB?

Viola Haxhiademi – Jeni duke folur për 3 ditë përpara ?

Jorida Tabaku – Me 14.02.2022 është bërë një ndryshim në Qendrën Kombëtare të Biznesit i aksioneve në emër të kompanive të regjistruara janë shfaqur 3 aksionerë italianë. Qëllimi i këtij komisioni është të kuptojmë kush janë investitorët fundorë? A keni dhënë një miratim paraprak për ndryshimin e aksioneve nga një kompani në tjetrën ?

Viola Haxhiademi – Jo.

Jorida Tabaku – Nuk keni dhënë asnjë ndryshim ?

Viola Haxhiademi – Jo.

Jorida Tabaku – Nuk ka asnjë miratim ndryshimi?

Viola Haxhiademi – Nuk ka asnjë kërkesë për ndryshim të aksionerëve.

Jorida Tabaku – Atëherë, nuk është në dijeninë tuaj se si kanë ndryshuar aksionerët e kompanisë pak ditë më parë ?

Viola Haxhiademi – Jo.

Jorida Tabaku – Pyetja e fundit që kam unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo e ka radhën një koleg nga maxhoranca.

Pagesat për inceneratorin e Fierit vazhdojnë, inceneratori i Fierit është kapur me shkelje të rëndë tashmë nga pikëpamja procedurale, por dhe nga pikëpamja e zbatimit. Unë kam konsultuar të gjithë legjislacionin, kam parë raste të ngjashme, kam dëgjuar edhe përgjigjen e ministres përgjegjëse për institucionin tuaj, që qeveria shqiptare ka frikë se do të shkojë në Arbitrazh nëse kjo ndodh. Kemi konsultuar tri raste të tjera të ngjashme, asnjë kompani, ku në thelb procedura është korruptive dhe është gjykuar korruptive nga një organ, siç është rasti i SPAK-ut, nuk ka të drejtë koncensionari ta çojë në arbitrazh, kjo është e para.

Elementi i dytë është: në momentin e hartimit të kontratës institucioni i Avokatit të Shtetit u ka dërguar të gjithë palëve, përfshirë edhe institucionin tuaj, sugjerime në lidhje me shkelje të rënda të kontratës, ndërkohë që kontrata është miratuar ashtu siç ishte, pa asnjë ndryshim absolutisht. Avokati i Shteti, unë e kam shkresën këtu, e lexova edhe kur ishte drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, sugjeron që kontrata është diskriminuese, në favor të koncensionarit, në dëm të shtetit, së pari, dhe, së dyti, duhet t'i jepet për gjykim një gjykate këtu, në Shqipëri dhe jo në rastin e arbitrazhit. Këto nuk janë marrë parasysh në hartimin e kontratës, e cila në fund të ditës është miratuar nga autoriteti kontraktuesi i atëhershëm, jo juaji, por ka pasur përfaqësues të institucionit tuaj.

Shqetësimi është se në momentin që është vërtetuar se inceneratori i Fierit është pastrim parash, nuk është vepër penale të vazhdoni dhe të bëni pagesa për një vepër penale ?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Viola Haxhiademi – Në lidhje me komentet e Avokaturës së Shtetit, të them të drejtën, nuk jam në dijeni të kaq detajeve, patjetër mund të jenë ngritur komente nga institucione të ndryshme për t’u reflektuar në kontratë. Në momentin që unë kam filluar kontratat i kam gjetur të lidhura dhe në zbatim e sipër, kështu që nuk di të bëj komente lidhur me këtë çështje.

Jorida Tabaku – Për çështjen e pagesave të inceneratorit të Fierit.

Viola Haxhiademi – Për çështjen e pagesave, po i kthehem pjesës së parë, më falni. Për çështjet e pagesave të inceneratorit, pagesa e fundit e kryer është diku në dhjetor. Kontrata parashikon detyrimin për të kryer të gjitha pagesat e mundshme, Fieri aktualisht, në dijeninë time, shoqëria me të cilën kemi kontratën nuk është e sekuestruar.

Jorida Tabaku – Nuk është e sekuestruar, por është në hetim, ka një akuzë për pastrim parash.

Viola Haxhiademi – Është nën hetim dhe, në dijeninë time, nëse nuk gabohe, është sekuestruar njëri prej aksionarëve, të paktën që ka qenë më parë i shoqërisë dhe që ka maxhorancën në aksione. Kështu që, unë besoj se tani është në kontroll.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Më lini ta përfundoj, mos i ngatërroi juve, po kur ta bësh ti, do ta bëj unë.

Faleminderit!

Doktorin kemi në tjetër në parti, të lutem, zonja Haxhiademi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Viola Haxhiademi – Çështja është nën hetim, nuk është se ka një vendim final.

Jorida Tabaku – Por aksioneri është vendosur në sekuestro për akuzën e pastrimit të parave.

Viola Haxhiademi – Që do të thotë se shteti, në dijeninë time, ka kontroll në aksionet dhe në të gjitha pagesat tashmë, që bëhen për këtë kontratë. Kjo do të thotë që jemi në kushte shumë më të favorshme se sa në kushtet e mëparshme.

Jorida Tabaku – Unë nuk kam më pyetje, pastaj do t’ia jap fjalën zonjës Denaj dhe pastaj zotit Bushati.

E ka kërkuar që në fillim zonja Denaj, patjetër me radhë.

Zonja Denaj, keni pyetje apo për procedurë.

Anila Denaj – Zonja kryetare, unë ju ftoj, si kolege, ta drejtoni sot seancën me shumë qetësi dhe të mos bëni asnjë anëtarë të komisionit të ndihet sikur është duke bërë faj kur komenton me kolegun. Ju keni përgjegjësinë për të drejtuar komisionin, por jo të ngrini zërin apo të fyeni, këtë e kemi përsëritur disa herë, meqenëse është fillimi i një seance dhe i shumë ditëve të tjera më mbrapa, ju a kërkojmë përsëri, të jeni në krye të këtij komisioni, por me respekt ndaj të gjithëve.

Së dyti, pyetjen për zonjën Haxhiademi e lidh në vijim të atyre pyetjeve që ju parashtuat. Dua të më citoni një nen të një ligji që ju bën përgjegjës si autoritet kontraktor për bilanciçet që një kompani depoziton në QKB dhe cili është ky ligj apo neni përkatës.

Viola Haxhiademi – Nuk jam në dijeni të asnjë neni apo ligji, e vetmja gjë që bëhet, jemi struktura përcjellëse pranë strukturave përgjegjëse të bilanceve të tyre, nuk kemi asnjë autoritet verifikimi apo kontrolli.

Anila Denaj – Cili është ai nen i atij ligji që ju bën përgjegjës për ndryshimin e aksionerëve brenda një shoqërie?

Viola Haxhiademi – Nuk ka asnjë gjë të përcaktuar, nëse është e shkruar në kontratë për njohjen e aksionerëve, patjetër që është detyrë e koncensionarit, i cili duhet të depozitojë kërkesën dhe të marrë miratimin, sipas përcaktimeve kontraktuale.

Anila Denaj – A jeni ju përgjegjës për të bërë pagesa sipas situacioneve ?

Viola Haxhiademi – Jam përgjegjëse për të bërë pagesa sipas situacioneve dhe përcaktimeve kontraktuale, sepse në rastin tonë, për shembull, Fieri, puna paguhet me këste, sepse jemi në rast PPP, jo në një rast kontrate ndërtimi.

Anila Denaj – Nëse nuk do të ishin kryer këto pagesa sipas situacioneve, do të ekzistonte objekti që ne pamë në Fier?

Viola Haxhiademi – Nuk do të kishte objekt nëse nuk do të bëheshin pagesat, dhe janë detyrime që do t'i përmbushim.

Anila Denaj – Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Bushati pastaj zoti Xhafaj.

Helidon Bushati – Atëherë, zonja Haxhiademi, ju thatë diçka që nuk është thënë më përpara në këtë komision, thatë se Tirana është koncesion, ndërsa Fieri dhe Elbasani janë PPP, kjo nuk është e vërtetë. Pse e thatë këtë gjë?

Viola Haxhiademi – E thashë këtë gjë, sepse nëse Fieri dhe Tirana kontratat janë lidhur për të mbuluar shpenzimet e ndërtimit dhe investimit nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve kontraktuale për Elbasanin 21,600 në total pa TVSH ndërsa për Fierin 27,500 e diçka milionë euro pa TVSH, për Tiranën buxheti i shtetit nuk paguan për ndërtimin, paguan vetëm bashkitë respektive për përpunimin e tyre pranë inceneratorit.

Helidon Bushati – Të nderuar kolegë, përsëri ju thatë diçka të vërtetë, por që nuk është thënë asnjëherë më përpara, që buxheti i shtetit ka mbuluar ndërtimin e inceneratorit, do të thotë ndërtimi është bërë me paratë e shtetit dhe jo me paratë e privatit, edhe kjo është një risi.

Jo, ju jeni në rregull nga ana formale dhe efektive.

Jorida Tabaku - Të gjithë kolegët ta ulin pak zërin, sepse nuk dëgjohet asgjë.

Zonja do të përgjigjet dhe juve do të pyesni.

Viola Haxhiademi – Saktësoj për Elbasanin dhe për Fierin, Tirana është ndryshe, këtë dua ta ndaj.

Helidon Bushati – Atëherë, nga ana profesionale jeni shumë e saktë, janë dhënë lekë, pra me lekët e buxhetit të shtetit është bërë ndërtimi i inceneratorit të Elbasanit dhe të Fierit, do të thotë koncensionari nuk ka paguar asgjë.

Atëherë, zonja Haxhiademi, besoj se nga eksperiencia juaj dhe shumicës së kolegëve këtu, është qartësisht e dukshme që ju po thoni një diçka që nuk është thënë fare më përpara, shumë e saktë, që ishte dashur të bëhej një prokurim publik, të kishte konkurrence, të hidheshin 21 milionë lekë të qytetarëve për t'u prokuruar, të fitonte kompania me çmimin më të ulët dhe jo të bëhej një koncension i fshehur me negociim, pa shpallje, në rastin e Elbasanit, me procedurë super të përshpejtuar dhe me problematika procedurale si në Elbasan, si dhe në Fier me një konkurrues të vetëm.

Ju falënderoj jeni shumë e saktë nga ana profesionale.

Viola Haxhiademi – Mund ta saktësoj pak të lutem se çfarë ndodh me PPP-në përkundrejt një kontrate prokurimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është i njëjti ligj.

Jorida Tabaku – Ju lutem, zonja Dhima, ju lutem, të përfundojnë përgjigjet e zotit Bushati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, dakord të thotë se unë nuk kam asnjë përgjegjësi, nuk kam qenë në atë pozicion, po lëre të përgjigjet vetë, të lutem.

Zoti Xhafaj, të lutem!

Helidon Bushati – Atëherë, edhe një sqarim për zonjën Dhima, pa dashur të replikojmë, kur vijnë drejtues institucionesh, si në rastin e zonjës Haxhiademi, me përjashtim të rasteve kur vjen për t'u pyetur për një vendimmarrje individuale në kuadër të një komisioni që ka shkuar individualisht, për sa kohë vjen si sekretare e përgjithshme e një ministrie, vjen në kuadër të ministrisë dhe mban përgjegjësi jo përgjegjësi, në fakt, po do të thosha për memorie historike dhe të përgjigjet se çfarë parashikon institucioni që ajo përfaqëson edhe kur ajo nuk ka qenë në pozicionin që është sot, për të qenë të qartë në këtë pikë. Pra, për sa kohë që nuk është individualisht...

(Diskutime pa mikrofon)

...vetëm për vendime individuale...

(Diskutime pa mikrofon)

Pyetja tjetër, zonja Haxhiademi. Ju e dini që në kontratë ka një nen, është faktikisht në çdo kontratë koncesionare, ku presupozohet që njëra nga kompanitë ka edhe ekspertizën e duhur e të tjera, kur ndryshon pronësia e kompanisë. A duhet një miratim paraprak nga autoriteti kontraktor?

Viola Haxhiademi – Kjo varet nga përcaktimet kontraktuale, ka nga ato që janë vetëm me njoftim, ka përcaktime në të cilat thuhet që po duhet të marrësh miratim, kështu që varet nga përcaktimi i nenit në kontratën që është lidhur me autoritetin kontraktor.

Helidon Bushati – Pa dyshim në kontratën për të cilën po bëhet fjalë, për të cilën ju drejtua edhe kryetarja e komisionit, është pikë kontraktuale, ekspertët do të tregojnë pikën kontraktuale, pika 16 (1, 2 dhe 3), e cila parashikon qartë që duhet të merret miratim paraprak nga autoriteti kontraktor që në këtë rast jeni ju.

Viola Haxhiademi – Siç jua bëra me dije, nuk jam në dijeni të një kërkesë nga koncesionari për ndryshimin e aksionerëve për të ndjekur dhe për të dhënë miratimin e ndryshimeve.

Helidon Bushati – Zonja Haxhiademi, ju si drejtuese e lartë e ministrisë, e dini që në momentin që ka një detyrim kontraktual për të marrë miratimin nga autoriteti kontraktor, të cilin

e përfaqësoni ju sot, ai miratim merret paraprakisht, jo aposteriori po merret apriorori, para se të bëhej ndryshimi i pronësisë, apo jo?

Viola Haxhiademi – Kjo është e vërtetë, por për sa kohë nuk kam dijeni për këtë çështje nuk mund t'ju them gjë. Patjetër që duhej të merrej paraprakisht, nëse është një përcaktim kontraktual, nëse janë bërë shkelje absolutisht të vazhdojnë dhe ta...

Helidon Bushati – Shumë e saktë.

IZP-ja, pra njësia e zbatimit të projektit, ju na e shpjeguat qartësisht që ka një përbërje nga institucione të ndryshme, në varësi të cilës ministri është?

Viola Haxhiademi – IZP-ja është krijuar fillimisht në përcaktimin kontraktual nga Ministria e Mjedisit dhe me transferimin e menaxhimit të kontratave në Ministrinë e Infrastrukturës me një urdhër të përbashkët në fund të vitit 2017 dhe në fillim të vitit 2018 është bërë dorëzimi i kopjeve të dokumentacioneve që dispononte Ministria e Mjedisit, duke i kaluar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Helidon Bushati – Domethënë në linjë hierarkike varet nga ju në vetvete?

Viola Haxhiademi – Në këto kushte...

Helidon Bushati – Në kushte ligjore jemi.

Një pyetje tjetër.

(Diskutim pa mikrofon)

Në kuptimin kur varet nga ana institucionale, pavarësisht se ka një përbërje me përfaqësues të ministrive të tjera padyshim që raporton tek titullari i ministrisë nga e cila varet, kjo është ideja, aq më tepër që me të drejtë ky institucion është edhe autoriteti kontraktor. Pra, të gjitha raportet 3-mujore të supervisorit dhe raportet 3-mujore të koncesionarit që sjellin problematikat dhe zgjidhjet e mundshme nga ana e supervisorit padyshim janë në dijeni të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës, apo jo?

Viola Haxhiademi – Janë të dorëzuara në ministri për secilën prej kontratave koncesionare.

Helidon Bushati – Ju i keni mundësitë dhe duhet të keni një informacion mbi zhvillimin e punimeve.

Viola Haxhiademi – Raportet janë shumë voluminoze, unë marr vetëm një përmbledhje të raporteve mbi problematikat dhe informohen në lidhje nëse strukturat përgjegjëse për

monitorimin e kontratës kanë evidentuar problematika apo kanë lënë detyra për ndjekje për koncesionarin.

Helidon Bushati – Një pyetje tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Haxhiademi, te raporti i KLSH-së është një pikë në të cilën thuhet: nuk është arritur dakordësia mes Ministrisë së Energjetikës dhe koncesionarit për sa i përket çmimit. A jeni në dijeni të kësaj problematike të ngritur nga KLSH-ja?

Viola Haxhiademi – Cilës kontratë i referoheni? Raportit të cilit viti dhe për çmimin e cilit?

Helidon Bushati – Atëherë, në qoftë se nuk gaboju është viti 2019 për inceneratorin e Fierit.

Viola Haxhiademi – Inceneratorin e Fierit e kam gjetur me një kontratë të lidhur dhe nuk ka çmim. Depozitimi i mbetjeve për Elbasanin dhe për Fierin bëhet jo përkundëjt pagesës. Qarqet depozitojnë, supozohet që kontrata parashikon që nuk ka pagesë apo tarifë depozitimi, kështu që nuk e di se për çfarë çmimi i referohet KLSH-ja në këtë raport.

(Diskutime pa mikrofon)

Ka çmim?

Ju kërkoj falje!

Ky diskutim ka nisur me inceneratorin e Elbasanit, i cili normalisht i ka përfunduar punimet në vitin 2016 dhe po në të njëjtin vit është certifikuar dhe licencuar për prodhimin e energjisë, ndërsa sot që jemi duke folur nuk kemi një çmim të përcaktuar për prodhimin e energjisë. Ka pasur një korrespondencë me ERE-n dhe diku nga tetori i vitit 2020 jemi vënë në dijeni të një vendimi të shkallës së parë të Gjykatës së Tiranës me ekzekutim të menjëhershëm, ku palë ka qenë kompania koncesionare e Elbasanit dhe ERE, për detyrimin e ERE-s për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike.

Sot, ERE ende nuk ka një çmim të përcaktuar për energjinë elektrike. Shkresa e fundit me të cilën i jemi drejtuar për të nxjerrë çmimin ka qenë diku në tetor të vitit 2021, sepse ishte fundi dhe po vinte momenti i dorëzimit në bashkinë e Elbasanit dhe në këtë mënyrë nxjerrja e çmimit ishte emergjente.

Helidon Bushati – A jeni në dijeni, në cilësinë që keni në pozicionin drejtues të Ministrisë së Energjetikës, për ndonjë vendim të marrë nga kjo ministri, urdhër ministri, vendim

apo inicim të një VKM-je të bërë ekzekutive sa i përket impiantit të prodhimit të energjisë elektrike në Elbasan? Çfarëdolloj gjëje të keni, vendim, urdhër ministri apo inicim të ndonjë VKM-je, në çfarëdolloj kohe, për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike në Elbasan.

Viola Haxhiademi – Jam në dijeni që impianti është i licencuar nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave të vitit 2016, mos ma kërkoni numrin se nuk do të jem e saktë, por është i miratuar me VKM.

Helidon Bushati – Në Republikën e Shqipërisë licencimet bëhen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). A mund të më...

Viola Haxhiademi – Është kontratë e lidhur. VKM-ja ka miratuar kontratën e lidhur për prodhimin e energjisë. Licencimi, patjetër që bëhet nga ERE, por ata kanë lidhur një kontratë dhe kanë ndjekur procedurat për njohjen dhe për ta bërë gati prodhimin e energjisë, pra për ta njohur si prodhues energjie.

Helidon Bushati – Kjo kontratë e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për çfarë bën fjalë, zonja Haxhiademi?

Viola Haxhiademi – Në dijeninë time kontrata i referohet, është pandashmërisht e lidhur me kontratën e Elbasanit për përpunimin e mbetjeve. Po t'i referoheni VKM-së, diku në fillim të saj specifikisht shprehet që kjo VKM dhe kontratë po lidhet në funksion të kontratës së inceneratorëve të Elbasanit për përpunimin e mbetjeve.

Helidon Bushati – Zonja Haxhiademi, ndoshta nuk jeni eksperte e energjetikës, por unë po ju them që është Enti Rregullator i Energjisë që licencon. Nëse ju mund të më jepni një rast të dytë ku një vendim i Këshillit të Ministrave licencon një prodhues energjie, do të isha shumë i gatshëm ta shikoja.

Viola Haxhiademi – Nuk dua të bëhet ngatërresë e fjalëve dhe të keqinterpretohen. Vendimi i Këshillit të Ministrave ka miratuar kontratën për prodhimin e energjisë elektrike. Kompetencat që ka ERE për pjesën e licencimit është një institucion i pavarur dhe patjetër mbeten të sajat për t'i ndjekur procedurat e veta.

Në kohën kur është miratuar me VKM, nëse nuk gaboju unë, ligji që ka qenë në fuqi parashikonte që kontratat për prodhimin e energjisë miratoheshin nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave dhe si e tillë kontrata e prodhimin e energjisë ka kaluar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Helidon Bushati – VKM-ja që ju i referoheni, faktikisht, është që me VKM jepet licenca për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë me fuqi të instaluar mbi 2 mega. Besoj se është vendimi nr. 822, apo jo?

Viola Haxhiademi – Vendimi nr. 822 bazohet mbi 2 mega dhe ka procedurat, por VKM-ja është miratuar në vitin 2016 apo kontrata që jemi duke folur.

Helidon Bushati – Jo. Ky dokument është një risi dhe besoj se do të protokollohet dhe do të mbahet shënim, po ashtu edhe kryetarja ka vëmendjen e duhur që në fund t’ju kërkojmë që këtë kontratë të lidhur t’ia vini në dispozicion këtij komisioni, sepse nuk e kemi si dokument deri më sot.

Viola Haxhiademi – Patjetër.

Helidon Bushati – Jo kontratën koncesionare, ne duam të vini në dispozicion të këtij komisioni kontratën që sapo deklaruar me të cilën Këshilli i Ministrave ka ratifikuar një kontratë me kohëzgjatje të caktuar, siç e parashikon kontrata (ky komision do ta shohë tashmë), edhe vendimin e Këshillit të Ministrave edhe kontratën ta kemi nga ana protokollare!

Në qoftë se keni familjaritet, pse e them që keni familjaritet? E them këtë, sepse problemi i inceneratorëve, punimet e këtij komisioni tashmë po ndiqen dhe kanë një lloj vizibiliteti, aq më tepër nga ana e institucioneve që janë të involvuara në hapa të ndryshëm proceduralë të kontratave koncesionare. Kontrata e ratifikuar me vendim të Këshillit të Ministrave çfarë kohëzgjatjeje ka?

Viola Haxhiademi – Në dijeni time, 25-vjeçare, këtë e kam dëgjuar edhe nga diskutimet që ju keni bërë në komision, duke iu referuar afatit 25-vjeçar. A mund t’ju sqaroj pak në lidhje me këtë çështje?

Referuar VKM-së, më duhet t’ju them që VKM-ja përcakton që kjo kontratë, e cila është e miratuar me VKM...

(Diskutime pa mikrofon)

...parashikon diku në fillim të saj, tani nuk e kam përpara, por mund edhe t’jua citoj, dhe e lidh ngushtësisht me kontratën e Elbasanit, e cila është për prodhim energjie dhe në objektin e saj ka edhe prodhimin e energjisë. Kur flasim për 25-vjeçarin e prodhimit të energjisë, licencohet apo i jepet e drejta ndërtimit, do të thotë që inceneratori i ndërtuar për prodhimin e energjisë ka 25 vjet kohë për prodhim energjie dhe lidh këtë lloj kontrate.

Kjo nuk është e lidhur me shoqërinë që e ka ndërtuar, prandaj i referohem VKM-së për energjinë e lidhur ngushtësisht me kontratën e koncesionit të Elbasanit. Në momentin e transferimit, proces, i cili filloi, por u ndalua për arsye të sekuestrues nga SPAK-u, patjetër që në transferimin e aseteve, kur flasim për asete transferohen jo vetëm godinat, pajisjet, por transferohen të gjitha të drejtat dhe licencat, si dhe të drejtat për ndërtimin dhe prodhimin e energjisë janë të drejta të transferueshme tek ai që do ta zotëronte objektin në vetvete në vijim. Ky proces nuk përfundoi në mënyrë që edhe ne të përfundonim dhe të kryenim rregullimet e nevojshme për kalimin e kësaj të drejte pranë shoqërisë që është krijuar nga bashkimi i bashkive.

Helidon Bushati – Zonja Haxhiademi, me të drejtë ju përmendët fjalën kontratë. Çdo kontratë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë ka dy palë. A mund të më tregoni se cilat janë dy palët e kësaj kontrate?

Viola Haxhiademi – Saktësisht ju iu referuat dhe thatë se ajo që është miratuar me VKM është për ndërtimin. Shoqëria, e cila ka marrë kontratën...

(Diskutime pa mikrofon)

Patjetër.

... ishte shoqëria që mori përsipër ta ndërtonte inceneratorin dhe e ndërtoi inceneratorin, në vitin 2016 ishte në përfundim të tij. Arsyeja pse kontrata e miratuar me VKM u lidh me shoqërinë kaloi, sepse ishte pikërisht shoqëria, e cila do ta shfrytëzonte deri në fund, pra deri sa të bënte dorëzimet, që i bie të ishte fundi i vitit 2021. Në momentin që do të transferoheshin asetet, së bashku me impiantin e prodhimit të energjisë do të transferoheshin edhe të drejtat që kishte fituar shoqëria gjatë ndërtimit të këtij impianti. Kur flas për prodhimin e energjisë, e kam fjalën edhe për licencat e tjera të mundshme që ajo mund të ketë marrë nga kompani të tjera për përpunimin e mbetjeve, sepse mund të kenë përfituar edhe licenca të tjera. Të gjitha këto janë të transferueshme tek aksioneri i ri i shoqërisë dhe i objektit të ndërtuar.

Helidon Bushati – Çdo objekt që është ndërtuar për të prodhuar energji licencohet nga ERE dhe ka një dokument apo një vendimmarrje të ERE-s për inceneratorin e Elbasanit me një kohëzgjatje 25 vjet dhe për sa kohë e ka dhënë ERE-ja, është absolutisht ajo që thoni ju, por për sa kohë e ka dhënë ERE, është licencë për prodhim energjie të atij impianti, kushdo qoftë pronari. Në momentin që është nënshkruar një kontratë me ndërtuesin, sepse, siç e thatë edhe ju me të drejtë, është bërë me paratë e shtetit, dhe me zbatuesin e punimeve, nënshkruhet një kontratë me zbatuesin e punimeve, ku jepet e drejta për ta zgjatur afatin, sepse ajo kontratë është

dhënë vetëm për impiantin e prodhimit të energjisë dhe e keni lidhur jo ju, por ministria dhe autoriteti kontraktor. E kanë lidhur me dashje 25 vjet me atë kompani që nesër, në rastin më të keq për kompaninë, të shkoj në arbitrazh dhe t’i marrë të gjithë fitimin e munguar shtetit. Në VKM-në nr. 822 thuhet qartë: “Jepet licencë nga Këshilli i Ministrave vetëm për ndërtimin”, ndërkohë që atë vit impianti ishte në ndërtim e sipër apo ishte i ndërtuar.

Pra, kjo kontratë është dhënë me qëllimin që fitimet e kompanisë private, të koncesionarit privat të vazhdonin t’i vinin edhe për 25 vjetët e ardhshëm.

Viola Haxhiademi – Unë besoj se ju sqarova aq sa kisha dijeni. Në lidhje me këtë nuk kam më komente. Unë besoj se kjo është situata dhe besoj se jua sqarova se si e shohim, si dhe masat që kemi marrë për ndryshimin dhe nxjerrjen e çmimit diku nga muaji tetor, sepse ishte e rëndësishme për ne, pasi do ta merrte bashkia.

Helidon Bushati – Zonja Haxhiademi, personalisht ju falënderoj, sepse keni qenë shumë e vlefshme për këtë komision, duke na sjellë të dhëna mjaft interesante!

Etjen Xhafaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj edhe sekretaren e Përgjithshme!

Sa i takon pjesës së pyetjeve, kisha një pikë për procedurën, por në fakt zonja iu përgjigj. Pyetja kishte të bënte me licencën për prodhimin e energjisë për koncesionarin apo për impiantin. Do të doja me shumë përlësi t’ju ftoja të gjithëve që të kemi parasysh kontekstin në këtë komision, qoftë atij kohor, ligjor apo që ka lidhje me kompetencat e çdo institucioni ku ne kemi respektuar ekspertizën e çdokujt në këtë komision nga të dyja krahët. Nëse duam të kemi një aspekt teknik, atëherë hajdeni të marrim njerëz që të flasin për çdo aspekt teknik, por nëse do të kemi parasysh madhësinë e një institucioni të tillë, ne mund t’i kërkojmë sekretarit të Përgjithshëm specifikimet teknike të proceseve...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju, te pyetjet tuaja ishit më të thelluar seç isha unë në pyetjet e mia, sepse unë i kisha më të përgjithshme, por më duhet t’ju them se ne nuk mund të pretendojmë këtë gjë nga çdo dëshmitar, madje do të ishte pak e rrezikshme nëse do t’i vëmë të gjithë para përgjegjësive të të gjitha kontratave. Këtë e them edhe për një arsye shumë specifike, sepse arsyeja pse këto gjëra janë ndarë në kohë është edhe arsyeja që nga ndryshimet të mos rrimë e t’i rikthehemi çdo gjëje nga e para dhe të jemi ende duke shqyrtuar kontratat para 30 vjetëve. E njëjta ministri, që zonja

përfaqëson, është edhe ministria që ka firmosur kontratën e Rrugës së Kombit dhe nuk mund ta pyesim për atë, por kjo është një pjesë e saj.

Unë do t'ju thosha që nga ana procedurale, nëse ne duhet të flasim për atë kohë, do të kishte edhe gjëra të tjera. Kryetarja ngriti këtu disa pika, por do të doja që ekstraktin e QKB-së ta ndanit edhe me mua, sepse nuk e disponoj, t'ju them të drejtën, megjithatë do ta kontrolloj sapo të mbarojnë pyetjet me dëshmitarin. Nëse ne themi që autoriteti kontraktor në bazë të një vendimi të hetimit tatimor do të duhet të mbajë një qëndrim, mendoj se këto janë marrëdhënie të ndryshme, sepse për kontratat ne të tërë jemi të qartë se u bë goxha kohë që po flasim për to, janë komplekse dhe secili institucion ka pjesën e tij. Institucioni për të cilin po flasim tani nuk mund të jetë përgjegjës edhe për pjesën e prokurorisë, edhe për pjesën e hetimit tatimor, edhe për marrëdhëniet...

(Diskutime pa mikrofon)

Po jua përmend unë, sepse u përmend hetimi tatimor që ka dhënë një gjobë dhe informacioni i hetimit tatimor merret dhe zbatohet nga të tjera instanca. Në qoftë se pyesim sa kontrata koncesionesh menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, atëherë duhet të kemi parasysh që jo çdo shkresë që kalon me të gjitha këto kompani, të cilat kanë koncesione apo punë publike, mund të merret aty.

(Diskutim pa mikrofon)

Dakord, unë një sugjerim po ju bëj, i nderuar koleg, meqë ju dëgjova...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, është për të dyja palët!

Sugjerimet tona duhet të jenë pjesë e raportit dhe ne për këtë jemi, por jo për të gjitha institucionet përballë dëshmitarëve, sepse nuk janë të gjithë fajtorë për të gjitha.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka kërkuar zonja Zhupa.

Më pas fjalën e ka zonja Dhima.

Ina Zhupa – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju deklaruar këtu që sa i përket inceneratorit të Tiranës ka pasur ndryshime në grafikun e punime që ju ua keni pranuar. Kush i ka bërë këto ndryshime, i ka bërë vetë koncesionari dhe ju ia keni marrë të mirëqena apo ka qenë një bashkëpunim ndërmjet jush dhe atyre?

Viola Haxhiademi – Ndryshimet në grafikun e punimeve patjetër që kërkohen nga koncesionari dhe miratohen nga supervizori, i cili shikon, kontrollon dhe propozon, pra është struktura, e cila propozon ndryshimet. Pas kësaj miratohen nga NJZP-ja, e cila nëse bie dakord apo dakordësojnë dhe negociojnë kur flasim jo për shtyrje të afatit të ndërtimit, mbetemi brenda afatit 5-vjeçar, por ndryshojnë zërat brenda për brenda. NJZP-ja i ka pranuar këto ndryshime dhe i ka miratuar nga viti 2020. Arsyet kanë qenë COVID-i, vonesat në ndërtim dhe pandemia. Ky ka qenë arsyetimi.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Ju sapo pranuat një gjë të kundërt me atë që na ka thënë administratorja. Pra, ju thoni nuk ka shtyrje të afatit të ndërtimit të inceneratorit, a është korrekte kjo?

Viola Haxhiademi – Jam korrekte dhe i qëndroj deri në fund. Kam dokumentin zyrtar. Pra, ndërtimi fillon pas marrjes dhe zbardhjes së lejes së ndërtimit dhe përfundon pas 5 vjetësh.

Ina Zhupa – Që nga dita e fillimit të punimeve sipas kontratës, apo jo?

Viola Haxhiademi – Fillimi i punimeve supozohet është dita kur merret leja e ndërtimit. Leja e ndërtimit është zbardhur më 2020-ën dhe përfundon në vitin 2025. Saktësisht afati është 60 muaj, por ne i referohemi 5 vjet, por sipas kontratës është 60 muaj.

Ina Zhupa – Administratorja ka pohuar këtu që ka shtyrje të afateve dhe është deri në 6 vjet. Faleminderit për konfirmimin tuaj!

A keni ju organe në vartësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Viola Haxhiademi – Nuk ka shtyrje të afatit të ndërtimit. Mbetemi te 5-vjeçari, dhe nuk ka ndryshuar asnjë muaj.

Ina Zhupa – A keni ju organe në vartësi që merren me monitorimin e kontratave koncesionare?

Viola Haxhiademi – Ministria ka strukturat, të cilat në fusha të caktuara kanë përgjegjësinë, në bazë të përcaktimeve të tyre ligjore dhe kompetencat u janë dhënë me VKM apo me ligj, për të mbuluar një pjesë të funksioneve të tyre. Për shembull, ARSSH-ja, që ta hapim pak, të mos mbetemi vetëm këtu, e cila është kompetente për rrugët. Patjetër që brenda strukturës së ministrisë janë struktura, nukla të vogla, politikëbërse, por kur flitet për çështje të mëdha, janë struktura të tjera, të cilat ndjekin zbatimin e kontratave.

Ina Zhupa – Këtu u evidentua, nga pyetjet e zotit Bushati, një nga shkeljet e kontratës, që ishte për ndryshimin e pronarëve. Unë ju pyeta a keni monitorim, sepse nuk është e udhës që ju t'i merrni vesh shkeljet nga komisioni hetimor, por duhet të keni një strukturë që ju referon herë pas here, ku ju bën raporte në lidhje me ecurinë e një kontrate dhe evidenton shkeljet e mundshme, që ju të keni mundësi të jepni gjoba apo penaltete.

Viola Haxhiademi – Për të mos u bërë e bezdisshme duke përsëritur veten, patjetër që është NJZP-ja struktura e autorizuar dhe është zëri i ministrisë, e cila është një strukturë me kombinimin e disa institucioneve. Ne kemi një marrëdhënie institucionale dhe shkresore me NJZP-n, sepse janë përfaqësues të ministrive të ndryshme. Por kur flasim për kontrata, që kanë të bëjnë me ndërtimin, patjetër që nga supervizori shkon te NJZP-ja për të bërë këtë. Kjo është e padiskutueshme dhe mban përgjegjësi ligjore për çdo gjë, për zbatimin e grafikut të punimeve, për realizimin e tyre, për financimin, për të gjitha gjërat është supervizori dhe mban përgjegjësi ligjore.

Ina Zhupa – E fundit, në lidhje me prodhimin e energjisë, që ju pyeti edhe zoti Bushati, a ka ministria juaj të përgatitur një raport apo studim, që lidhet me vënien në funksion të prodhimit dhe shitjen e energjisë nga inceneratorët sipas kontratës?

Viola Haxhiademi – A do ma përsërisësh edhe një herë pyetjen, ju kërkoi ndjesë?

Ina Zhupa – Kontratat parashikojnë edhe shitjen e energjisë, si produkt final nga të cilat do të marrin fitim, ju e monitoroni këtë proces? Përveç kontratës që keni bërë, a keni raporte mbi këtë proces se ku është?

Viola Haxhiademi – Përveç inceneratorit të Elbasanit, i cili ka qenë në prodhim të energjisë dhe e ka hedhur në rrjet, për Tiranën dhe Fierin nuk kemi prodhim energjie për momentin dhe nuk është hedhur asnjë sasi energjie në rrjet.

Ina Zhupa – Edhe për rastin e Elbasanit raporti i ERE-s nuk na evidenton që është hedhur energji në rrjet. Ju thatë që është hedhur në rrjet, a ka një bashkërendim të këtyre dy institucioneve?

Viola Haxhiademi – Unë nuk mund të shprehem për atë çfarë ka thënë ERE, ai është një institucion i pavarur dhe nuk ka varësi nga ministria jonë. Unë shprehem për atë çfarë di unë dhe për informacionin që marr nga strukturat që janë monitoruese, dhe e di që të gjitha strukturat kanë deklaruar në mënyrë të shkruar hedhjen e energjisë në rrjet prej vitesh. Momenti kur është

ndërprerë prodhimi i energjisë ka qenë momenti një ditë apo dy ditë përpara se SPAK-u të kryente sekuestron.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja Tabaku!

Faleminderit, zonja Haxhiademi, për përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e këtij komisioni!

Unë dua të sjell në vëmendje të këtij komisioni dhe të gjithë qytetarëve që Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka bërë një miratim me shkresën nr. 4557/7, datë 31.10.2016, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit të rikuperimit të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, nga shoqëria “Albtek Energy sh.p.k.”. Njëkohësisht dhe ka një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili është bërë publik me nr. 792, datë 09.11.2016 për këtë problem.

Kam dy pyetje. E para, a është kryer pagesa për punimet faktike të kryera në impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier nga ana e ministrisë suaj dhe nga ju personalisht?

Viola Haxhiademi – Sot që flasim, unë kam një konfirmim nga supervizori, datë 30.03.2021, që ka mbaruar ndërtimi dhe realizimi i kontratës, sipas situacioneve. Sot që flasim, pagesat e kryera nga Ministria e Infrastrukturës në tërësi jo vetëm nga ministria, pra në tërësi nga buxheti i shtetit, nuk kanë arritur vlerën e deklaruar sipas situacionit, si investim i kryer nga shoqëria.

Antoneta Dhima – Si sekretare e Përgjithshme, unë dua të di nga ana juaj cilat janë përgjegjësitë e supervizorit.

Viola Haxhiademi – Supervizori ka përgjegjësi ligjore për një sërë aktivitete, për ndjekjen e çdo gjëje. Supervizori është në terren çdo ditë, për grafikun e punimeve, për realizimin e zërave të deklaruar, për investimin ai është përgjegjës në të gjitha projektet. Këtu që është edhe më komplekse, patjetër që kërkon një përgjegjësi shumë më të madhe.

“*AVE Consulting*” vazhdon të na vë në dispozicion me shkresa për të gjitha çështjet apo nëse ka problematika. Deri tani nuk ka asnjë problematikë të ardhur nga tavolinë as nga supervizori, as nga NJZP-ja. Ministria e Infrastrukturës ka nisur shkresat te NJZP-ja për t’u siguruar në çfarë kushtesh jemi dhe për të filluar llogaritjen e penaliteteve për vonesën e mosvënies në funksionim të impiantit të Fierit.

Antoneta Dhima – Faleminderit për përgjigjet.

Zonja kryetare, kam një kërkesë për ju. Ju deklaruar që ka një lëvizje në shitjen e aksioneve dhe keni ekstraktin historik të shoqërisë që në datë 14 shkurt 2022 janë bërë transaksionet, dua që këtë ekstrakt ta deponitoni pranë sekretarisë.

Gjithashtu, ditën e martë keni bërë publike një listëpagesë për pagesën e ish-administratorit të Fierit, edhe kjo listëpagesë dua që të merret në dorëzim nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Po, zonja Dhima.

Zoti Plarent Ndreca, eksperti juaj i nderuar i tenderit të uniformave dhe të çdo lloj tenderi në Republikën e Shqipërisë, mund ta aksesojë *online*....

Antoneta Dhima – Të lutem, nuk ka lidhje, unë bëra një kërkesë konkrete dhe ju duhet t'i deponitoni pranë sekretarisë këto të dhëna...

Jorida Tabaku – Patjetër.

Antoneta Dhima – Gjithsecili mban përgjegjësi individuale. Përgjegjësia nuk është kolektive.

Zoti Plarent Ndreca dhe çdo zotëri tjetër që ka shkelur ligjin mban përgjegjësi individuale. Të lutem!

Jorida Tabaku – Patjetër. Meqenëse u ngrit shqetësimin i supervisorit dhe e diskutuam gjatë, kush e ka zgjedhur supervisorin?

Viola Haxhiademi – Me një procedurë të përcaktuar në kontratë, në secilën prej kontratave...

Jorida Tabaku – Në këtë rast kompania *AVE Consulting* që ju e përmendët.

Viola Haxhiademi – Kam përshtypjen që *AVE Consulting* është në të tria. Unë supervisorin e kam gjetur të emëruar, nuk është se është me procedurë, por është bërë që në fillim fare me lidhjen e kontratës. Janë propozuar tre emra, të paktën me procedurat që kam parë dhe NJZP-ja ka zgjedhur njërin nga tre emrat e propozuar dhe i është njoftuar palëve për kompaninë, e cila do të bëjë supervizionin e ...

Jorida Tabaku – A keni dijeni për faktin që në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit thuhet që supervizionin duhet ta zgjidhte institucioni juaj, por fatkeqësisht e ka zgjedhur koncesionari dhe kjo është konsideruar si shkelje? Pra, ju në këtë komision keni deklaruar që çdo pagesë e bazoni mbi auditin që është Stela Gugallja dhe mbi supervisorin që e ka zgjedhur po

Klodian Zoto dhe Stela Gugalljan? Pra, praktikisht ne po deklarojmë që ju po financoni, por nuk i kontrolloni dot, sepse i ka kontrolluar përsëri Stelal Gugallja dhe Klodian Zoto të gjitha pagesat. Ju keni autorizuar pagesa të këtyre individëve bazuar në raportet e dhëna nga këto individë dhe nuk ka ekzistuar në mënyrë absolute asnjë kontroll...

(Debat në sallë)

Viola Haxhiademi – A mund t’ju sqaroj?

Jorida Tabaku – Ju lutem, zonja po flet me shumë qetësi dhe po i sqaron të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja ta përfundojë përgjigjen zonja dhe pastaj mund ta merrni fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhafaj, të lutem, do të flisni kur t’jua jap fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja iu referua disa herë dhe tha që unë nuk mbaj përgjegjësi, sepse ia sjell supervizori dhe auditi. Unë po i them, a e dini që supervizori është vetë kompania.

Etjen Xhafaj – Kur thuhet për procedurë merret fjala, nëse jemi jashtë procedurës...

Jorida Tabaku – Patjetër.

Etjen Xhafaj – Për çfarë po flasim, ju jeni duke akuzuar persona që nuk kanë lidhje me këtë. E para.

Jorida Tabaku – Nuk po e akuzojmë fare zonjën, thjesht po i themi nëse e dini që janë këto...

Endri Xhafaj – E dyta, jeni përsëri jashtë kohëve të gjësë, pra ajo që po i thoni është që përse nuk e keni lexuar të gjitha...

Jorida Tabaku – Jo, jo fare. Unë po i them zonjës...

Etjen Xhafaj – Më jepni pra mundësinë të flas ...

Jorida Tabaku – Një sekondë se po i drejtoj një pyetje zonjës me shumë qetësi.

Antoneta Dhima – Bëni pyetje dhe jo konkluzione.

Jorida Tabaku – Kur të përfundoj unë zonja do të flasë. Kompania “*AVE Consulting*”...

(Ndërhyrje pa mikrofon e zotit Etjen Xhafaj)

Patjetër. Kompania “*AVE Consulting*” që është supervizori, është propozuar nga vetë koncesionari thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, nuk ka pasur ...

Viola Haxhiademi – Ka një përcaktim...

Jorida Tabaku – Mund ta vazhdojë zonja. Ju lutem, ka qenë jashtëzakonisht korrekte në përgjigje, prandaj nuk besoj që...

Viola Haxhiademi – Janë procedura, të cilat i kam gjetur të mbyllura, pra nuk jam në dijeni të mënyrës.

Jorida Tabaku – Kaq

Viola Haxhiademi – Por di për që për të tria kemi *AVE Consulting* si supervizor, që ka përgjegjësi ligjore dhe është një kompani e madhe, në dijeninë time, për t'i njohur përgjegjësitë e veta për atë çfarë bën dhe çfarë firmo

Jorida Tabaku – Shqetësimi ynë është përdorimi i buxhetit të shtetit, sepse nuk na intereson fare se çfarë bën supervizori. Ju i bazoni të gjithë firmat tuaja të buxhetit të shtetit mbi një kompani që është në konflikt interesi.

Ju flisni për Njësinë e Zbatimit të Projektit si një entitet që nuk varet nga kush, sikur është në eter dhe është jashtë. Autoriteti kontraktues është Njësia e Zbatimit të Projektit, thjesht ju sugjeron, ju rekomandon. Përgjegjësinë ligjore e mban autoriteti kontraktues, sepse në këtë mesele unë po kuptoj që shteti e ka financuar, por nuk ka ushtruar kontroll. Klodian Zoto dhe Stela Gugallja e kanë bërë kontrollin

Viola Haxhiademi – Larg të gjithë komenteve, ligjet në tërësinë e tyre përcaktojnë hallkat e monitorimit të kontratave.

Jorida Tabaku – E kam këtu.

Viola Haxhiademi – Nuk mundet që përgjegjësia të mbesë në një institucion. Kjo është arsyeja përse vendosen *layers* të monitorimit dhe të kontrollit duke ndarë përgjegjësitë në nivele të caktuara të supervizori të NJZP-ja, pa hequr përgjegjësinë e institucionit, i cili merr sinjale nga strukturat.

E sqarova që ka problematika për të bërë lëvizje dhe për të marrë masat e duhura, duke ndjekur shkresa. Gjithashtu, sqarova që me NJZP-në kemi marrëdhënie institucionale. NJZP-ja nuk është e përbërë me staf të një ministrie, por është një kompozim dhe përbërje komplekse nga Ministria e Mjedisit nga bashkitë respektive dhe secili merr përgjegjësitë për pjesën e tij. Kjo është arsyeja përse është bërë.

Jorida Tabaku – Sigurisht. Por firmën në fund të ditës e keni hedhur ju për t'i përcjellë raportet dhe për supervizorin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është autoriteti kontraktues që e përcakton. Ligji...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e kam parë ministren që del në terren për kontrata të tjera, edhe zotin Gjikhuri e kam parë që ka shkuar te inceneratori i Elbasanit. Këtë po diskutojmë çfarë përgjegjësie ka autoriteti kontraktues? Një autoritet kontraktues për dhënien e koncesionit dhe një autoritet kontraktues për zbatimin e koncesionit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo zoti Shalsi, ju sapo erdhët. Ju nuk ishit këtu gjatë gjithë diskutimit, jo tani sepse ka radhë.

Zonja Haxhiademi faleminderit!

Fjalën e ka zoti Boçi, i cili e ka kërkuar po për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po sapo e përfunduat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zonja Çupi dhe pastaj zoti Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Më fal, a më thatë pasi të mbaroni ju do të ma jepni fjalën?

(Debat pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Xhafaj, pastaj zonja Çupi.

Etjen Xhafaj – E kam për procedurë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, ju nuk ishit në mbledhje prandaj kjo nuk është etike...

Etjen Xhafaj – Zonja kryetare, të lutem, është e qartë që ju do të paragjykoni çdo njeri nga anëtarët e maxhorancës në këtë komision dhe çdo dëshmitar këtu, por nuk mund t'i akuzoni të gjithë për të gjitha. Ky është komision hetimor parlamentar, nuk është gjyq popullor dhe nuk mund të vazhdojmë me këtë procedurë pa procedurë, ku i vendosim të gjithë përpara fakteve, që nuk kanë lidhje me ata, ku çdo dëshmitar duhet të fasë për të gjitha.

Nëse keni kaq vite, me gjithë respektin, apo kaq muaj që përgatisim këtë komision apo këtë hetim, a mund ta sqarojmë publikun që na ndjek, por edhe njëri-tjetrit për anën e procedurave ligjore, sepse nëse nuk njihet procedura ligjore, e cila përgjegjësinë e ndan institucionalisht, sipas fushave të veprimit të çdo institucioni, brenda këtyre institucioneve, sipas

përgjegjësi të pozicioneve brenda tyre. Ne nuk mund të flasim të tërë për të gjitha, edhe për hetim tatimor, edhe për prokurori, edhe për polici, edhe për të tjera.

Nëse kemi çështjen e supervizorit, që është hallkë ligjore dhe e procedurave ligjore, që kanë të bëjnë me çdo koncesion, mund të thërrasim supervizorët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, para dy ditësh në dëshmitë që janë dhënë këtij komisioni të nderuar hetimor, ku respektohet vetëm njëri krah, ndërsa për tjetrin nuk pyet, na është thënë që ka mbi 220 kontrata koncesioni. Nëse janë diku te 190 nuk mund të pyetet specifikisht me emra të përveçshëm. Nëse këto janë pyetje të domosdoshme për hetimin, shumë faleminderit për pjesën e respektimit etik të gjithë çështjeve që ngrihen nga të gjithë, atëherë ejani dhe të mos ia kërkojmë një njeriu të gjithë informacionin, por këtë informacion ta kërkonin në formë shkresore ashtu siç janë administruar të gjitha kërkesat e tjera të këtij komisioni hetimor.

Ne kemi miratuar të gjithë së bashku objektin e hetimit dhe kemi vijuar me këtë që nga dëshmitarët e dokumentet që janë kërkuar. Nëse do të vazhdojmë të ndryshojmë ditë për ditë dhe do t'u kërkojmë të gjithë njerëzve individualisht të gjithë dokumentet, kjo pastaj tregon që kjo nuk është çështje e një komisioni hetimor, por është një çështje që çdo institucion është përgjegjës për çdo gjë dhe aq më tepër çdo dëshmitar nuk po trajtohet si dëshmitar, por si i pandehur. Të gjithë e kemi përsëritur dhe stërpërsëritur që në procedurat për komisionet hetimore, kjo është tërësisht e ndaluar.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Bushati.

Helidon Bushati – Zonja kryetare, po i referohem diskursit të parafolësit, pa dashur të bëj replikë. M'u duk sikur i gjithë diskursi lidhet me faktin që ata, që vijnë për të dëshmuar këtu, nuk duhet të sjellin dokumentacionin, të cilin kanë marrë përsipër ta sjellin pranë këtij komisioni, sipas kërkesave të anëtarëve të këtij komisioni. Unë gjithmonë vazhdoj të insistoj, besoj se kam mirëkuptimin jo vetëm të zonjës Haxhiademi, por të ministrisë që ajo përfaqëson, që ne, ky komision, në afate sa më të shkurta kohore do të kemi kontratën, për të cilën folëm dhe vendimin e Këshillit Ministrave, çdo gjë të protokolluar dhe zonja Haxhiademi e mori këtë si një angazhim institucional, jo personal pa dyshim.

Faleminderit! Kaq kisha për sqarim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Zonja kryetare, e kuptoj që ndërhyrjet e mia të rralla të bëjnë të mendosh që nuk isha prezent, por jam prezent që në krye të herës kur ka ardhur dëshmitarja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sinqerisht, nuk doja të më kërkonit ndjesë mua, por do të bëja edhe një herë tjetër thirrje që komisioni të respektojë etikën. Keni bërë akuza, janë thënë të pavërteta. Kolegu shtroi disa pyetje, absolutisht pa asnjë lloj problemi, pyeti dhe nuk bëri asnjë koment, pyeti dhe mori përgjigjet që donte, ndoshta mori përgjigjet që nuk donte, por nuk ndërhyra. Por kur shikoj që momente-momente, dhe këtu kam një thirrje për të gjithë kolegët deputetë, për të gjithë pa përjashtim, nëse duhet, ta ndërpresim 5 minuta, por nuk mund të vijojmë edhe për shkak të interesit, edhe për shkak të procesit hetimor, që e dimë shumë mirë si po ndodh, të tejkalohen kompetencat e komisionit, të bëhen interpretime, të bëhen akuza, të bëhen komente e të thuhet të pavërteta, sepse mund të them edhe një diçka që e thatë para lidhjes me ekstraktin, hapa ekstraktin, pashë datat, krejtësisht e pavërtetë ajo. Këtu nuk jeni as ju dhe as askush prej nesh për të bërë hamendësim. Edhe mënyra se si do t'u drejtohem dëshmitarëve duhet të dëshmojë së paku respekt edhe për ata që kemi thirrur, edhe për pozicionin tonë. Gjithsecilit i kërkoj, por ju e para keni përgjegjësinë e madhe si moderatore të tregoni me shembuj. Thashë ka kolegë përballë që bëjnë pyetje, marrin përgjigje; janë të pëlqyeshme, nuk janë të pëlqyeshme, por nuk kanë bërë interpretime. Këtë po kërkoj, prandaj ndërhyra dhe prandaj kam ndërhyrë rrallë, kur kam parë që janë tejkaluar, madje po abuzohet me pozicionin tonë. Pyetet dëshmitari, merret përgjigja, nuk ka nevojë as për të bërë koment, as për të interpretuar dhe as për të hamendësuar se çfarë donte të thoshte dhe pse e tha apo si e tha. Në rast se do ta respektojmë këtë gjë, atëherë do të vendosim edhe një normë të re. E kuptoj që kanë kaluar shumë ditë, e kuptoj edhe trysnin që gjendesh si kryetare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, trysninë e të menaxhuarit të një tryeze, që unë për vete e kam provuar, dhe ta kam thënë, në komisionet parlamentare. Nuk është e lehtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Tabaku, unë të kuptoj, shpeshherë të mirëkuptoj, shpeshherë nuk të mirëkuptoj, sepse është pozicion i vështirë të moderosh një komision në përgjithësi, për më tepër një komision hetimor. Ndaj duhet të sforcoheni shumë më tepër nga gjithsecili prej nesh për shkak të përgjegjësisë që keni si moderatore dhe si moderatore duhet të jeni e fundit që jepni shembullin

e abuzimit me pozicionin, duke bërë aludime, duke bërë përsiatje dhe duke hamendësuar. Në rregull.

Unë për veten time nga ky moment e tutje, që nga momenti që do të konstatoj nga të gjitha krahët një sjellje jokonform përgjegjesisë sonë, do të kërkoj pezullim të seancës, derisa të gjithë të bëhemi të vetëdijshëm për rolin që kemi.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Shalsi, nuk dua fare të bëj absolutisht asnjë replikë për atë që thatë ju, sepse ia kemi harxhuar kohën zonjës edhe me replika ndërmjet njëri-tjetrit në këtë komision. Unë iu referova një informacioni publik, e ndava me anëtarët tuaj të komisionit, ju gjykojeni, reflektohet në QKB, nuk reflektohet, kjo është çështje tjetre, por informacioni është publik. Informacioni për ndryshimin e aksioneve të kompanisë është një informacion publik. A keni nevojë që ta konsultoni më pas? Në rregull. Më pas diktohem me njeri-tjetrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kam thënë në këtë komision asgjë që nuk e kam bazuar në letra, në prova dhe në shkresa. Për supervisorin është e njëjta gjë, është raporti shumë voluminoz i Kontrollit të Lartë të Shtetit që na ka ardhur para dy ditësh, të cilit iu referova pak më parë, e gjen si shkelje që supervisorin është miratuar nga vetë kompania. Është i njëjtë në të tria rastet e të tri inceneratorëve dhe këtu po diskutojmë për një përgjegjësi, sepse po paguhen fonde të buxhetit të shtetit bazuar mbi këtë supervisor dhe mbi këtë auditues. Këtë vetëm, asnjë koment tjetër.

Fjalën e ka kërkuar zoti Boçi.

Eduard Shalsi – Zonja kryetare, 1 sekondë.

Jorida Tabaku – Po, zoti Shalsi.

Eduard Shalsi – Zonja kryetare, unë nuk do ta bëja ndërhyrjen. Lëreni t'i largohen dëshmitarët, më pas bëjmë një *brainstorming* bashkë.

Jorida Tabaku – Po, patjetër.

Eduard Shalsi – Të themi çfarë mendoni ju dhe çfarë mendojmë ne. Për sa kohë i kemi dëshmitarët këtu për t'i pyetur, le të marrim përgjigjen. Na pëlqeu, nuk pëlqeu, si e dha përgjigjen, është përgjegjësi e tyre. E kam thënë dhe e theksoj: jemi këtu për të hedhur dritë mbi të vërtetën dhe nuk kemi as edhe njëfarë kompleksi. Përgjegjësit kanë dalë një pjesë para drejtësisë; do të dalin, nuk do të dalin, nuk e dimë si do të dalë kjo histori, por nuk jemi absolutisht aspak të interesuar që të shmangim tymnajën dhe të lejojmë një proces që do të

ndihmojë, jo një proces që po duket sikur më shumë po eklipson se sa po e ndihmon. Këtu them pyetje-përgjigje. Iku dëshmitari, bëni komente; kemi konferencat e shtypit aty poshtë, mund të dalim nëpër media dhe mund të bëjmë, por jo këtu. Nuk është ky vendi.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Shalsi!

Fjalën tymnajë sot e hodhi zoti Edi Rama dhe në unison fillon komisioni me fjalën tymnajë.

Zoti Boçi, pyetjet e fundit për zonjën që të largohet, sepse është e ngarkuar.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Haxhiademi!

Unë kam 3-4 pyetje.

Së pari, me vendim qeverie ministria juaj është autoriteti kontraktor, i cili kontrollon zbatimin tashmë të tri kontratave koncensionare, apo jo?

Viola Haxhiademi – E sqarova, ka një urdhër të përbashkët të ministrive për transferimin e dokumentacionit të tri kontratave koncensionare nga Ministria e Mjedisit, duke na kaluar të drejtën e menaxhimit të këtyre kontratave në vijimësi, diçka nga 12.01.2018, por nuk dua të jem e gabuar me datën.

Luçiano Boçi – Dua një sqarim për shumën që duhet të paguhet nga buxheti i shtetit për zbatimin e këtyre kontratave. Sa është shuma totale, sepse ka shumë debat për këtë gjë?

Viola Haxhiademi – Atëherë, po i ndaj kontratat veç e veç. Nuk di ta them bashkë, duhet t'i shikoj kontratat veç e veç, ashtu sikurse menaxhohen. Kontrata e Elbasanit ka një vlerë 21 milionë e 600 euro pa TVSH; kontrata e Fierit është 27 milionë e 500 euro e diçka, të mos ngatërrohëm, ndërkohë për Tiranën nuk paguhet para nga buxheti i shtetit për ndërtimin si funksion i kontratës.

Luçiano Boçi – Këtu pati pyetje në lidhje me çmimin dhe marrëdhënien që ka centrali elektrik në Elbasan me ERE-n, i cili nuk ka një çmim të përcaktuar, por ka pasur një studim fizibiliteti, dhe besoj se ju jeni e njohur me studimin e fizibilitetit. Pyetja ime është: sa ishte çmimi i parashikuar në studimin e fizibilitetit për shitjen e energjisë?

Viola Haxhiademi – T'ju them të vërtetën, nuk e kam këtë informacion me kaq detaje. Ju kërkoi falje! Unë di që, meqenëse jemi shtet ligjor, nisem nga vendimi i gjykatës që e ka detyruar ERE-n dhe nuk e shikoj me vend që të diskutojmë një studim fizibiliteti sot, kur ka një vendim gjykatë që një strukturë shtetërore duhet të nxjerrë çmimin për të vijuar.

Luçiano Boçi – Jo për të bërë koment, por studimi i fizibilitetit parashikon një çmim, pasi në kontratë angazhohen palët, në këtë rast edhe autoriteti kontraktues, që të marrë masat që kërkesa e shoqërisë të zbatohet. Në këtë rast nuk është më Ministria e Mjedisit autoriteti, por jeni ju që duhet ta ndihmoni koncensionarin në këtë rast për të arritur objektivat e tij sipas studimit. Nuk e kisha për koment, kam pyetje të tjera. Në kontratën e re 25-vjeçare, që u parashtrua edhe nga parafolësi, përcaktohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka kontratë aplikimi, e drejtë, në lidhje me centralin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne flasim për procedurë, dhe tani do të moderoni pyetjet tona, sepse nuk po e kuptoj?! Mënyrën si e formuloj unë pyetjen është njohuria ime, është mënyra e parashtrimit tim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

U fol për një kontratë 25-vjeçare për shfrytëzimin e prodhimit të energjisë nga kompania Albtek. Kjo kontratë 25-vjeçare, a e pengon dorëzimin në afat të impiantit të Bashkia e Elbasanit, pasi ka pasur debate të tilla midis bashkisë në momentin e fillimit të dorëzimit 6-mujor dhe kompanisë, pasi kompania pretendon që mund ta shfrytëzojë për 25 vjet impiantin e prodhimit të energjisë?

Viola Haxhiademi – Nuk jam në dijeni të debateve që ka pasur kompania e Elbasanit. Ajo që mund të them, dhe që vazhdoj të insisto, është që procesi i dorëzimit do të përfshinte në tërësinë e tij të gjithë veprën, duke përfshirë edhe incenerimin, që do të thotë edhe objektin e prodhimit të energjisë elektrike dhe e drejta për prodhimin e energjisë elektrike është një e drejtë e transferueshme në momentin që asetit transferohet dhe bashkë me asetin transferohet edhe e drejta e prodhimit të energjisë. Është e pamundur që të mbetet me një X aksioner që nuk ka më të drejta mbi objektin. Nuk e di konfliktin që kanë pasur. Kështu që nuk mund të shprehem në lidhje me këtë, nuk e di debatin.

Luçiano Boçi – Këtë pyetje e kam më shumë për sqarim. Çështja e koncesionit, që u dha nga komisioni, ishte negociim pa shpallje dhe argumenti ishte emergjenca mjedisore. Këtu përfshihet edhe çështja e koncesionit të centralit elektrik, sepse ka dy koncesione, megjithëse njëri është brenda. Ky i dyti nuk duhej të kishte ndjekur procedura të tjera, sepse nuk kishte të bënte me emergjencën mjedisore, është një profil komplet tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ta quajmë.

Në lidhje me aplikimin dhe miratimin që dha ministria juaj, sipas procedurave, njoftimi duhet të ishte shpallur tri ditë në tri gazeta kombëtare, a është bërë kjo?

Viola Haxhiademi – Nuk kam dijeni në lidhje me këtë. Janë procedura që unë i kam gjetur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Përgjithësisht ia kam tërhequr vëmendjen kolegëve socialiste, por sot do t'ia tërheq zoti Boçi me gojën plot. Këto pyetje i ezauroam një herë, zonja është shumë e ngarkuar me punë, ka detyra të tjera të rëndësishme, të lutem, të mos i përsëritim pyetjet e kolegëve!

Luçiano Boçi – Deri tani kontrata, për të cilën flasim, sepse është folur shumë nuk është bërë publike. A mund të bëhet publike?

Viola Haxhiademi – Ka një VKM. Unë do t'jua sjell dhe do t'jua vë në dispozicion, ashtu siç i thashë edhe zotit Bushatit, patjetër.

Jorida Tabaku – Zonja Haxhiademi, ju lutem një sekondë!

Zoti Bushati i bëri njëjtën pyetje, pak a shumë, dhe zonja premtoi se do të na sjellë informacion për kontratën origjinale, që i referohet asaj VKM-je që po diskutojmë këtu.

Zoti Boçi, a keni pyetje të tjera?

Unë ju falënderoj që ju hoqa edhe ato tri pyetje, sepse ishte përgjigjja.

Të nderuar kolegë, kanë qenë ditë të gjata pyetjesh dhe përgjigjesh për të dyja anët e tryezës, për mua kryesisht në fillim.

Dua që ta falënderoj zonjën për pyetjet dhe për përgjigjet! Njëkohësisht, dua t'i kërkoj ndjesë, në qoftë se zgjati pak më shumë. Faleminderit që erdhët pak më herët! Ka një interes shumë të madh publik për këtë kontratë koncensionare. Kemi ngritur një komision hetimor për këtë kontratë koncensionare dhe unë i mirëkuptoj të gjithë kolegët që kanë pasur pyetje dhe interes.

Faleminderit!

A doni të thoni diçka të fundit?

Viola Haxhiademi – Faleminderit!

Jo.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Ju lutem, edhe një minutë, para se bëjmë pak pushim!

Partia Socialiste dërgoi kërkesën për Këshillin e Rregullores dhe Mandateve për dëshminë e zotit Artan Rama, ndërkohë që unë po depozitoj një kërkesë të Partisë Demokratike që gjatë dëshmisë së zotit Engjëll Agaçi ne të marrim informacion për procesverbalet e tri mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, të cilat i kemi të nevojshme për të diskutuar në këtë komision.

Faleminderit për durimin!

Zoti Boçi dhe zoti Shalsi, besoj se do të na bashkohen deri në fund të punimeve të këtij komisioni.

Kemi për të marrë dëshminë e zotit Loran Dusha, i cili për momentin është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si administrator i inceneratorit “*Integrated Technology Waste Treatment Fier*”. Zoti Dusha e shprehu vullnetin e tij për të ardhur në komision ditën e hënë, më pas ditën e martë ose të mërkurë komisioni administroi një test COVID-i, zotëria ishte i sëmurë. Pas tri njoftimesh, me vendosëm të kemi një komunikim *online*. Kështu që, duke qenë se zotëria është në kushtet e COVID-it, unë besoj se do të kemi mirëkuptimin e të gjithë kolegëve për t’i koncentruar pyetjet dhe për të vlerësuar kohën e zotërisë, i cili është edhe i sëmurë, zonja Denaj. Të respektojmë edhe kohën e zotërisë që është i sëmurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Denaj më kujtoi që për të gjithë dëshmitarët ne duhet që ta respektojmë kohën.

Zoti Dusha, a na dëgjoni qartë?

Loran Dusha – Po, ju dëgjoj.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zoti Dusha ka avantazhin që nuk na dëgjon kur flasim jashtë mikrofonave, kështu që dëgjon vetëm mikrofonin dhe asnjë diskutim jashtë mikrofonave.

Ju kujtoj se, bazuar mbi rregulloren e brendshme të komisionit, dëshmia do të merret pas betimit nga personi i thirrur dhe ju kujtoj, njëkohësisht, se, sipas Kodit Penal, dëshmia e rremë dënohet deri 6 vite heqje lirie, sigurisht nga organet kompetente, siç zoti Ajazi ka shumë dëshirë të kujtojë. Neni 360 i Kodit të Procedurës Penale thotë se ju duhet të betoheni para këtij komisioni. Ju lutem, përsërisni në fund pas meje “Betohem se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë.”

Loran Dusha – Betohem!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zoti Dusha, cila është mosha juaj?

Loran Dusha – Mosha ime 38 vjeç.

Jorida Tabaku – Dua të bëni një prezantim tuajin , njëkohësisht, në cilën detyrë jeni për momentin?

Loran Dusha – Quhem Loran Dusha, lindur në Lushnjë, dhe banues në Tiranë, datëlindja 18.11.1983. Aktualisht zotëroj postin e administratorit të shoqërisë “*Integrated Technology Waste Treatment Fier*”.

Jorida Tabaku – A e njihni shtetasin Mirel Mërtiri dhe shtetasen Stela Gugallja?

Loran Dusha – Nuk ju dëgjova.

Jorida Tabaku – A e njihni shtetasin Klodian Zoto, shtetasin Mirel Mërtiri dhe shtetasen Stela Gugallja?

Loran Dusha – Po, i njoh.

Jorida Tabaku – Në cilat marrëdhënie?

Loran Dusha – Klodian Zoto është aksioner kryesor i shoqërisë, ku unë punoj, ndërsa zoti Mirel Mërtiri ka qenë drejtor pranë kompanisë “*Integrated Technology Service*”

Jorida Tabaku – Në cilin vit keni filluar punë në kompaninë aktuale? Kërkoj ndjesë, nëse e nuk e kam dëgjuar unë!

Loran Dusha – Kam filluar punë më 28 gusht 2017.

Jorida Tabaku – Ku keni punuar më parë?

Loran Dusha – Kam qenë në kompani të tjera private. Në vitin 2013 kam qenë punonjës në kompaninë “*Integrated Technology Service*” dhe aty e kam njohur edhe Klodian Zoton.

Jorida Tabaku – Kjo kompani në pronësi të kujt është?

Loran Dusha – Kjo kompani është në pronësi “*Integrated Technology Service*” dhe ndërtim-montim Patos, Fier.

Jorida Tabaku – Është e njëjta kompani që po flasim që është në administrim në koncesionin e Fierit.

Loran Dusha – Po.

Pronarët e shoqërisë që unë administroj janë *Waste Treatment Fier*, janë *Integrated Technology Service* dhe ndërtim-montim Patos, Fier janë dy aksionarët e kësaj kompanie.

Jorida Tabaku – Dhe i keni filluar marrëdhëniet e punës me ta që në vitin 2013?

Loran Dusha – Në vitin 2013 unë kam qenë për një periudhë shumë të shkurtër në kompaninë “*Integrated Technology Service*”.

Jorida Tabaku – Kur ka qenë eksperiencia juaj e parë në punë, pra në cilin vit?

Loran Dusha – Unë kam punuar në kompani të ndryshme, por në vitin 2013 unë kam qenë punonjës i ITS.

Jorida Tabaku – A keni punuar më parë në kompani të tjera, apo kjo ka qenë eksperiencia juaj e parë?

Loran Dusha – Eksperiencia ime e parë pas mbarimit të shkollës ka qenë specialist marketingu.

Jorida Tabaku – Në cilën kompani?

Loran Dusha – Specialist marketingu kam qenë te “*FedEx*”, kompani postare.

Jorida Tabaku – Unë kam këtu një ekstrakt nga QKR-ja që në vitin 2010 ju keni qenë përfaqësues i kompanisë “*Hermes Communication*”, nuk e keni njohur zotin Klodian Zoto që në kompaninë “*Hermes Communication*” që në vitin 2010?

Loran Dusha – Jo, nuk kam dijeni.

Jorida Tabaku – A keni njohur zotin Arben Ahmetaj në kompaninë “*Hermes Communication*” në vitin 2010?

Loran Dusha – Jo.

Jorida Tabaku – A keni punuar, apo jo në këtë kompani? A keni qenë përfaqësues zyrtar?

Loran Dusha – Jo.

Jorida Tabaku – Nuk keni asnjë lidhje me këtë kompani?

Loran Dusha – Jo.

Jorida Tabaku – Atëherë, na ka gënjyer Qendra Kombëtare e Regjistrimit që ju keni qenë përfaqësues dhe është dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit një dokument juaj i identitetit me datëlindje 18.11.1983, Loran Dusha; mund të lexoj edhe ID-në, por për çështje...

Loran Dusha – Jo, është diçka që nuk kam dijeni.

Jorida Tabaku – Nuk keni dijeni që kompania “*Hermes Communication*” ka përdorur të dhënat tuaja dhe ju ka regjistruar si përfaqësues?

Loran Dusha – Zonjë, nuk kam dijeni për këtë çështje.

Jorida Tabaku – E kuptoj.

Loran Dusha – Nuk kam dijeni për këtë çështje, është hera e parë që po e dëgjoj.

Jorida Tabaku – Besoj se kuptoni që dëshmia juaj është në betim?

Loran Dusha – Patjetër.

Jorida Tabaku – Patjetër. E njihni zonjën Ariola Kodra?

Loran Dusha – Ariola Kodra?

Jorida Tabaku – Po.

Loran Dusha – Nuk e njoh.

Jorida Tabaku – Nuk e njihni?

Loran Dusha – Nuk e njoh.

Jorida Tabaku – Nuk e njihni zonjën Ariola Kodra?

Loran Dusha – Në marrëdhënie pune jo.

Jorida Tabaku – E njihni, apo jo zonjën Arjola Kodra?

Loran Dusha – Në marrëdhënie pune jo, sepse nuk kam punuar asnjëherë me zonjën Kodra.

Jorida Tabaku – Në rregull. Atëherë, në kompaninë CGC keni punuar, apo jo?

Loran Dusha - Po.

Jorida Tabaku – Në kompaninë “CGC” ka punuar edhe zonja Arjola Kodra, e cila në betim këtu dëshmoi që nuk e njihnte Klodian Zoton, Mirel Mërtirin dhe Stela Gugalljan përpara vitit 2019, kur kishte marrëdhënie pune me to. Kompania “CGC” është një shoqëri, ku dalin si pronarë Stela Gugallja, Klodian Zoto, Mirel Mërtiri, Loran Dusha, që jeni ju, keni qenë një periudhë kohe aksioner i kësaj kompanie dhe përfaqësues ligjor...

Loran Dusha - Nuk kam qenë përfaqësues ligjor, por kam qenë administrator.

Jorida Tabaku - Dhe njëkohësisht zonja Arjola kodra, përfaqësuese ligjore e kësaj kompanie. Zonja na dëshmoi këtu në këtë komision se në vitin 2019 i ka njohur zotërinjtë që e kanë marrë në punë dhe para këtij viti nuk i njihnte. A e njihni zonjën Denisa Tollkuçi?

Loran Dusha - E njoh!

Jorida Tabaku - Ne çfarë marrëdhënie e njihni zonjën Denisa Tollkuçi?

Loran Dusha - Ka qene punonjëse e *Integrated Techology Services*.

Jorida Tabaku - Njëkohësisht përfaqësuese ligjore e inceneratorit të Elbasanit.

Loran Dusha - Nuk e di këtë pjesë.

Jorida Tabaku - Nuk e dini.

Në gjykimin tuaj, pse kompania, ku ju punoni tani, kishte nevojë që të hapte tre kompani të tjera me emra të ndryshëm për të reflektuar në tre koncesione të ndryshme, tre kërkesa të ndryshme, ndërkohë që pronarët ishin të njëjtë?

Loran Dusha - Nuk e di për çfarë po flisni. Unë përfaqësoj shoqërinë ku jam dhe pronarët e kompanisë, ku unë jam administrator, janë *Integrated Technology Service* dhe Ndërtim Montim Patos, për pjesën tjetër nuk e di.

Jorida Tabaku - Në cilën marrëdhënie e njihni Denisa Tollkuçi?

Loran Dusha - Kur kam qenë punonjës tek *Integrated Technology Service* ka qenë kolege.

Jorida Tabaku - I sqaroj këto pyetje, sepse bëhet fjalë për një grup individësh, 4 ose 5 individë, që në vitin 2010 kanë punuar në biznese të ndryshme. Ju kujtoj që të gjithëve se kompania Hermes Communication është çelësi që i lidhë këta individë në marrëdhënie biznesi. Zoti Klodian Zoto i lidh këta individë. Zonja Arjola Kodra në dëshmi, në betim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, që të gjithë e kemi të qartë marrëdhënien e pronësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër! Edhe unë atë po bëj.

Këtu është shumë e rëndësishme që ne të kuptojmë sesi një rrjet biznesesh janë lidhur me njëri-tjetrin që në vitin 2010...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Asnjë të keqe, por zonja në betim dha një dëshmi të rremë dhe ky është shqetësim.

Bëhet fjalë për të njëjtat persona. Kur ka qenë komunikimi juaj i fundit me zotin Mirel Mërtirin, Klodian Zoton dhe zonjën Stela Gugalljan?

Loran Dusha - Me Klodian Zoton, me sa mbaj mend, ka qenë para festave të nëntorit, me zotin Mirel Mërtiri, nuk e mbaj mend, ka shumë kohë pa komunikuar.

Jorida Tabaku - E kuptoj. Besoj se komunikimet tuaj kanë qenë në lidhje me punën tuaj dhe detyrën tuaj si administrator i inceneratorit të Fierit?

Loran Dusha - Në rastin e zotit Klodian Zoto, po.

Jorida Tabaku - Zoti Dusha, unë këtu kam bilancin që kompania juaj ka dorëzuar, ku, në fakt, detyrimi ligjor ishte edhe për vitin 2020, unë të fundit kam vitin 2019 dhe kompania juaj nuk e ka plotësuar detyrimin ligjor për ta dorëzuar bilancin e vitit 2020, ku thuhet që në bilanc

njihet nga vetë ju në fakt. Po e citoj: “Arkëtime për paradhënie, për porosi, 20 milionë euro”. A mund të na e sqaroni pse në bilanc keni deklaruar që janë marrë arkëtime për paradhënie për porosi 20 milionë euro. I kujtoj të gjithë qytetarët se në vitin 2019 inceneratori i Fierit nuk kishte filluar akoma ndërtimin dhe operimin e tij, për arsye të çështjes së pronës që ne kemi diskutuar gjerësisht.

Ndoshta linja nuk është emirë dhe zotëria na dëgjon me vonesë.

Pse në bilancin tuaj thoni që keni marrë 20 milionë euro paradhënie për porosi, ndërkohë që punë nuk është kryer? Si i keni marrë 20 milionë euro paradhënie për porosi?

Loran Dusha –Nuk e kuptoj pyetjen.

Jorida Tabaku - Pse keni marrë 20 milionë euro paradhënie për porosi? Çfarë porosisih kur nuk janë kryer punë? Pse keni bërë pagesa për paradhënie, 20 milionë euro?

Loran Dusha - Pagesat paradhënie mund të jenë bërë edhe për..., a më dëgjoni?

Jorida Tabaku - Nuk ju dëgjuam dhe nuk ju kuptuam. Çfarë janë 20 milionë euro pagesa për paradhënie për inceneratorin e Fierit?

Loran Dusha - Më duhet ta shikoj këtë pjesë. Nuk mund t’jua them.

Jorida Tabaku - Inceneratori i fierit është në total 28 i gjithi, 20 milionë euro është 70% e vlerës së inceneratorit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi- Pyetja duhet të jetë specifike: “A keni marrë ju nga buxheti i shtetit paradhënie 20 milionë euro?”

Jorida Tabaku- I kanë marrë pra...*(mungesë incizimi)* nga buxheti i shtetit 20 milionë euro paradhënie për punë që nuk është kryer, e keni reflektuar në bilanc. Ju kujtohet apo nuk ju kujtohet?

Loran Dusha- Më duhet ta shikoj.

Jorida Tabaku- Kontratat e inceneratorit të Fierit, sipas informacionit që ne kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i gjithë tranferta buxhetore që ka ardhur çdo vit është nënkontraktuar nga një grup i ngushtë kompanish, 80% e tyre në pronësi të zotit Zoto, kompania ITS, një pjesë tjetër është nënkontraktuar në kompanitë, të cilat kanë xhiruar fatura TVSH-je me vlera fiktive, jo reale. Ky është një informacion i bërë publik jo vetëm nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht që është i saktë. drejtoria e përgjithshme e Tatimeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi administruar, ka ardhur në këtë komision ditën e mërkurë ai dokument nga drejtoria e përgjithshme një CD. Është vendosur në dispozicion dhe të gjithë e kemi dhe me atë informacion po punojmë. Të gjitha tabelat, librat e shitjes dhe të blerjes të të gjithë kompanive që ju keni kontraktuar, kompanitë e zotit Klodian Zoto. Ky është shqetësimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur ta merrni ju për pyetje, do ta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë punësh e keni kontraktuar zotin Klodian Zoto, me të gjitha fondet dhe një pjesë tjetër e fondeve ka shkuar vetëm për kompani që kanë marrë pagesa fiktive? Më dëgjuat apo jo?

Loran Dusha - Jo, nuk ju dëgjova?

Jorida Tabaku -Për çfarë punësh është paguar zoti Klodian Zoto me vlerën e 20 milionë eurosh paradhënie nga buxheti i shtetit, kur nuk është kryer punë në inceneratorin e Fierit, të paktën deri në vitin 2019?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lekë të buxhetit të shtetit. Kam konfirmimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. 23 milionë euro, për të qenë e saktë. drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nënkontraktim të kompanive të Klodian Zotos.

Loran Dusha - Më duhet ta konfirmoj, sepse nuk mund t'jua them dot.

Jorida Tabaku - Çfarë pune ka kryer kompania që ka marrë paradhënie deri në vitin 2019, që ju keni qenë administrator, dhe nuk është ndërtuar?

Loran Dusha - Kompania *Integrated Technology Services* është kompani nënkontraktore për kryerjen e punimeve civile dhe për ndërtim.

Jorida Tabaku - Çfarë pune keni kryer konkretisht deri në vitin 2019?

Loran Dusha - Unë nuk e mbaj mend që të ta them se çfarë punimesh kemi kryer.

Jorida Tabaku - Po ta them unë, sepse nuk ka pasur vendosje të përcaktuar, ve ndodhja nuk është përcaktuar dot akoma, kanë lëvizur në tre vende të ndryshme. Ndërkohë që lëvizej në tre vende të ndryshme, çfarë pune ka kryer kompania?

Loran Dusha - Zonjë!

Jorida Tabaku - Po, zotëri!

Loran Dusha - Kompania ka filluar ndërtimin për impiantin e trajtimit të mbetjeve dhe të prodhimit të energjisë pas marrjes së lejes së ndërtimit më 5 shkurt të vitit 2018.

Jorida Tabaku - Keni filluar punën më 8 gusht të viti 2018.

Loran Dusha - Jo, më 5 shkurt ka dalë leja dhe ka filluar puna për ndërtimin.

Jorida Tabaku - Atëherë, më 8 gusht ka dalë leja e ndërtimit për inceneratorin e Fierit.

A më dëgjoni?

Loran Dushi - Më 5 shkurt 2018.

Jorida Tabaku - Ju kërkoi ndjesë!

Unë kam qenë në inceneratorin e Fierit në fund të vitit 2019 në fillim të vitit 2020 ka qenë një karabina, e kam parë me sytë e mi që ka qenë vetëm një karabina. Deputetët kanë shkuar disa herë në inceneratorin e Fierit gjatë kësaj periudhe, por edhe gjatë punës së komisionit hetimor dhe kanë vënë re që pajisja nuk është në punë. Edhe një herë, për çfarë janë shpenzuar 20 milionë euro paradhënie për inceneratorin e Fierit dhe, sipas pagesave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kompanive të Klodian Zotos në total 23 milionë euro?

Loran Dusha - Zonjë, unë këtë duhet ta konfirmoj dhe nuk mund t'jua them dot tani, sepse nuk kam asnjë dokument, por mund të jenë bërë pagesa për nënkontraktorë për agregatet e inceneratorit me kompanitë e huaja. Këtë nuk mund ta them dot, sepse duhet ta konfirmoj.

Jorida Tabaku- Shpenzimet e inceneratorit të Fierit, sipas analizave që ka sjellë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kanë një zë të konsiderueshëm për shpenzime udhëtimi. Për çfarë ka qenë e nevojshme që të udhëtojnë punonjësit e kompanisë tuaj?

Loran Dusha- Ato janë udhëtime personeli për nevojat e impiantit.

Jorida Tabaku - Nuk ka pasur impiant në vitin 2019.

Loran Dusha - Nuk ka pasur, por detyrimisht ne kemi nënkontraktorë që janë jashtë Shqipërisë, po them janë në Itali dhe janë udhëtime pune të kompanisë të stafit, lidhur edhe me nevojat e kompanisë, duke shkuar te nënkontraktorët dhe duke parë ecurinë e punëve.

Jorida Tabaku - Kontraktori i vetëm, sipas librave të shitjes, është Klodian Zoto. A ka nënkontraktorë të tjerë? Zoti Zoto a është i vendosur në Itali, ka bizneset e tij në Itali?

Loran Dusha - Jo, nuk di që të ketë.

Jorida Tabaku - Po atëherë?!

Loran Dusha - Nuk e kuptova pyetjen.

Jorida Tabaku - Nënkontraktori i vetëm, sipas librave të shitjes 23 milionë euro, është Klodian Zoto. Zoti Zoto i ka të vendosura bizneset e tij të vendosura në Itali, ITS-ja është në Itali? Kush janë nënkontraktorët në Itali, ose në Holandë?

Loran Dusha - Unë mund të t'i jap me emra, por nuk i mbaj mend të gjitha. Ne kemi porositur agregatë për inceneratorin.

Jorida Tabaku - Nuk ka pasur inceneratorë deri në vitin 2019, nuk ka pasur agregate, nuk ka pasur inceneratorë...

Loran Dusha - Bëhet porosia për agregatet që vonon në prodhim, detyrimisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku - Ju lutem, kolegë, ta dëgjojmë zotin Dusha!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka pasur kompani, për 4 vjet nuk ka pasur kompani, si i kanë paguar 23 milionë euro pa kompani?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk kam asnjë kompleks të më flasë mua Partia Socialiste, e cila ka marrë emrin nga Partia Komuniste. Unë jam mbesa e një të persekutuari politik të më thoni mua: “Hetues të komunizmit”. Ju lute, pak integritet!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Secili flet për veten e vet, zonja Neta!

Zoti Dusha, shqetësimi im është që janë paguar 23 milionë euro kur s'ka pasur punë, paradhënie. Këtë e thoni vetë në bilan, “paradhënie” thotë zoti Dusha, si administrator në ekstraktin që është depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kanë udhëtuar jashtë për të bërë punë kur nuk ka pasur punë; është paguar kompania e zotit Zoto. Prandaj, ne duam të dimë se kush është pronari përfitues dhe ku kanë shkuar paratë e buxhetit të shtetit? për këtë është ky komision.

Loran Dusha- Zonjë e nderuar, ju keni qenë, ose një pjesë e deputetëve kanë qenë prezent në impiantin e inceneratorit të Fierit dhe e kanë e parë në çfarë faze është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërtimi i impiantit të inceneratorit ka përfunduar.

Jorida Tabaku - Të mos i hyjmë këtij diskutimi, sepse e diskutojmë më vonë, por unë po interesohem për vitet 2017-2018-2019-2020, për këtë periudhë.

Loran Dusha - Këtë pjesë nuk mund t'juaj konfirmoj tani, sepse më duhet ta shikoj dhe nuk ju jap dot përgjigje.

Jorida Tabaku- Nuk e dini që keni marrë 20 milionë euro nga shteti, 23 milionë euro i ka marrë Klodian Zoto në këtë periudhë? Nuk e mbani mend fare, ka nevojë për konfirmim kjo?

Loran Dusha – Nuk e kuptoj: “I ka marrë Klodian Zoto 23 milionë euro”, duhet ta shikoj.

Jorida Tabaku - Ka nënkontraktuar veten.

Loran Dusha - Zonjë, më duhet ta shikoj dhe ta konfirmoj, nuk mund të jap një përgjigje tani drejtpërdrejt.

Jorida Tabaku- Patjetër!

Zonjën Sevi Zani e njihni?

Loran Dusha- Po.

Jorida Tabaku - Sevi Zani ka qenë njëkohësisht punonjëse e kompanisë BCGC, që është kompania që ka bërë ofertën e pakërkuar për inceneratorin e Fierit, më pas, menjëherë, pas dorëzimeve të ofertave të pakërkua, pronësinë e këtij biznesi e blen zoti Klodian Zoto. Zonja Sevi Zani, për të gjithë të interesuarit, është njëkohësisht përfaqësuese dhe punonjëse edhe tek inceneratori i Tiranës dhe del njëkohësisht në punë edhe nga zoti Klodian Zoto dhe për inceneratorin e Elbasanit. A keni dijeni pse zonja ia shiti aksionet e saj zotit Klodian Zoto, që më pas mori kompaninë....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Proceduar sesi është marrë koncesioni nuk është objekt i këtij komisioni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, sigurisht, sepse bëri një ofertë të parkuar dhe ia bleu Klodian Zoto.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Pëllumbi, me qetësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, bëhet fjalë për të njëjtin grup punonjësish, që kanë blerë me njeri-tjetrin, kanë ngritur biznese, kanë bërë oferta të pakërkua.

Ndërhyrje pa mikrofon

A e njihni shtetasin Alqi Bllako?

Loran Dusha - Jo.

Jorida Tabaku - Po shtetasin Edmond Arqile Bllako?

Loran Dusha- Jo.

Jorida Tabaku - A e njihni shtetasin Lefter Koka?

Loran Dusha - Jo.

Jorida Tabaku- Asnjë nga këta shtetas nuk i njihni, as shtetasin Arben Ahmetaj?

Loran Dusha- Jo, i njoh si politikanë.

Jorida Tabaku - I njihni si politikanë, nuk keni pasur ndonjëherë asnjë kontakt me to?

Loran Dusha - Jo, asnjëherë.

Jorida Tabaku – E kuptova.

Kam edhe dy pyetje të fundit për zotin Dusha dhe më pas do t'ia jap fjalën kolegëve.

Në planin e biznesit të dorëzuar nga kompania, të cilën, siç doli nga historiku, ju nuk jeni thjesht administrator, por njiheni që në një kohë të hershme, por, njëkohësisht, edhe në studimin e fizibilitetit thuhet që kompania ka kapacitetin për ta ndërtuar vetë impiantin dhe, njëkohësisht, inceneratorin. Ndërkohë, këtu na dëshmoi edhe ish-administratori, janë marrë dy kredi bankare për ndërtimin e saj, ne kemi edhe barrat sigurorese, të cilat janë depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, janë *online*. Pse gjykoni që ka qenë e nevojshme marrja e dy kredive bankare, kur kompania ka thënë që ka pasur qëndrueshmërinë financiare për ta zbatuar vetë projektin?

Loran Dusha - Zonjë, unë në këtë periudhë, kur është bërë firmosja e kontratës nuk kam qenë dhe nuk mund t'ju jap dot një...

Jorida Tabaku- ju sapo pranuat që keni qenë pjesë e kompanisë ITS, e cila ka bërë studimin e fizibilitetit për këtë kontratë.

Loran Dusha - Unë kam qenë pjesë e ITS-së në vitin 2013, zonjë, dhe administrator i kompanisë *Integrated Technology Waste Treatment* Fier kam filluar punë në datën 29 gusht të vitit 2017.

Jorida Tabaku - A e dini se kur është bërë studimi i fizibilitetit dhe kërkesa?! Ka nisur procedura që në vitin 2015-2016, pra, bëhet fjalë pikërisht për periudhën kur ju keni qenë në punë.

Loran Dusha - Nuk kam qenë punonjës, nuk kam pasur lidhje fare me ta.

Jorida Tabaku - Tek inceneratori, sigurisht, jo, nuk ka sot incenerator, jo atëherë të ketë pasur lidhje.

Unë kam edhe një pyetje të fundit për zotën Loran Dusha. Në momentin që është fituar kontrata koncesionare, pronësia e aksioneve ndryshoi nga kompania italiane, që ishte përdorur për të marrë koncesioni dhe që kishte eksperiencën koncesionare, te kompania Ndërtim Montim Patos, që kishte një bilanc prej 98 milionë lekësh, por vitin pasardhës deklaroi pothuajse një 10-fishim, por edhe një rritje të xhiros. Në dijeninë tuaj, kompania ka marrë miratimin paraprak nga autoriteti kontraktues për këtë ndryshim pronësie.

Loran Dusha - Nuk kam dijeni për këtë gjë.

Jorida Tabaku- Nuk keni dijeni për këtë çështje?

Loran Dusha - Jo.

Jorida Tabaku - Dua t'i jap fjalën anës së maxhorancës për pyetje, pastaj zotit Lefter Gështenja nga ana e opozitës.

Zonja Dhima fjala për ju.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Dusha, që pranove të lidhesh *online*, edhe pse je me arsye shëndetësore!

Të uroj të shkuara dhe shërim të shpejtë!

Pyetja e parë: a vazhdon puna për kolaudimin e veprës në impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier?

Loran Dusha - Vazhdon.

Antoneta Dhima - Pyetja e dytë: kur mendoni se do të përfundojë kolaudimi i veprës dhe do të dorëzohet nga ana juaj?

Loran Dusha - Mendojmë që shumë shpjet vepra do të jetë në funksion dhe dorëzimi i veprës është në muajin tetor të vitit 2022.

Antoneta Dhima - Aktualisht, a depozitohen mbetje në impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier dhe cilat janë bashkitë që depozitojnë mbetje?

Loran Dusha - Sot në impiantin e trajtimit të mbetjeve depozitohen mbetje Bashkia Fier, Bashkia Patos, Bashkia Lushnjë dhe Bashkia Roskovec, janë bashkitë të cilat depozitojnë mbetjet urbane në landifill.

Antoneta Dhima- Me përafërsi, sa është volumi i mbetjeve që depozitohen aty çdo ditë.

Loran Dusha - Afërsish, me përafërsi janë 180 tonë në 24 orë.

Antoneta Dhima - Sa është numri i personelit, i cili punon në këtë impiant të trajtimit të mbetjeve?

Loran Dusha - Aktualisht, janë përafërsisht 31 punonjës.

Antoneta Dhima – Sa?

Loran Dusha – Afërsisht 31 punonjës.

Antoneta Dhima – Faleminderit edhe një herë dhe të shkuara!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje, zoti Dusha!

Faleminderit që jeni pjesë e këtij komunikimi dhe të shkuara!

Loran Dusha – Faleminderit!

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Lefter Gështenja – Pyetja ime e parë për ju është: a jeni në dijeni që kompania juaj ka qenë e licencuar që nga momenti i parë për këtë proces që ka marrë përsipër të realizojë? Pra, a është e licencuar kompania?

Loran Dusha – Nuk e kuptova pyetjen.

Lefter Gështenja – Kompania juaj është e licencuar për realizimin e punimeve që ka marrë përsipër për këtë koncesion...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

Loran Dusha – Si nuk është e licencuar? Kompania është kompani. “Integrated Technology Waste Treatment Fier” është krijuar për zbatimin e këtij projekti.

Lefter Gështenja – Meqenëse në kriteret e tenderit nuk është si kriter, por a jeni të licencuar për ndërtimin e impianteve elektrike, siç është ky impianti që do të prodhojë energji?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Impianti...

Lefter Gështenja – Nëse po, a mund të kemi një kopje të licencës, a mund të na e vini në dispozicion nëse keni mundësi online tani, apo kur mund të na e vini në dispozicion?

Loran Dusha – Do të shikoj dhe do t’ju them. Unë nuk kam asgjë këtu.

Nuk mund t’ju jap asgjë.

Lefter Gështenja – Pyetja e parë ishte: a jeni të licencuar apo jo?

Loran Dusha – Po.

Lefter Gështenja – Jeni të licencuar?

Loran Dusha – Po.

Lefter Gështenja – Si administrator i kësaj kompanie, ju keni realizuar disa nënkontrakttime, të cilat, në dijeninë time, janë deklaruar publikisht edhe pse nga organet ligjzbatuese nuk na është vënë në dispozicion një material i tillë, por privatisht kemi marrë informacione që ju keni bërë nënkontrakttime.

Ashtu siç e keni të përcaktuar në kontratë ligjërisht, a i keni të miratuara këto nënkontrakttime nga institucioni, nga autoriteti kontraktues?

Loran Dusha – Po.

Lefter Gështenja – Pra, janë të certifikuara, të miratuara?

Loran Dusha – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në dijeninë time, po.

Lefter Gështenja – Në dijeninë tuaj, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni i sigurt për këtë?

Loran Dusha – Në dijeninë time.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet ta shikoj. Do ta verifikoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështenja – Pra, je i sigurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – A jam i sigurt?! Duhet ta verifikoj.

(Debat në sallë)

Lefter Gështenja – Çfarë keni? Pse mërziteni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka gjë.

Pyetja tjetër është: si ka mundësi që kompania...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, si ka mundësi...? E dua unë.

Si e doni ju? E doni “si ka mundësi”, a ka mundësi?

Si ka mundësi që për koncesionin e Fierit janë ezauruar të gjitha fondet e kontratës, përfshirë... Nëse nuk gaboj, kanë ngelur vetëm 248 lekë të rinj, pra 2480 lekë të vjetër pa marrë nga kontrata, ndërkohë...

Loran Dusha – A mund t’ju korrigjoj këtu, ju lutem?

Lefter Gështenja – Po.

Loran Dusha – Shoqëria “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sot ka marrë 23 milionë e 700 euro pa TVSH.

Lefter Gështenja – Ma thuaj në lek, se në lek e kam nga Thesari.

Loran Dusha – Tani, unë në lek mund ta kthej me makinë llogaritëse, se...

Lefter Gështenja – Kështu e kam nga Thesari. Gjithsesi, ma thoni ju, domethënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Shoqëria në fjalë ka marrë kaq dhe ka për të marrë akoma lek, euro domethënë.

Lefter Gështenja – Sa?

Loran Dusha – Ka për të marrë akoma, afërsisht edhe rreth 5 milionë euro.

Lefter Gështenja – Jo, e certifikuar nga Drejtoria e Thesarit, na është vërtetuar që ju keni ezauruar të gjithë fondin e kontratës. Kjo është zyrtare nga Thesari. Nëse ju keni shtesë kontrate, duhet të na e thoni.

Loran Dusha – Nuk ka shtesë kontrate. Lekët nuk janë marrë... Janë marrë sipas rregullave, por nuk janë marrë të gjitha; nuk janë ezauruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështenja – Unë shifrën, e përsëris, e kam nga Drejtoria e Thesarit me shkresë zyrtare, të cilën e ka i gjithë komisioni. Kjo do të thotë që i gjithë fondi në dispozicion për këtë kontratë është ezauruar.

Loran Dusha – Në dijeninë...

Lefter Gështenja – Është ezauruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Loran Dusha – Në dijeninë time...

Lefter Gështenja – Unë e kam zyrtare, jo në dijeni, madje këtë shkresë zyrtare e ka i gjithë komisioni, si opozita dhe maxhoranca, gjë e cila do të thotë se nga i gjithë fondi i vënë në dispozicion, në përputhje me vlerën e kontratës, mungojnë vetëm 248 lekë të rinj, në mos gaboj, edhe 12 cent. Pra, mungojnë 2480 lekë të vjetër nga vlera e kontratës.

Thuhet se është likuiduar për inceneratorin e Fierit, ndërkohë nga inspektimi që bëme në terren, inceneratori i Fierit rezultoi se nuk funksionon, nuk është vënë në punë.

Është e vërtetë apo jo?

Loran Dusha – Inceneratori i Fierit për momentin është në kolaudim.

Lefter Gështenja – Nuk është vënë në punë.

Është deklaruar nga kompania juaj që në prill të vitit 2021, përpara Kryeministrit, se do të vihej në punë për 20 ditë apo 30 ditë. Sot pas një viti nuk ka filluar ende nga puna.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është, apo jo, në punë? Ka punuar ndonjë ditë inceneratori i Fierit?

Loran Dusha – Nuk ka punuar. Është në fazë kolaudimi.

Lefter Gështenja – A ka punuar ndonjë ditë inceneratori i Fierit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Është në fazë kolaudimi, gjë e cila do të thotë që...

Lefter Gështenja – Duhej të përfundonte sipas kontratës në ...

Administratori është ai, nuk jeni ju.

(Deputetja Dhima flet pa mikrofon.)

Ne nuk jemi prokurore apo gjykatës, por ju nuk jeni avokatë! Ju lutem!

(Deputetja Dhima dhe deputetë të tjerë flasin pa mikrofon.)

Mos u bëni avokatë, ju lutem!

Loran Dusha – Në prill të vitit 2021 ka përfunduar ndërtimi i...

Lefter Gështenja – Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk ka përfunduar. Biem dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Në vitin 2021 ka përfunduar ndërtimi i impiantit. Kolaudimi është tjetër gjë.

Lefter Gështenja – Po për çfarë janë marrë paratë nga ana juaj kur ky objekt nuk është në punë...

Loran Dusha – Është në fazë kolaudimi.

Lefter Gështenja – ... në përputhje me kontratën?

Loran Dusha – Kontrata për dorëzimin e impiantit është në tetor të vitit 2022.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështenja – Në rregull. Faleminderit!

Loran Dusha – Faleminderit juve!

Jorida Tabaku – Kush ka pyetje nga deputetët e maxhorancës?

Zonja Çupi?

Dhurata Çupi – Po.

Jorida Tabaku – Me radhë të gjithë, ndërkohë që presim edhe nga radhët e maxhorancës kush ka dëshirë të bëjë pyetje.

Dhurata Çupi – Faleminderit, zotëri, për praninë edhe pse në kushte shëndetësore jo të favorshme sipas jush!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sipas jush.

Faleminderit që jeni i pranishëm për të dëshmuar!

Pyetja e parë. Ju keni filluar si administrator rreth 7 muaj pasi është nënshkruar kontrata dhe ka filluar ekzekutimi. Pra, kontrata është nënshkruar në tetor të vitit 2016 dhe ka pasur afat dorëzimi vitin 2019. A ka mundësi të jepni sqarime? Ndërkohë, paratë, gjithë buxhetin e shtetit...

Është deklaruar këtu edhe para jush që paratë janë marrë sapo është nënshkruar kontrata.

Loran Dusha – Për pjesën e parë unë nuk kam dijeni, sepse nuk kam qenë në atë periudhë.

Dhurata Çupi – Pse, janë marrë gjashtë muajt e parë të gjitha?

Jorida Tabaku – Nuk ka qenë administrator.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Jo, jo, nuk kam dijeni fare për pagesat që mund të jenë bërë në fillim, sepse unë nuk kam qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Po pra, po, po të them. Nga viti 2016...

Loran Dusha – Nuk ju jap dot një përgjigje.

Dhurata Çupi – Pra, në momentin kur ju keni qenë administrator, ka qenë shlyer e gjithë shuma 23 milionë euro? Keni marrë edhe ju pastaj, besoj, apo gjithçka është dhënë sapo është nënshkruar kontrata?

Loran Dusha – Zonjë, nuk kam dijeni për pjesën kur unë nuk kam qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Pyetja, në fakt, është e qartë, por, gjithsesi.

Kontrata duhej të përfundonte në... kishte afatin e përfundimit të punimeve dhe të vënies në funksion të inceneratorit në vitin 2019. Ju thoni se kontrata ka afat deri në tetor të vitit 2022. Përse u shty afati i kontratës nga viti 2019 deri në vitin 2022?

Loran Dusha – Nga informacioni që unë kam, shkak ka qenë ndryshimi i ndërtimit të impiantit nga një vend në vendin tjetër, kanë qenë protestat... Kështu që ka pasur vonesa. Për këtë shkak...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Kush e kërkoi ndryshimin e destinacionit të objektit?

Loran Dusha – Nuk e kam...

Zonjë, po flasim për një periudhë kohore kur unë nuk kam qenë.

Unë thjesht një informacion, që e kam, aq sa e kam, po jua jap. Unë nuk e di fare çfarë ka ndodhur.

Dhurata Çupi – Ju keni qenë, sepse ju keni filluar punë në vitin 2017...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Në fund të gushtit të vitit 2017.

Dhurata Çupi – Pikërisht, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, pra, Arencin e pyeta.

(Ndërhyrje pa mikrofon: Na e sqaroi.)

Dhurata Çupi – Jo, nuk sqaroi asgjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kishte protesta, pra. Zotëria thotë që tre destinacionet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju deklaroni që tre destinacionet janë ndryshuar para se ju të jeni administrator?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – Komisioni funksionon.

Loran Dusha – Unë nuk kam qenë administrator në periudhën kur janë bërë këto ndryshime.

Dhurata Çupi – Sepse ndryshimi i tretë, destinacioni i tretë në Mbrostar është reflektuar në kontratë shumë më vonë, pra kur keni qenë ju administrator.

Loran Dusha – Zonjë, unë... Leja ...

Në qoftë se flasim për lejen e ndërtimit, kam qenë unë, por leja e ndërtimit ka dalë më 5 shkurt të vitit 2018, kur impianti ka filluar të ndërtohet.

Dhurata Çupi – Ndërkohë kishit marrë të gjithë fondin e kontratës. Pra, shuma 23 milionë euro ishte dhënë nga buxheti i shtetit dhe ju nuk kishit marrë ende lejen e ndërtimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Jo, jo, në dijeninë time jo!

Dhurata Çupi – Sapo thatë që paratë janë dhënë gjashtë muajt e parë dhe ju nuk keni dijeni.

Loran Dusha – Unë do ta verifikoj, por për pjesën kur unë nuk kam qenë administrator nuk di të them, sepse nuk kam dijeni.

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Dhurata Çupi – Jo pra, më tha: “Janë marrë, janë dhënë... Nuk kam dijeni unë për paratë e buxhetit”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Nuk kam dijeni për momentin kur unë nuk kam qenë pjesë, kur nuk kam qenë administrator i kësaj shoqërie.

(Diskutime pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Po pra, por është reflektuar. E kam të qartë unë atë punë.

Është reflektuar tri herë ndryshimi i destinacionit, i cili është reflektuar shumë vonë në kontratë, kur zotëria ka qenë administrator. Dhe unë i them: ju keni marrë paratë, nuk keni pasur leje ndërtimi dhe nuk ka filluar funksionimi. Kaq. Pse është kërkuar shtyrja e afatit nga viti 2019 në vitin 2022? Pra, është kërkuar pothuajse më shumë shtesë e afatit të ekzekutimit të kontratës sesa ishte fillimisht.

Pra, nëse ishte fundi i vitit 2016 deri në vitin 2019, tashmë shkon nga viti 2019 deri në vitin 2022, ndërkohë fut edhe dy vite pandemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pretendoni se të gjitha paratë i keni marrë në vitin 2016, destinacioni përfundimtar për leje ndërtimi është dhënë në vitin 2018 dhe afatin e nënshkrimit të kontratës e keni tashmë në vitin 2022. Të gjitha këto kërkesa ju i keni bërë tek autoriteti kontraktues: për të shtyrë afatin, për të aplikuar për leje ndërtimi, për të ndryshuar destinacionin e pronës e të tjera.

Loran Dusha – Për ndryshimin e pronës nuk kam qenë, ndërsa për shtyrjen e lejes së ndërtimit po.

Dhurata Çupi - Edhe një pyetje: sa e keni pasur pagën ju si administrator?

Loran Dusha – Tani, paga është konfidenciale, nuk mund t’jua them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Jo, është këtu.

Loran Dusha – Mirë, është aty, ju e shikoni, por unë nuk mund ta them...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Po gjatë periudhës 2019-2022, a keni marrë kredi sovrane?

Loran Dusha – Po, kemi marrë.

Dhurata Çupi – Sa ka qenë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – 69 milionë lekë, në mos gabo, të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Mirë, faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zoti Dusha, përshëndetje dhe të shkuara!

Loran Dusha – Përshëndetje dhe faleminderit!

Arben Pëllumbi – A jeni thirrur ju për ndonjë arsye nga ndonjëri prej organeve të akuzës në lidhje me pozicionin që mbani në këtë kompani?

Loran Dusha – Jo.

Arben Pëllumbi – Ndonjë nga punonjësit tuaj?

Loran Dusha – Në dijeninë time, jo.

Arben Pëllumbi – Në dijeninë tuaj, jo. Në rregull.

Kur ne vizituam impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier, ju na thatë që midis 35 dhe 40 ditëve përfundon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose dikush nga ju, një përfaqësues na tha që midis 35 dhe 40 ditëve mendohet që mund të mbarojë kolaudimi. A vazhdojnë të jenë në terren përfaqësuesit e kompanive që bëjnë kolaudimin?

Loran Dusha – Po.

Arben Pëllumbi – A vazhdon puna në impiantin e trajtimit të mbetjeve në landfill?

Loran Dusha – Po, vazhdon.

Arben Pëllumbi – A vazhdon trajtimi i ujërave të ndotura?

Loran Dusha – Po, vazhdon.

Arben Pëllumbi – A vazhdojnë të vijnë çdo ditë rreth 100-180 ton mbetje?

Loran Dusha – Po, vazhdojnë të vijnë 180 ton mbetje.

Arben Pëllumbi – Fakti që nuk ka filluar ende incenerimi, a ka sjellë ndonjë pengesë në pastrimin e bashkive, të cilat kanë lidhur kontratë me ju?

Loran Dusha – Në dijeninë time, jo.

Arben Pëllumbi – Në rregull. Faleminderit!

Loran Dusha – Faleminderit juve!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zonja Zhupa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Përshëndetje, zoti Dusha! Të shkuara!

Loran Dusha – Faleminderit!

Ina Zhupa – A e deklaroni ju në tatime pagën e punonjësve njësoj siç ua jepni atë realisht?

Loran Dusha – Po.

Ina Zhupa – Punonjësi juaj, Arenc Myrtezani, i pyetur për pagën para komisionit, deklaroi se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Një sekondë, se është administratori!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Po e pyes...

Atëherë, zoti Myrtezani deklaroi se nuk merr pagën që ju deklaroni në tatime. A keni dijeni për këtë fakt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – Mund të jetë demokrat ai, mos e mbroni kot, se nuk i dihet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Zonjë, më dëgjoni?

Ina Zhupa – Po, unë ju dëgjoj.

Loran Dusha – Zoti Arenc Myrtezani pagën e ka më të vogël sesa paga ime. Në qoftë se i referohemi periudhës janar të vitit 2021, Arenc Myrtezani për atë periudhë ka marrë një bonus.

Ina Zhupa – Ah, e keni zgjidhur kështu si ta fshihni!

Loran Dusha – Jo, mund ta kontrolloni, mund ta aksesoni kur të doni, të shikoni edhe sa e ka pasur pagën ndër vite.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – ...bonus më të lartë se paga e administratorit që merr drejtori duhet të ketë disa shërbime të veçanta për të cilat e shpërbleni më shumë se paga juaj tri-katër herë.

Loran Dusha – I është dhënë një bonus...

Ina Zhupa – Për arsyen?

Loran Dusha – Për muajin janar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për performancë të mirë në punë.

Ina Zhupa – Në ç'kuptim? Se duhet të ketë bërë një gjë të paparë që të marrë atë rrogë.

Loran Dusha – Tani, këto janë të kompanisë. Unë jua dhashë përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – E kuptoj, por ngaqë merren nga paratë publike dhe e ndajnë, na bën përshtypje shuma 9 milionë lekë, se po t'i kishit para private, nuk do të na bënte aq shumë përshtypje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Unë jua dhashë përgjigjen.

Ina Zhupa – Në vitin 2018 kompania juaj ka realizuar 955...

Më dëgjoni? Se po bëjnë zhurmë. Janë ziliqarë për pagën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vitin 2018 kompania juaj deklaroi të ardhura në shumën 955 milionë lekë. Keni dijeni?

Loran Dusha – Më duhet ta konfirmoj.

Ina Zhupa – Duhet ta konfirmoni? Në rregull, sepse deklaroni pastaj fitim zero dhe për këtë doja t'ju pyesja: ku janë çuar paratë gjatë vitit 2018? Apo as këtë nuk e mbani mend?

Loran Dusha – Më duhet ta konfirmoj, zonjë.

Ina Zhupa – Nuk e mbani mend as këtë. Në rregull.

Loran Dusha – Nuk e mbaj mend.

Ina Zhupa – Në rregull.

Pyetja e fundit: aktualisht ju ose gjatë kohës kur ju keni qenë administrator, pra jo vetëm aktualisht, a keni bërë edhe tërheqje *cash* në bankat e nivelit të dytë në cilësinë tuaj si administrator, pra jo vetëm transaksione bankare, por edhe tërheqje *cash* të shumave?

Loran Dusha – Nuk e kuptova.

Ina Zhupa – Gjatë kohës kur ju jeni administrator i kompanisë, në cilësinë tuaj si administrator keni edhe të drejta, besoj, mbi financat e kompanisë. A keni kryer tërheqje *cash* nga llogaritë e kompanisë?

Loran Dusha – Nuk e mbaj mend.

(Deputeti Pëllumbi flet pa mikrofon: ...çfarë kanë bërë ata në përditshmërinë e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Po?

Loran Dusha – Nuk e mbaj mend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – E fundit, a keni autorizuar, a ka autorizuar kompania juaj, pra ju që jeni administrator, persona të tjerë për të kryer tërheqje parash *cash* nga llogaritë e kompanisë?

Loran Dusha – Jo, nuk kam dijeni.

Arben Pëllumbi – Nuk ka lidhje me objektin...

Ina Zhupa – Ka lidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Jo, nuk kam dijeni.

Ina Zhupa – Pyetja ishte: a keni autorizuar ju? Si nuk keni dijeni? A keni autorizuar dikë?

Pra, a ka autorizuar në cilësinë e administratorit se kush mund të bëjë tërheqje parash? Se ju jeni administratori. Nuk keni dijeni për atë që keni autorizuar?

Loran Dusha – Jo.

Ina Zhupa – Si “jo”? Nuk keni dijeni për atë që autorizoni? Se unë nuk po ju pyes për shifra konkrete.

Loran Dusha – Jo, nuk kam po them.

Ina Zhupa – Jeni administrator dhe nuk keni dijeni se kush mund të tërheqë paratë e kompanisë që administroni ju?!

Loran Dusha – Nuk ka një person tjetër që mund t’i tërheqë, - thashë.

Ina Zhupa – Ah, vetëm ju mund t’i tërhiqni.

Loran Dusha – Nuk u kuptuam në...

Ina Zhupa – Ah, më falni! Pra, nuk ka person tjetër. As pronarët nuk mund të tërheqin shuma parash?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem tani, se mund të japë autorizim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A keni dhënë autorizim? Po, jo?

Pra jo, askush tjetër, vetëm ju. Jam e saktë?

Loran Dusha – Nuk më kujtohet.

Ina Zhupa – Jam e saktë? Vetëm ju mund t’i tërhiqni?

Loran Dusha – O, zonjë, nuk më kujtohet! Nuk mund të jap dot një përgjigje në këtë moment. Nuk më kujtohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina Zhupa – Jo, “Nuk më kujtohet”, - thotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Nuk më kujtohet, zonjë.

Ina Zhupa – Atëherë, është rast unik që administratorit nuk i kujtohet dhe nuk e di kush tërheq paratë e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Loran Dusha – Faleminderit juve!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zonja Dhima dhe pastaj zoti Bushati.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Dihet jo vetëm për ne si anëtarë të këtij komisioni, por edhe për të gjithë publikun, që para se të fillonte ndërtimi i impiantit ka pasur protesta nga ana e banorëve të njësisë administrative Mbrostar.

Gjatë periudhës që ju keni ndërtuar këtë impiant dhe aktualisht tani, a kanë protestuar qytetarët në lidhje me ndërtimin e kësaj vepre?

Loran Dusha – Jo, në periudhën kur unë kam qenë, ndërsa për më mbrapa nuk e mbaj mend...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Pyetja tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Loran Dusha – Kam përshtypjen që po.

Antoneta Dhima – Më dëgjoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ju lutem, ta dëgjojmë zonjën Dhima!

Loran Dusha – Po.

Antoneta Dhima – Mbetjet që janë depozituar pranë impiantit të trajtimit të mbetjeve, me fillimin e punës, pasi do të kolaudohet dhe do të merret në dorëzim vepra, do të insinerohen?

Loran Dusha – Nuk ju dëgjoj.

Antoneta Dhima - Me fillimin e punës, pasi vepra të kolaudohet, sepse nga ana e opozitës këtu u tha që insineratori funksionon, por pa kolauduar nuk mund të funksionojë, dhe me marrjen në dorëzim të saj, do të fillojë insinerimi i mbetjeve që janë depozituar dhe atyre që vazhdojnë të depozitohen pranë impiantit të trajtimit të mbetjeve?

Loran Dusha – Po, do të fillojë.

(Debate pa mikrofon)

Helidon Bushati – Që të mos e mbajmë më tepër se është edhe i sëmurë.

Të kaluara, zoti Dusha!

Këtu kam kontratën e insineratorit të Fierit, ku pika nr. 1028, që përkon me një nga detyrat që ju keni, thotë: “Të mbajë të informuar autoritetin kontraktor për çdo rrethanë që mund

të ketë ndikim në ecurinë e projektit”. Ju e thatë pak a shumë këtë gjë në përgjigjet për pyetjet e koleges sime Çupi.

Edhe për pyetjen specifike nëse keni qenë ju ai që keni kërkuar zgjatjen e afatit, përgjigja ishte përsëri pohuese. A është e vërtetë kjo?

Loran Dusha – Po.

Helidon Bushati – Tek insineratori i Fierit ka dy shtesa kontratash. Unë dua një shpjegim për një element. Te kontrata kryesore, themelorja, e para, sikur të shkonte çdo gjë si duhej, koha e përfundimit të punimeve ka qenë 20 muaj, por më pas, gjatë kohës së administrimit tuaj, tek aneks-kontrata e nënshkruar jo nga ju, por nga autoriteti kontraktor, afati shkon në 29 muaj, në vitin në vitin 2019 dhe pastaj në vitin 2020, ndërkohë që punimet duhet të ishin kryer, bazuar në atë që ju thatë, që leja është marrë në datën 5 shkurt 2018.

Po e marrim të mirëqenë faktin që deri më 5 shkurt 2018 ka pasur problematika, por, siç e theksuat edhe ju, në përgjigje të pyetjeve të zonjës Dhima, pasi keni shkuar ju, pas vitit 2017, nuk ka pasur më protesta, nuk ka pasur më probleme. Tani, afati i kryerjes së punimeve nga 20 muaj në kontratën fillestare shkon në 29 muaj dhe e fundit thotë 37 muaj. Në gjuhën ligjore kjo quhet ndryshim i kushteve themelore të kontratës, gjë që nuk mund të bëhet me aneks kontratash, por e marrim të mirëqenë që bëhet.

Ju lutem, si e keni argumentuar zgjatjen nga 20 muaj në 37 muaj, kur nuk keni pasur as protesta? Ju lutem, gjatë shtjellimit mos fusni Covid-in, sepse çdo firmë në Shqipëri ka punuar gjatë kohës së Covid-it! A mund të ma shpjegoni pak, ju lutem?

Loran Dusha – Kjo ka ndodhur për shkak të vonesave. Ne kemi një relacion sqarues për këtë gjë, të cilin mund t’jua vë në dispozicion për ta parë. Në periudhën e Covid-it ne kemi pasur kompani nënkontraktore në Itali dhe kemi pasur mungesa edhe me furnizim, edhe në mjetet e transportit, pavarësisht se në Shqipëri lejohej të punohej në pjesën e ndërtimit. Nënkontraktorët tanë kryesorë janë në Itali dhe duke qenë se Italia ka qenë në një kolaps në atë periudhë kanë ardhur edhe këto pasoja dhe vonesa.

Helidon Bushati – Zoti Dusha, nga 5 shkurti 2018 deri në mars 2020 janë 24 muaj, i dashur. Covid-i dhe gjendja e emergjencës ka filluar në mars 2020. Domethënë, sipas pikave të kontratës, ju duhet të kishit kryer punimet përpara se italianët të fillonin të kishin probleme të presupozuara të transportit. Apo jo?

Loran Dusha – Zotëri, nëse kërkon një relacion sqarues, unë do t’jua vë në dispozicion për ta parë.

Helidon Bushati – Zotëri, unë iu referova një pike të kontratës, që është detyrimi juaj dhe ju e pranuat. Ju keni bërë, padyshim bashkë me supervizorin, se është procedurë kjo, argumentimin dhe unë po ju them që kontrata fillestare ka qenë 20 muaj. Ju keni marrë lejen, pikën e fillimit, që nuk ka pasur asnjë ndalesë ligjore për fillimin e punimeve, më 5 shkurt 2018 dhe në mars të vitit 2020 ka filluar Covid-i. Ju keni pasur 24 muaj kohë për të kryer punimet konform kontratës. A mund të më shpjegoni pse nuk janë kryer punimet, i dashur?

(Diskutime pa mikrofon)

A më dëgjon?

Loran Dusha –Tani po.

Helidon Bushati – Më 5 shkurt të vitit 2018 ju keni marrë lejen, që është pika e fillimit të punimeve pa asnjë ndalesë ligjore. Po apo jo?

Loran Dusha – Nuk ju kuptova, zotëri, se jam edhe pa qejf. Më falni!

Helidon Bushati – Jo, nuk ka problem, të fal, sepse ju mirëkuptoj për gjendjen që jeni dhe ju falenderoj që morët pjesë!

Më 5 shkurt të vitit 2018, sipas fjalëve tuaja, ju keni marrë lejen për fillimin e punimeve. Domethënë, nuk keni pasur më asnjëlloj ndalesë ligjore për të filluar punimet. Po apo jo?

Loran Dusha – Po.

Helidon Bushati – Gjendja e emergjencës së Covid-it në të gjithë Europën është vendosur në shkurt dhe mars të vitit 2020. A më dëgjuat?

Loran Dusha – Po.

Helidon Bushati – Atëherë, nga shkurti i vitit 2018 deri në mars të vitit 2020 janë 25 muaj afat, i cili duhet të përkonte me përfundimin e punimeve sipas afateve kontraktuale. Pastaj filloi Covid-i dhe ju keni gjetur ato justifikime. Përgjigju pyetjes sime, harroje Covid-in.

Loran Dusha – Dakord, e harrova Covid-in. Pas marrjes së lejes, që është afati 20 muaj, është kërkuar një shtyrje lejeje me 9 muaj për të gjitha problematikat që ka pasur.

Helidon Bushati – Cilat janë këto problematika, sepse thatë vetë që nuk ka pasur protesta?

Loran Dusha – Janë të gjitha bashkë. Mund t’ju jap relacionin shpjegues dhe do ta shikoni. Është marrë shtyrja e lejes me 9 muaj.

Më dëgjoni?

Helidon Bushati – Po, ju dëgjoj shumë mirë. Ju më dëgjoni mua?

Atëherë, për mendimin tim ju keni bërë një kërkesë të paargumentuar, sepse ju duhet t'i kishit filluar punimet edhe me fillimin e vitit 2018 dhe jo me fillimin e kontratës, kur keni marrë lejen. Duhet të ishin kryer, bile.

Loran Dusha – Më fal se po e zgjasim shumë, sepse edhe unë nuk jam në formë. Përgjigjen jua dhashë. Në qoftë se ju duhet informacion shpjegues, unë do t'jua vë në dispozicion dhe mund t'i shikoni shtyrjet e lejeve për çdo gjë, edhe pse janë shtyrë deri në fillim të prillit të vitit 2021. Unë do t'ju vë në dispozicion relacionin shpjegues dhe ju mund t'i shikoni, sepse edhe unë nuk kam fuqi të flas. Më kuptoni edhe mua.

Helidon Bushati – Absolutisht, ju mirëkuptoj për gjendjen tuaj shëndetësore dhe ju falenderoj që morët pjesë! Jua thashë edhe në fillim këtë gjë.

Po mundët, vendosini në dispozicion të këtij komisioni argumentimin e mirëfilltë pse ka ndodhur ndryshimi i një prej kushteve themelore të kontratës, që është afati i zbatimit.

Pyetja e dytë lidhet përsëri me punën tuaj.

Impianti i insinerimit do të kolaudohet për 30 apo 40 ditë dhe presupozohet që do të fillojë punën, apo jo?

Loran Dusha – Po.

Helidon Bushati – Për problematikat me ERE-n për sa i përket çështjes së çmimit, ndoshta jo ju si administrator, pronarët e insineratorit që ju përfaqësoni kanë pasur një eksperiencë të ngjashme edhe në Elbasan. Ju keni ndërmarrë hapa administrativë ligjorë për të zgjidhur këtë problematikë, sepse është diçka që do të ndodh pas 30 ditësh dhe do të fillojë prodhimi i energjisë?

Loran Dusha – Tani jemi në fazën e kolaudimit. Në momentin pas fazës së kolaudimit do të shkojmë, por deri në këto momente jo.

Helidon Bushati - Kjo përgjigje juaja, që ka pak probleme me profesionalizmin që duhet të ketë një administrator, mund t'ju shkaktojë edhe largimin nga puna nga aksionerët, që shpresoj të mos ndodhë. Ju e dini që impianti do të fillojë të prodhojë energji pas 30 ditëve, sipas fjalëve tuaja, por ndërkohë, duke pasur edhe precedentin e Elbasanit, nuk keni ndërmarrë asnjë hap për t'u licencuar, për të marrë leje dhe për të fiksuar çmimin nga ERE.

Faleminderit!

Kaq pyetje kisha.

Loran Dusha –Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Dusha për dëshminë tuaj dhe shërim të shpejtë!

Loran Dusha – Faleminderit!

Fadil Nasufi – Në dijeninë tuaj, teknologji e cilit vit është impianti?

Loran Dusha – Si teknologji është i viteve të fundit.

Fadil Nasufi – Në dijeninë tuaj, në cilin shtet janë blerë agregatet?

Loran Dusha – Pjesa më e madhe janë blerë në Itali.

Fadil Nasufi - Montimi dhe ngritja e impiantit, pas përfundimit të gjithë proceseve të tjera të punës, është bërë me specialistë të huaj?

Loran Dusha – Edhe një herë ju lutem, sepse nuk ju dëgjova!

Fadil Nasufi – Montimi është bërë me specialistë të huaj?

Loran Dusha – Po.

Fadil Nasufi – Për sa i përket shtyrjes së afateve, për të cilat u bënë disa pyetje nga kolegët e tjerë të komisionit, ka argumentim nga supervizori i punimeve?

Loran Dusha – Po, ka.

Fadil Nasufi - Dakord, faleminderit!

Loran Dusha – Faleminderit ju!

Jorida Tabaku – Zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit, kryetare!

I nderuar, të rikthehem edhe një herë ku ishim.

Në kontratë parashikohej që ndërtimi i këtij insineratori do të përfundonte në vitin 2019, kurse ju thatë që tani është në fazën e kolaudimit. Pra, nga viti 2019, kur duhej të dorëzohej, kanë kaluar gati 4 vjet që objekti duhet të ishte në punë nga ana juaj.

Sipas kontratës, ju do ta mbani edhe 4 vjet në punë pas kolaudimit apo do t’ia dorëzoni autoritetit kontraktor, siç e përcakton kontrata?

Loran Dusha – Do ta dorëzojmë siç thuhet në kontratë.

Lefter Gështenja – Do të thotë?

Loran Dusha – Do të thotë që me mbarimin e kontratës dhe dorëzimit, që është tetori 2022, i dorëzohet autoritetit kontraktor.

Lefter Gështenja - Ju do ta dorëzoni pa e vënë në punë, pa prodhuar energji, pa e testuar apo thjesht do ta kolaudoni dhe ...?

Loran Dusha – Jo, jo, impianti në momentin që mbaron kolaudimi, bëhet testimi, futet në funksion. Kështu që, në momentin që bëhet dorëzimi impianti do të jetë në punë.

Lefter Gështenja - Dakord, faleminderit!

Rikthehem edhe një herë te pyetja e parë. Sa është vlera e kontratës, sipas jush, se më thatë që nuk e keni marrë të gjitha pagesën sipas kontratës?

Loran Dusha –Vlera e kontratës është 28 milionë euro pa TVSH.

Lefter Gështenja – Ma thua dot në lekë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Etjen! Më ndiq!

Po ju korrigjoj si administrator i kompanisë. Vlera e kontratës, sipas ofertës së dorëzuar nga ana juaj, është 27 359 534 euro pa TVSH dhe jo 28 milionë euro, sepse janë shumë, janë edhe 700 mijë euro dhe nuk besoj se keni mundësi t’i përballoni. Kjo është pa TVSH. Në lekë është 3,7 miliardë lekë. Ndërkohë, vlera që unë po citoj, 3,7 miliardë, 3 763 851 097 lekë, sipas Drejtorisë së Thesarit, është ezauruar dhe kanë ngelur pa mare vetëm 248 lekë, i nderuar.

Loran Dusha – Këtë gjë unë nuk e konfirmoj, sepse shoqëria ka për të marrë akoma lekë, nuk i ka marrë të gjitha, siç pretendoni ju.

Lefter Gështenja – Unë nuk pretendoj, por këto janë me shkresa zyrtare të vëna në dispozicion nga institucionet.

Loran Dusha – Me shkresa i kam edhe unë. Shoqëria nuk i ka marrë të gjitha paratë.

Faleminderit!

Lefter Gështenja - Si ka mundësi, i nderuar, që në ofertën e dorëzuar nga ana juaj nuk ka të parashikuar as fluturime me avion, as sponsorizim në media, as tallava, por janë punime civile, makineri, lidhje me sistemin elektro-energjetik, që kushton 266 000 euro, por që sot që ne flasim kjo nuk është bërë, sepse nuk është certifikuar. Pra, impianti nuk është lidhur me sistemin elektroenergjetik edhe pse kompania ka marrë 266 mijë euro. Mund të më shpjegoni çfarë ka ndodhur, pse nuk janë parashikuar në preventivin e ofruar nga ana juaj të gjitha këto që cilësova?

Loran Dusha – Biznes-planin nuk e kam bërë unë, sepse në atë periudhë unë nuk kam qenë dhe nuk di t’ju them.

Lefter Gështenja - Faleminderit dhe të shkuara!

Loran Dusha – Faleminderit!

Jorida Tabaku – Unë kam grupin e fundit të pyetjeve për zotin Dusha!

Ju përmendët disa herë kolauduesin. Përfaqësuesi juaj teknik në një deklaratë kur Kryeministri ishte atje në fushatën e prillit 2021, tha po të njëjtat fjalë që thatë ju tani dhe po të njëjtat fjalë që u thanë para një jave kur kolegët ishin atje: “është në proces kolaudimi, për 35 ditë nuk kolaudohet”.

Çfarë ndodhi nga prilli deri më sot që nuk përfundoi procesi i kolaudimit?

Loran Dusha – Është një vepër shumë e madhe dhe ka pasur edhe vonesa të tjera nga pjesët ...

Këtë nuk mund ta sqaroj dot, sepse nuk jam inxhinier, por di të them që është drejt përfundimit.

Jorida Tabaku – Pra, ju e gënjyet publikisht Kryeministrin e vendit që do edhe 35 ditë, në fushatë elektorale, kur varej e ardhmja e Partisë Socialiste në pushtet. Pse nuk po na gënjeni edhe ne?

Loran Dusha – Zonjë, në punë dalin edhe të papritura. Të merrem pse i thashë atij, pse i thashë këtij, unë nuk ...

Jorida Tabaku – Pse mund të mos na gënjeni edhe ne këtu në komision duke na thënë që do edhe 35 ditë?

Loran Dusha – Ajo që po ju them është që insineratori i Fierit është drejt përfundimit të kolaudimit. Kjo është përgjigja ime.

Jorida Tabaku – Patjetër.

Si është zgjedhur kolauduesi? Cila është kompania kolauduese?

Loran Dusha – Secili agregat ka inxhinierët e vet, që bëjnë kolaudimin.

Jorida Tabaku - Nuk më duhen inxhinierët, por si është përzgjedhur kompania kolauduese dhe cila është?

Loran Dusha – Është nënkontraktori.

Jorida Tabaku - Si quhet kompania kolauduese dhe si është përzgjedhur?

Loran Dusha – Nuk më kujtohet.

Jorida Tabaku – Urdhëro? Nuk ju kujtohet as kjo, cila është kompania kolauduese?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk më kujtohet, tha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Në fakt, Covid-i ka pasojë edhe humbjen e memories.

Loran Dusha - Zonjë, mos bëj ironi me mua!

Jorida Tabaku – Jo, zotëri, po ju flas drejtpërdrejtë, nuk kam nevojë të bëj ironi me ju.

Këtu në këtë komision sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës na informoi që supervizori është AVE Consulting, që, në fakt, ne e kishim nga shkresat, dhe është i njëjti supervizor për të tri insineratorët; për Elbasanin, për Fierin dhe për Tiranën.

Ju lutem kolegë, nuk dëgjoj dot.

Si është përzgjedhur supervizori?

U zhduk Lorani.

Ju lutem, e dëgjuat pyetjen deri në fund.

Si është përzgjedhur supervizori AVE Consulting?

Loran Dusha - Me anë të autoritetit kontraktues.

Jorida Tabaku - Kontrolli i Lartë i Shtetit thotë që e keni propozuar ju.

Loran Dusha – Unë mund ta kem propozuar, por nuk e kam zgjedhur unë. Propozimi është tjetër gjë dhe përzgjedhja është tjetër gjë, se mund të kenë qenë tre persona që ...

Jorida Tabaku – Dakord, këtë po kuptoj. Nuk është faji juaj që autoriteti kontraktues ka zgjidhur atë që keni propozuar ju, kjo është e qartë, problemi është që supervizori firmos situacione, të cilat i merr të mirëqena ministria. Këtu është konflikti i interesit që ne po diskutojmë.

Cila është kompania audituese që ju keni?

Loran Dusha – Është ekspert i pavarur.

Jorida Tabaku – Kush është eksperti i pavarur?

Loran Dusha – Nuk e mbaj mend mirë, Lavdrim më duket se quhet.

Jorida Tabaku – Po, zoti Lavdrim Fusha është ekspert i pavarur që punon për zonjën Stela Gugallja në kompaninë e saj të auditimit.

Nuk gjykoni që është konflikt interesi që edhe auditorin, edhe supervizuesin i zgjidhni ju dhe autoriteti kontraktor ju merr të mirëqenë çdo gjë që ju i çoni?

Loran Dusha – Zonjë, të gjitha punimet ndiqen nga supervizioni.

Jorida Tabaku - Që keni propozuar ju. Këtë po them. Po flas për audituesin tani.

Loran Dusha - Audituesi është privat.

Jorida Tabaku - Patjetër, është zoti Lavdrim Fusha, i cili është punonjës i zonjës Stela Gugallja në biznesin e saj.

Loran Dusha - Nuk e di ku është punonjës, thashë që është privat. Nuk e di që të jetë punonjës.

Jorida Tabaku – Jua them unë, sepse kam ekstraktet e Qendrës Kombëtare të Biznesit, që është në marrëdhënie biznesi me zonjën Stela Gugallja. Pra, këtu kemi një problem shumë të rëndë, në gjykimin tim, që autoriteti kontraktor ka financuar dhen nuk ka kontroll.

Loran Dusha – Unë nuk kam dijeni se çfarë marrëdhëniesh ka iksi apo ipsiloni.

Jorida Tabaku - Patjetër, ju nuk i dini, nuk i mbani mend.

Nga i gjeneron të ardhurat kompania juaj, përveç buxhetit të shtetit?

Loran Dusha - Për momentin, përveç buxhetit të shtetit, kompania nuk ka të ardhura të tjera.

Jorida Tabaku - Nuk ka të ardhura të tjera shtesë. Atëherë, pse ishte e nevojshme të merrnit një kredi me garanci sovrane kur pagesat e buxhetit të shtetit nuk kanë ndaluar në asnjë moment në vitin 2019? Sapo deklaruat që keni marrë 69 milionë lekë për pagat.

Loran Dusha – Po, për pagat.

Jorida Tabaku – Po, por pagat ju i paguani me të vetmet të ardhura nga buxheti i shtetit, që nuk kanë ndaluar për asnjë ditë. Për çfarë duhej shtesë garancia sovrane?

Loran Dusha – Zonjë, në periudhën e pandemisë ka pasur edhe vonesa në pagesa.

Jorida Tabaku - Asnjë vonesë nuk ka pasur për koncesionarin e Fierit në pagesa, por janë paguar të gjitha një për një. Kam pagesat e thesarit.

Loran Dusha – Dakord, kjo është përgjigja ime. Më pyete pse e ke marrë dhe unë po ju them që e kam marrë për të shlyer pagat e punonjësve në periudhën e pandemisë.

(Diskutime pa mikrofon)

Jorida Tabaku - Ju lutem! Një grup kompanish, për shembull, kompania Frogi, kompania Amco&Co, Alpha Power, Elvis03 Group, Alber Co&Co, AA 117, MP&A Company, GleVan, EZ&La, janë kompani, një pjesë e tyre, të akuzuara për mashtrime me faturat në vitin 2016. Administratori i kompanisë Frogi, në fakt, ka qenë edhe i arrestuar. Janë kompani nënkontraktore të tjera, përveç Klodian Zotos në biznesin tuaj, të provuara që kanë xhiruar fatura fiktive për TVSH-në. A e mbani mend se çfarë punimesh kanë kryer për ju këto kompani?

Loran Dusha - Nuk kam dijeni, sepse nuk kam qenë në atë periudhë.

Jorida Tabaku – A keni qenë në vitin 2018? Ju thashë, kjo kompani tek inceneratori i Elbasanit është gjendur me fatura fiktive, ndërkohë të njëjtat kompani kanë vazhduar kanë marrë punë deri para 6 muajsh, edhe te Fieri.

Loran Dusha - Unë po jua shpjegoj, nuk kam dijeni për çfarë po thoni.

Jorida Tabaku – Nuk ju kuptova.

Loran Dusha - Nuk kam dijeni.

Jorida Tabaku – Që keni paguar kompani që s'kanë kryer punë, kanë xhiruar fatura fiktive, ju, administratori i koncesionarit?

Loran Dusha - Zonjë, unë kam filluar më datë 28 gusht të 2017-s, se çfarë punimesh janë bërë më përpara, nuk kam dijeni, sepse nuk kam qenë.

Jorida Tabaku - Flas pas asaj periudhe. U referohem viteve 2018, 2019, 2020. Kësaj periudhe i referohem dhe unë.

Disa nga këta janë kontraktorë.

Loran Dusha – Dëgjo, ka kompani nënkontraktore, që mund të kenë kryer punime dhe janë pagesa të prapambetura. Nuk e di për çfarë po flisni. Në dijeninë time nuk di që ka fatura fiktive.

Jorida Tabaku – E kuptoj. Në autoritetin kontraktues, kush është personi *counterparty* juaj, me të cilin keni kontakte për punën tuaj?

Loran Dusha - Edhe një herë, ju lutem.

Jorida Tabaku – Në autoritetin kontraktues, cili është kontakti përgjegjës, për kontratën tuaj koncesionare?

Loran Dusha – Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjetikës.

Jorida Tabaku – Cili është kontakti juaj përgjegjës në ministri? Me kë komunikoni?

Loran Dusha – Nuk e mbaj mend.

Jorida Tabaku – A jeni administratori i kompanisë? Nuk e mbani mend se ku i nisni shkresat?

Loran Dusha – Po, unë jam administratori i kompanisë. Nuk e mbaj mend.

Jorida Tabaku - Po çfarë mbani mend si administrator i kompanisë gjatë kësaj periudhe?

Loran Dusha - Zonjë, unë po ju jap përgjigjen time.

Ju lutem, mos...

Unë nuk mbaj mend.

Jorida Tabaku - Nuk mbani mend asgjë për atë që dorëzoni me firmën tuaj?

Loran Dusha - Nuk mbaj mend personin, kush është personi X apo Y. Nuk e mbaj mend.

Jorida Tabaku – Nuk e mbani mend! E kuptova.

(Debat pa mikrofon në sallë)

Atëherë, të nderuar kolegë, që t’i japim leje edhe zotit Dusha, ju lutem!

(Debat pa mikrofon në sallë)

Ju lutem!

Ju lutem, kolegë!

Unë jam jashtëzakonisht e shqetësuar, se këtu bëhet fjalë për fonde publike, bëhet fjalë për garanci sovrane, kredi me garanci sovrane, bëhet fjalë për fonde publike. Po flasim për 23 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon në sallë)

Jo, private, nuk ka.

Nuk kam të ardhura të tjera, tha.

(Debat pa mikrofon në sallë)

Zoti Gështeja, vazhdoni pyetjet.

Lefter Gështenja – Zonja kryetare, faleminderit!

I nderuar, ju thatë se keni licencë për incenerimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane.

(Ndërhyrje pa mikrofon në sallë)

Faleminderit, zoti Xhafaj!

Ju thatë që keni licencë për incenerimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon në sallë)

A ka mundësi...

Për çfarë nuk më lë të flas?

(Ndërhyrje pa mikrofon në sallë)

A ka mundësi të më lini të flas?

(Ndërhyrje pa mikrofon në sallë)

Ç’lidhje ka?

Po lëre avokatinë tani, muhabet kot.

A ka mundësi të më thoni, i nderuar, cila është kontrata e parë që ju keni realizuar për të marrë licencën? Pra, që të jesh i licencuar në këtë fushë, do të thotë që të kesh një kontratë të lidhur, kompania juaj, çfarë kontrate ka pasur, përpara se të bënte kontratën e Fierit? Cila është kontrata për të cilën është licencuar për herë të parë?

Faleminderit!

Loran Dusha – Nuk e mbaj mend. Nuk më kujtohet.

Lefter Gështenja – Gjithsesi, është e qartë që administratori s'është administrator. Tjetërkush duhet të jetë administrator.

Gjithsesi, unë e falënderoj për disponibilitetin, që ishte sot në këtë konferencë live.

Jorida Tabaku – Edhe unë e falënderoj zotin Dusha.

Për zotin Dusha kam vetëm një kërkesë: çdo gjë që nuk mban mend, të lutem, mbaje mend përpara SPAKU-t. Është shumë e rëndësishme të shpëtosh veten. Mund të kesh lidhje të vjetra biznesi me Klodian Zoton, Mirel Mërtirin dhe Stela Gugalljan, por të lutem mbaje mend përpara SPAKU-t.

Të nderuar kolegë, e falënderojmë zotin Dusha!

I urojmë shëndet në ditët në vijim dhe shpresojmë që sa më shpejt t'u japim informacion qytetarëve, se çfarë ka ndodhur me lekët që nuk mbahen mend, të shpenzuara për inceneratorin e Fierit.

Faleminderit, zoti Dusha!

Antoneta Dhima – Më vjen mirë kryetare që e kuptove, se zotëria ishte i sëmurë dhe e pranove.

Jorida Tabaku – Përpara se të fillojmë me dëshmitarin tjetër, kam një njoftim për anëtarët e komisionit.

Diskutuam sot në mëngjes për praninë e zonjës Arjola Kodra, e pritëm në mëngjes, por nuk erdhi. E ftuam në orën 15:00. Staf i Kuvendit dhe posta e posaçme e Kuvendit shkuan në inceneratorin e Tiranës, i cili është i mbyllur. Punonjësi ka mbyllur derën dhe tha që nuk ndodhet asnjë nga stafi i inceneratorit i pranishëm në kantier. I kemi nisur një kërkesë tjetër me postën speciale zonjës Arjola Kodra, kemi marrë disa herë në telefon, do ta ripërsërisim edhe një herë kërkesën tonë që ajo të jetë këtu në komision.

Ndërkohë, na ka sjellë një pjesë të informacionit që kërkuam ditën e premte.

I bëjmë thirrje zonjës Arjola Kodra, punonjësve të inceneratorit të Tiranës, të hapin derën, të pranojnë shkresën e Kuvendit, janë letra zyrtare të shteti shqiptar. Ju lutem, merreni njoftimin për të ardhur, për të dëshmuar.

Zonja Denaj.

Zonja Dhima.

Anila Denaj – Më vjen mirë që e rifrazuat kërkesën, ndryshe nga mëngjesi kur përmendet policinë, forcën.

(Kryetarja e komisionit Jorida Tabaku ndërhyr pa mikrofon.)

Ta mbaroj pak, të lutem.

Jo, nuk keni të drejtë ligjore, sepse nuk mundet të intimidoni përsëri me polici, kur rregullat e një formimi, të cilat lidhen si me afatin 48-orësh, ashtu edhe me konfirmimin e njoftimit, vlejné për këtë komision, pastaj nëse të dyja janë të konfirmuara dhe dëshmitari nuk paraqitet, ju keni të drejtën të flisni për forcë, për polici dhe të tjera. Asnjë nga këto të dyja nuk është konfirmuar dhe nëse i bëni referencë diskutimit këtu, kur ishte prezente zonja, në dijeninë time, ne i kemi kërkuar dokumente, sigurisht mund të kërkonit atë dhe këdo tjetër për të ardhur, për të dëshmuar, por duhet sipas rregullave. E para me shkrim, e dyta konfirmim që e ka marrë njoftimin dhe e treta 48-orëshi.

Prandaj, përpara se të përdorni forcën si koncept, përdorni ligjin dhe shkresën.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Po, zonja Denaj, ditën e mërkurë, bashkë me zonjën Dhima nisëm një shkresë të dytë për zonjën Arjola Kodra. Sot në mëngjes u nis një shkresë e tretë për zonjën Arjola Kodra, ashtu siç e parashikon ligji. Kemi përdorur të gjitha instrumentet që na lejon ligji. Mbas herës së tretë, do t'i kërkojmë zonjës të paraqitet këtu me forcën e Policisë së Shtetit.

(Deputetja Anila Denaj flet pa mikrofon nga salla.)

Po, sigurisht. Ligji nuk është interpretim.

Ju lutem!

Unë ju mirëkuptoj kur vijnë këtu përfaqësues zyrtarë dhe i mbroni, por përfaqësuesit e kompanisë, ju lutem!

Mos i mbroni, po largohen të gjithë.

(Deputetja Anila Denaj flet pa mikrofon nga salla.)

Kaq. Patjetër, zonja Denaj, ju kërkoj vetëm që t'u referoheni shkresave zyrtare të komisionit për t'i lexuar.

Zonja Dhima, të lutem.

(Debat pa mikrofon në sallë)

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Në vijim të dëshmisë të dhënë nga zonja Kodra, në sekretarinë e komisionit, është depozituar një kopje e dokumenteve që iu kërkua në dëshminë e dhënë nga ana e saj, ku përfshihen pasqyrat financiare të viteve, 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Situacionin progresiv të periudhës tetor, nëntor, dhjetor, 2021. Grafiku i rishikuar i punimeve. Lista e sponsorizimeve të kryera nga shoqëria për periudhën 2018- 2022, si dhe lista e nënkontraktorëve. Besoj se edhe juve ju është vënë në dispozicion ky dokumentacion.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zonja Dhima, edhe unë këtë thashë, ndoshta nuk dëgjoni, ndoshta edhe unë e kam vesin e keq që s'dëgjoj, se kur jemi këtu flasim që të gjithë.

(Deputetja Antoneta Dhima flet pa mikrofon në sallë.)

Një pjesë, se për shembull leja paraprake nuk ka ardhur.

Antoneta Dhima – Kryetare, unë...

Jorida Tabaku – Kërkuam formularin e vetëdeklarimit, nuk ka ardhur.

Antoneta Dhima – Unë thashë që ka ardhur një pjesë e dokumentacionit.

Jorida Tabaku – Po, një pjesë ka ardhur.

Antoneta Dhima – Unë specifikova se çfarë dokumentacioni ka ardhur, sepse komisioni duhet të vihet në dijeni me dokumentacionin që ka ardhur.

Kaq.

Jorida Tabaku – Patjetër.

Antoneta Dhima – Thjesht, qartë.

Jorida Tabaku – Dhe bukur.

Unë i kërkoja zonjës Kodra, që të vinte. Ia shprehëm kërkesën në komision, i nisëm shkresën zyrtare sipas ligjit, i nisëm shkresën e dytë zyrtare sipas ligjit, ndoshta edhe ndonjë gabim në radhë mund ta kemi bërë në të shkuarën, po për zonjën Arjola Kodra ishim shumë të qartë.

Unë i bëj thirrje SPAK-ut dhe institucioneve përgjegjëse, të marrin masa dhe shpresojmë që zonja mos të na largohet, si 3 zotërinjtë që janë shpallur sot në kërkim. Unë dua të bëjmë vetëm dy minuta pushim për të ajrosur sallën dhe ftoj dëshmitarin e radhës.

(Pas pushimit)

Ju lutem!

Atëherë, ju lutem!

Të nderuar kolegë, jemi gati për rifilluar mbledhjen. I kërkoj teknikës të fillojmë të lidhemi.

Zoti Florian Muçaj është nga komisioni i koncesionit të inceneratorit të Fierit. Zoti Muçaj erdhi edhe dy ditë më parë, por ne kishim një mosmarrëveshje me njëri-tjetrin dhe ka ardhur prapë sot.

Zoti Muçaj, përpara se të fillojmë deklaratën tuaj, unë dua t’ju kujtoj rregulloren e brendshme të komisionit. Dëshmia juaj do të merret pas kryerjes së betimit nga personi i thirrur. Betimi bëhet sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale: “Beto hem se do të them të vërtetën, gjithë të vërtetën dhe asgjë që nuk është e vërtetë”. Beto hem!”

Florian Muçaj – Beto hem!

Jorida Tabaku – Zoti Muçaj, a mund të bëni një prezantim tuajin përpara këtij komisioni?

Florian Muçaj – Në lidhje me?

Jorida Tabaku – Me pozicionin tuaj të punës, ku jeni. Një prezantim.

Florian Muçaj – Atëherë, unë jam Florian Muçaj, administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a.

Jorida Tabaku – Në komisionin e koncesionit të Fierit, keni qenë si përfaqësues pozicionit aktual apo një pozicioni tjetër?

Florian Muçaj – Jo, në atë kohë unë kam qenë administrator i përgjithshëm i bashkisë Fier dhe kam qenë si përfaqësues i bashkisë Fier, por përpara se të vazhdoj me dëshminë time, dua t’ju informoj se...

Jorida Tabaku – Po, prit, se për atë do t’ju pyes.

A gjykoni se ka një konflikt? A jeni thirrur nga institucionet përkatëse të drejtësisë? Jeni pjesë e hetimit?

Florian Muçaj – Po. Jam thirrur nga SPAK-u për prezencën time në komisionin e inceneratorit të Fierit. Kam dhënë dëshminë time si pjesë e hetimit që zhvillohet prej tyre, kështu që unë kam ardhur këtu në respekt të këtij komisioni, por nuk mund të vazhdoj të jap dëshmi në lidhje me atë çështje, sepse çdo gjë që mund të them këtu, mund të përbëjë një prishje të hetimit, që është duke u zhvilluar nga SPAK-u.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Jeni thirrur në cilësinë e dëshmitarit, të hetuarit? Ka një akuzë ndaj jush apo thjesht deklaruës?

Florian Muçaj – Kam dhënë dëshminë në kuadër të hetimit që është duke zhvilluar SPAK-u, kështu që për këtë çështje unë nuk mund të shprehem askund tjetër, deri në përfundimit të hetimeve nga ana e tyre, përveçse me një autorizim nga ana e tyre.

Jorida Tabaku – Në cilin ligj e bazoni këtë ose çfarë keni firmosur?

Florian Muçaj – Në momentin kur kam dhënë dëshminë përpara SPAK-ut jam informuar prej tyre, përpara se të filloja të jepja dëshminë, që nuk mund të flisja për këtë çështje me askënd tjetër.

Jorida Tabaku – Ndërkohë, sipas komunikimeve dhe informacionit që ne kemi marrë, vetëm personat që kanë marrë njoftim si të paditur në këtë çështje, si në rastin e komisionit të inceneratorit të Elbasanit...

(Debat pa mikrofon nga salla)

Ju lutem, kolegë, do flasim të gjithë!

Ju lutem!

...të cilët na erdhën këtu me një shkresë nga SPAK-u, ku thuhej: “Ky informacion...” dhe i gjithë komisioni ishte dakord me atë, ndërkohë për ju nuk kemi asnjë gjë.

Florian Muçaj – Për sa i përket çështjes së marrjes së informacionit nga ana e SPAK-ut kjo është detyra juaj. Ju merreni informacionin nga SPAK-u dhe pastaj në qoftë se SPAK- u ju konfirmon që unë mund të vij dhe të jap deklaramë në lidhje me një çështje në hetim, atëherë vazhdojmë. Këtë duhet ta keni me shkrim, në të kundërt...

Jorida Tabaku – Nuk ka pse ta interpretojë SPAK-u, ju lutem.

Florian Muçaj – Në të kundërt, unë nuk mund të jap asnjë deklaratë tjetër. Bashkë e mbyllëm. Unë erdha sa për të qenë prezent këtu. Unë nuk flas më, ju vazhdoni.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Ju lutem, se çfarë është puna ime, e di unë se çfarë është puna ime!

Ju lutem, të ruajmë etikën të gjitha palët dhe t’i drejtohem njëri-tjetrit me respekt! Besoj se ky është minimumi, për ne këtu dhe për ju, që vini uleni atje. Nuk kam nevojë unë t’i shkruaj SPAK-ut asnjë shkresë, që të më konfirmojë për ju. Na e lejon ligji, për sa kohë që ju nuk jeni i paditur.

Për komisionin e inceneratorit të Elbasanit ne u informuam të gjithë, të gjithë e pamë shkresën, që na vendosën në dispozicion, që ishin të paditur, pamë çfarë kishin firmosur dhe të gjithë ramë dakord, se nuk do ta vazhdonin dëshminë, sepse ata ishin në atë orë.

Zoti Pëllumbi, keni ndonjë gjë për të thënë, për këtë çështje?

Arben Pëllumbi – Në bazë të Kodit të Procedurës Penale, i cili është edhe udhëzuesi i këtij, komisioni, ne nuk mund ta detyrojmë dëshmitarin të përgjigjet përpara këtij komisioni. Dëshmitari është paraqitur për respekt të komisionit dhe po deklaron që ai nuk dëshiron të vazhdojë të përgjigjet për pyetjet apo ato që kemi ne në lidhje me të, sepse mendon se mund të rëndojë pozitën e tij në raport me një hetim që po kryhet. Besoj se kjo është linja që duhet të ndjekim, atë që kemi thënë që në fillim, hetimi ynë nuk duhet t’i mbivendoset atij që është prioritar, hetimit penal që po zhvillon institucioni i specializuar për këtë çështje.

Jorida Tabaku – Unë e kuptoj shumë mirë çfarë thoni e kuptova edhe atë që tha zotëria, ne nuk e detyrojmë dot atë të përgjigjet. Ne e detyrojmë atë të vijë këtu në këtë komision përpara dhe të dëgjojë pyetjet, refuzimi për të dëshmuar përbën vepër penale, meqenëse ju thatë se Kodi i Procedurës Penale është udhëzuesi ynë. Unë nuk i them dot zotërisë: përgjigju kësaj pyetjeje, përgjigje asaj pyetjeje. Unë i bëj pyetjet, zotëria më thotë: nuk përgjigjem. Kaq.

Atëherë, fillojmë me pyetjet.

Antoneta Dhima - Zonja kryetare.

Jorida Tabaku – Për procedurë?

Antoneta Dhima - Po, për procedurë.

Jorida Tabaku – Po.

Antoneta Dhima – Më vjen keq, zonja kryetare, ju nuk mund të merrni atributet e SPAK-ut. Dëshmitari sapo tha: “Unë jam person nën hetim, jam thirrur nga SPAK-u, kam dëshmuar atje dhe nuk mund të jap dëshmi pranë këtij komisioni”. Të respektojmë dëshmitarin sipas Kodit të Procedurës Penale. Sapo e tha edhe zoti Pëllumbi, ne jemi këtu për të zbatuar ligjin dhe nuk mund të intimidojmë dëshmitarët, t’i detyrojmë ata të prononcohen në këtë komision, kur nuk kanë

dëshirë dhe kur ata kanë dëshmuar në një organ, i cili përbën sekret hetimor për komisionin edhe për vetë personin.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Unë mendoj se e kemi diskutuar njëherë këtë problem, pavarësisht se Jorida e përforcoi me shembullin e anëtarëve të komisionit të koncesionit të Elbasanit. Ne vërtetë e dëgjuam dëshmitarin, kur u betua, se do thotë të vërteten, por nuk jemi provuesit e së vërtetës. Edhe në rastin kur ai thotë “dëshmitar”, unë njerëzisht e pranoj, por zyrtarisht, mua si anëtar i komisionit hetimor më duhet një vërtetim shkresor që ai është thirrur dhe le të mos flasë. Por tani mund të vijmë të gjithë të thonë: jemi thirrur dëshmitarë dhe nuk përgjigjemi. Të gjithë mund të vijojnë pas këtij rasti, si një arsye...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Po, mirë janë nën betim, edhe ne nuk e dënojmë atë më pas në qoftë se e thyhen betimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Në qoftë se për ato pyetje, që ai mendon se rrezikohet dëshmia e tij, mendon se nuk duhet të japë një përgjigje, mos të japë përgjigje (pasi ne patëm përvojën tjetër të mëparshme, nuk po e referoj si formulë, sepse nuk është e domosdoshme, në qoftë se e ka ndjekur, e ka ndjekur), edhe për ato përgjigje që ai mendon se e cenojnë dëshminë e tij, le mos i japë. Nuk ka asgjë të keqe, se ne nuk e vërtetojmë dot.

Dakord jam unë, nëse vjen nga SPAK-u me një shkresë, e cila vërteton se është nën hetim, se nuk e pranoi që është nën hetim, ne duhet të vazhdojmë me pyetjet, pastaj, vetë dëshmitari t’i mendojë se cila pyetje e rrezikon në dëshmi, cila pyetje e rrezikon dëshminë që ka dhënë apo mund të jetë edhe pyetje që e ndihmon në dëshminë e tij apo mund ta përforcojë, është shumë e thjeshtë. Në këtë rast lehtëson edhe pozitën e vet.

T’ia japim këtë mundësi të paktën.

Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Faleminderit kryetare!

Neni 156 i Kodit Penal, Papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit, thotë: “Nuk mund të pyeten si dëshmitarë: personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt (këtë e kam për atë që bëjnë përpara); të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur, kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit të akuzës ose çështjes, ose i dënimit, duke përfshirë edhe

rastet e gjykimit me marrëveshje dhe të urdhrit penal të dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë”.

(Kryetarja e komisionit Jorida Tabaku ndërhyr pa mikrofon.)

Një sekondë. Po, po, bazuar mbi atë.

Ta mbaroj, unë, zoti Xhafaj, meqë ma dhatë fjalën, mos ma merrni prapë, se është bërë pak procedurë kjo, në këtë mes.

Ne jemi komision hetimor në bazë të vendimit nr. 81/ 2021 të Kuvendit të Shqipërisë, i cili na tregon atributet dhe e ka të detajuar, të shkruar nga opozita objektin e punës së komisionit hetimor, i cili ka lidhje me zbatimin e ligjeve, procedurave dhe veprimtarive të organeve publike, procedurave të ndërtimit.

Tani, për pyetjet me dëshmitarin e mëparshëm, i cili fatkeqësisht, siç e pamë të gjithë, ishte në gjendje të paaftësisë fizike, shkuam deri në nivelin sa i bëmë pyetje: ku shkon pa kapelë apo çfarë bluze ke veshur.

(Kryetarja e komisionit Jorida Tabaku ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, pyetja nuk ka lidhje fare...

Nuk është interes publik bluza e dëshmitarit dhe nuk mund të jetë në asnjë rast.

Shikojeni, do ta zbardhni edhe në procesverbal dhe do ta shikoni.

Së dyti, jemi të gjithë koshientë se ky hetim, ky komision hetimor parlamentar është duke u zhvilluar paralelisht me një hetim aktiv nga prokuroria speciale dhe, për pasojë, jemi të gjithë koshientë që asnjë nga anëtarët e këtij komisioni nuk mund ta ndërpresë apo ta pengojë. Nuk po them se kjo do të bëhet apo mund të bëhet me vullnetin tonë, të gjithsecilit këtu, apo të dëshmitarëve, por mund të ndodhë edhe në mënyrë të pavullnetshme, ku detaje që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me hetimin dhe përbëjnë sekret hetimor për një hetim aktiv, mund të dalin e të prishin atë që është një proces, i cili është duke u zhvilluar.

Asnjëri nga ne nuk ka asnjë presupozim që hajde pengojmë apo jo. Ky është një hetim aktiv duke u zhvilluar. Zotëria na tha që është thirrur. Tani në çfarë grade është thirrur, përsëri mund të përbëjë sekret të hetimit dhe nuk mund ta paragjykojmë të gjithë këtë meqë objekti është hajde t'i marrim dhe, siç ka ndodhur deri tani, t'i kryqëzojmë publikisht duke nxjerrë emra e duke bërë gjithfarëlloj supozimesh për lidhje dhe njohje të bizneseve apo të emrave që janë në të njëjtat fusha dhe t'i hedhim aty publikisht.

Unë po them vetëm këtë. Ne duhet t'i përmbahemi kësaj. Hetimi është aktiv deri në marrjen e atij vendimi që do të vijë si pasojë e mbylljes së hetimit që është duke u zhvilluar nga prokuroria speciale. Ne nuk mund të marrim në pyetje njerëz që janë pyetur nga prokuroria, se edhe ne vetë do të jemi dëshmitarë të një veprë penale.

Prandaj, ju lutem, ta mirëkuptojmë këtë fakt dhe faktin që organet kompetente të drejtësisë janë duke hetuar. Ka organe kompetente ligji, të cilat zbatojnë Kodin Penal.

Ky komision bazohet te Kodi Penal. Zbatimin e ka për detyrë dhe prerogativë prokuroria e shtetit shqiptar, e ngritur me ligjet e kësaj republike, të këtij parlamenti dhe të kësaj godine, ku ne jemi ulur sot për këtë komision hetimor.

Faleminderit!

Dhurata Çupi – Që të jemi të qartë edhe për opinionin publik, se po bëjmë sikur ju po mbroni hetimin në SPAK. Të jemi të qartë që kallëzimin në SPAK e kemi bërë ne, që kërkesën për komisionin hetimor këtu e kemi bërë ne, provat dhe denoncimet në SPAK, çfarë kemi pasur prova, i kemi denoncuar. I kemi dosjet dhe ia kemi dërguar SPAK-ut dhe SPAK-u është bazuar në atë çfarë ne i kemi dëgjuar dhe ka filluar hetimet dhe tashmë keni një ministër tuajin në burg.

Se po krijohet këtu ideja sikur ju po mbroni SPAK-un, hetimet dhe ne po i ndërpresim. Jo, zotërinj, dhe qytetarët janë shumë të mençur dhe na kuptojnë. Kallëzimin në SPAK e kemi bërë ne, kërkesën për komision hetimor e kemi bërë ne dhe ne nuk kemi asnjë lloj tendence t'i pengojmë hetimet atje. Përkundrazi, ne jemi shumë të interesuar.

Diskutimi është për t'u qëndruar edhe parimeve, mbi të cilat ne punojmë, edhe ligjit për komisionet hetimore, por edhe Kodin e Procedurës Penale, që ju na e citoni, dhe nenin 156, pika "b", po themi që nuk e cenon.

Zotëria dëshmitar nuk e sqaroi qartë pozitën e tij juridike lidhur me hetimin atje, por bëri betimin këtu, ndërkohë deklaroi se unë jam paralajmëruar në SPAK që nuk duhet të jap sqarime mbi atë çfarë është pyetur, por dëshmitari nuk mund t'u shmanget pyetjeve tona, aty ku nuk cenon sekretin hetimor, që ai e gjykon sekret hetimor, dhe aty ku ai e ndihmon edhe komisionin hetimor, se për këtë punë jemi këtu. Komisioni hetimor të bëjë punën e vet sa i takon komisionit hetimor, pa cenuar aspak dosjen hetimore në SPAK dhe pa cenuar edhe pozitën juridike të tij.

Ai bëri një betim dhe, nëse ai nuk ka thënë të vërtetën dhe, në fakt, nuk është paralajmëruar nga SPAK-u, atëherë mban përgjegjësi. Këto janë seanca publike, ndërkohë SPAK-u patjetër që do ta ndjekë, prandaj zotëria duhet të jetë i përgjegjshëm aty ku nuk cenon

sekretin hetimor dhe, lidhur me pyetje që i janë bërë atje, do ta ndihmoni edhe komisionin hetimor për t'i dhënë sqarimet e duhura.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja kryetare, e dëgjova me shumë vëmendje dhe, në fakt, e tha qartë që është instruktuar, në fakt përdori fjalën “informuar” që të mos japë deklarata në lidhje me çështjen, për të cilën është thirrur. Unë kam një kërkesë. Unë do të doja nga zotëria, nëse e ka me vete fletëthirrjen e SPAK-ut, (nëse nuk e ka) të na e vendosë në dispozicion në një moment të dytë fletëthirrjen e SPAK-ut.

(Diskutime në sallë.)

Jorida Tabaku – Ju lutem, kjo nuk është bisedë mes nesh!

Zotëria t'i përgjigjet zotit Shalsi, pastaj e ka fjalën zoti Boçi për procedurë.

Florian Muçaj – Atje ku më kanë thirrur, njoftimin ma kanë bërë me telefon, ashtu si edhe sot, për të ardhur këtu në komision njoftimin e kam marrë me telefon, jo me fletëthirrje.

Luçiano Boçi – Deri më tani, përgjatë këtij hetimi parlamentar, përfaqësuesit e maxhorancës për Fierin dhe Tiranën janë mbrojtur me faktin që nuk ka akuzë penale, nuk është vepër nën sekuestro, madje edhe, kur e quajmë Elbasanin “vepër krimi”, ju revoltoheni. Realisht, sipas gjuhës suaj juridike, në Fier dhe në Tiranë nuk ka akuzë penale dhe, kur nuk ka akuzë penale, nuk ka as dëshmitarë dhe as persona nën hetim, ka persona në dijeni të ngjarjes. Personat në dijeni nuk janë as dëshmitarë dhe as persona në hetim, se nuk ka akuzë penale ndaj Fierit. Pse bëjmë sikur s'e dimë? Për Elbasanin kemi vendosur, ka akuzë penale dhe ramë në konsensus për atë gjë dhe u shtua edhe shkresa reale konkrete.

Tani ne këtu jemi, nuk duhet të parashikojmë, të presupozojmë. Në qoftë se ka diçka zyrtare, edhe pse nuk ka akuzë penale për Fierin dhe Tiranën, sepse zotëria është anëtar i komisionit të koncesionit të Fierit, atëherë ne mund të vazhdojmë shumë mirë, nuk na pengon, pra ne mund të vazhdojmë shumë mirë me pyetjet pa u penguar fare ligjërisht. Vetë jemi mbrojtur, s'ka akuzë ndaj Fierit, Fieri është në rregull, madje do të punojë, Tirana, gjithashtu, nuk është vepër krimi. Atëherë, pse pengohemi ne?! Ju këndeje mohoni, këndeje pranoni në rastin kur ju intereson, por thjesht një dëshmi në komisionin hetimor. Pra, të mos hezitojmë, nuk na pengon asgjë nga ana ligjore.

Besion Ajazi – Faleminderit, kryetare!

Ndoshta nuk ka njerëz të marrë nën hetim apo të tjerë, por që ka një proces penal ka dhe kjo është e deklaruar. Personi që ne kemi thirrur sot për dëshmitar në komisionin tonë tha që unë e ka dhënë një dëshmi atje dhe ndoshta ato që ai ka dëshmuar në SPAK nuk ka pse ne të na i vërë në dispozicion dhe nuk ka pse komisioni të njihet me letra që SPAK-u do të njihet vetëm ai me ato letra; e para.

E dyta, ne prej kohësh, të gjithë anëtarët e maxhorancës në këtë komision, ju kemi bërë thirrje, madje edhe lutje, që të jeni korrektë me ligjin, të jeni korrektë me Kodin e Procedurës Penale, të jeni korrektë me Rregulloren e Kuvendit dhe ta çojmë në drejtimet e duhura këtë komision, ashtu siç e përcakton ligji, por ju prapë vazhdoni dhe abuzoni edhe me mikrofonin, edhe me kohën, edhe me procedurat, edhe me ligjin, edhe me Rregulloren, aq sa keni marrë përsipër të komentoni edhe Kodin e Procedurës Penale...

(Diskutime në sallë.)

Ruaj etikën! Ruaj etikën! Ruaj etikën!

Mos m'u drejton me "ti" dhe mos më thoni që, kur e komentoni edhe ti! Mos ma ndërprisni fjalën! Unë për procedurë e kam marrë dhe ma lejon Rregullorja.

Ju bëj me dije, zonja kryetare, aq sa njohuri kam unë, nuk ka të paditur në proces penale, ka të pandehur dhe me kaq kuptohet se sa njohuri juridike keni ju.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Ajazi, se dua ta kufizoj veten që të bëj komente për personin tuaj, në fakt, por nuk të lë. Çfarë të them? Nuk të lë. Zotëria duhet të na thotë këtu, a i është komunikuar ndonjë akuzë nga SPAK-u? A është i paditur zotëria, apo jo? Është inceneratori i Fierit sot skenë krimi dhe a është kryer atje një vepër penale, apo jo? Në qoftë se kjo është e vërteta, atëherë ministrja e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe sekretarja e Përgjithshme kanë gënjyer duke thënë që nuk ka asgjë me atë incenerator ose, përndryshe, zotëria të vijë të na japë këtu përgjigje!

Pastaj këto komentet për kontributin, njohurinë, eksperiencën e secilit, e kemi treguar secili me punën në parlament. Ti di aq sa di, unë di aq sa di. I lëmë qytetarët që t'i vlerësojnë dhe t'i gjykojnë.

Urdhëroni, zoti Bushati!

Helidon Bushati – Meqenëse zoti Muçaj ka ardhur dhe në shenjë demonstrative e shoh që nuk ka ndër mend të përgjigjet, ose kështu i ka marrë urdhrat, po jua them me sinqeritet që

jeni i vetmi që keni ardhur para këtij komisioni, që po e sheh e gjithë Shqipëria, pa asnjë letër. Jeni me të vërtetë i vetmi pa as edhe një letër, nuk keni asnjë letër para jush, me çfarëdolloj përmbajtjeje. Erdhën edhe anëtarët e një komisioni tjetër, paraqitën dokumentacion që ishin të thirrur apo kishin dëshmuar, e treguan me vepra. Zoti Muçaj, ka një gjë, ju qenkeni edhe administrator i një kompanie të madhe publike. Ju thatë se ju kanë thirrur me telefon. Mund të jetë procedurë pune, unë këtë nuk e vë në dyshim. Problemi është se ndodh shumë shpesh në institucionet publike, por edhe në SPAK dhe në çdo institucion, që mund t'ju thërrasin edhe për arsye, siç ka ndodhur edhe në këtë komision, që janë parashikuar orare të caktuara dhe njëra zgjat shumë kohë, tjetri mund ta ketë kaluar, domethënë ju nuk keni dokument që mund të tregoni se vërtet atë ditë, që ju kanë thirrur me telefon, edhe jeni pyetur apo çfarë ju kanë pyetur, sepse, zoti Muçaj, ka një problem të madh shumë, ju mund të jeni thirrur atje në cilësinë e anëtarit të komisionit, por edhe si administrator i Albpetrolit për t'ju pyetur nëse inceneratori i Fierit afekton marrëveshjet hidrokarbure që ju mbulonin dhe kjo nuk ka lidhje fare me objektin e veprimtarisë së këtij komisioni, prandaj unë ju sugjeroj shumë që ju të përgjigjeni për ato pyetje, që nuk ju kanë pyetur në SPAK. Mund të jenë edhe zotërinjtë e SPAK-ut duke parë, mund të hapen vizione të reja. Kështu që, ju lutem, mendoj ta rishikoni mendimin tuaj!

(Diskutime në sallë.)

Fadil Nasufi – Zonja kryetare, në qoftë se ne kemi mundësinë e të qenit në këtë komision dhe përdorim mikrofonin për të treguar se kush do të bëhet protagonist në kamerat që na ndjekin, e kemi krejt gabim. Ne duhet të merremi me procedurë ligjore. Dëshmitari është korrekt, ka ardhur këtu dhe deklaroi se është pjesë e hetimit në SPAK dhe ky standard duhet respektuar, në zbatim të Kodit të Procedurës Penale. Ne nuk mund t'i drejtojmë pyetje dhe as nuk mund të aludojmë që ne ushqejmë edhe SPAK-un, i cili na vëzhgon ne, për probleme të hetimit që mund të ketë për këtë punë që merremi ne këtu.

Për mendimin tim, duhet ta respektojmë këtë standard dhe të mos bëjmë sjellje të dëshmitarëve që komprometojnë hetimin, marrin penaltete shtesë dhe na implikojnë edhe ne në çështjet penale që janë kompetencë e tjetërkujt, nuk janë pjesa jonë.

Së dyti, edhe për zgjedhje mbahet qëndrim bllok, se ky ka qenë anëtar i komisionit të vlerësimit të koncesionit dhe nuk mund të flasë në emër të të gjithëve dhe nuk mund të jetë i diferencuar nga të tjerët për një pjesë që janë marrë këtu me këtë funksion që kanë pasur në këtë

procedurë, prandaj, përderisa është në SPAK, ju zbatoni Rregulloren, hidheni në votë dhe të vazhdojmë procedurën me kandidatin tjetër.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Urdhëroni, zoti Gështenja!

Lefter Gështenja – Faleminderit, kryetare!

Edhe një herë unë e përsëris, se sinqerisht nuk kuptoj se cila do të jetë puna e këtij komisioni, kur ne nuk na është vënë në dispozicion i gjithë materiali për këto tri procedura, e theksoj, i gjithë materiali.

Qoftë kolegët e maxhorancës, por edhe të opozitës, besoj se biem dakord që ne nuk kemi të gjithë dokumentacionin e këtyre procedurave. Ka mungesë të theksuar të dokumenteve, për të cilat ne duhet të hetojmë për qëllimin që është ngritur ky komision.

Vijmë te varianti i dytë, nuk lejohen me manovra, s'po e them më tutje, që dëshmitarët të deklarojnë, të dëshmojnë për atë çka dinë rreth këtyre tri procedurave.

Zonja kryetare, mjafton të ftojme stafin e Kuvendit të na bëjë me dije për kamerat që janë në korridor, se si instruktohen dëshmitarët që vijnë në këtë komision nga kolegët tanë, çfarë duhet të thonë, si duhet ta thonë, si duhet të përgjigjen, çfarë duhet të paraqesin këtu, a duhet të kenë shkresë apo jo, a duhet të thonë që janë në hetim apo jo etj. Mjafton të shohësh videot dhe kjo është, unë do të thosha, do t'ju ftoja, do të kërkoja zyrtarisht, ndoshta do të bëj edhe shkresë, t'u vihen në dispozicion dhe t'i bëhen të ditura publikut. Ky është ndryshimi. Nuk duhet të drejtojë gishtin askush as ndaj meje, as ndaj kolegëve të opozitës që ne jemi prokurorë, gjykatës. Jo.

Ju lutem, të dashur kolegë, të nderuar kolegë, edhe ju nuk jeni avokatë të këtyre inceneratorëve! Ju lutem, a doni t'i shkoni deri në fund hetimit?! Hajde t'i shkojmë! Por nuk mundet me këto manovra që dikush, komisionerët qenkan thirrur në SPAK për të dëshmuar për atë ç'ka kanë dijeni dhe ne nuk do t'i pyesim! Ne duhet t'i drejtojmë pyetje zotërisë dhe ai të përgjigjet për çfarë të dojë dhe si të dojë, por jo që të mos pyetet. Çfarë është kjo?! Jo të fikim kamerat se është person publik, ka familje (ishite para dy javësh biseda)! Do të pyetet, sepse është pjesë e dëshmisë; të dëshmojë! Secili nga dëshmitarët duhet të vijë të dëshmojë për atë që ai dëshiron të përgjigjet. Askush nga ne nuk e detyron të përgjigjet çfarë i themi ne. Ne i bëjmë pyetjen, ai të përgjigjet: “nuk përgjigjem për këtë pyetje”.

(Diskutime në sallë.)

Nga asnjëri nga ne nuk keni dëgjuar të artikulohet akuzë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja kryetare!

Më duket se të gjithë këtu po diskutojmë pa qenë të qartë se për çfarë po flasim, se besoj se kemi të gjithë të njëjtin qëllim, të mos dëmtojmë hetimin penal që është duke u zhvilluar apo që mund të fillojë.

Zotëria na tha nën betim se është thirrur në rolin e dëshmitarit apo të atij që ka dijani për një ngjarje të caktuar. Ajo që ne duhet t'i themi është: ne nuk ju detyrojmë ju që të rrini këtu me zor, ne nuk ju detyrojmë ju që t'u përgjigjeni pyetjeve që ne mund të bëjmë, por që ne t'ju bëjmë një pyetje, sepse prandaj ju kemi thirrur, ju mund ta dëgjoni, mund të deklaroni si të doni, ose mund edhe të mos rrini, por është e drejta juaj, jo e ligjit.

Përderisa keni ardhur, nuk ka asnjë arsye pse të mos i dëgjoni pyetjet e këtij komisioni, pastaj se si përgjigjeni, është e drejta juaj. Ne ju vëmë në dijeni dhe ju themi që çdolloj deklarimi që mund të bëni, mund t'ju rëndojë, ose mund të mos ju rëndojë, por atë e dini ju. Kjo është përgjegjësia juaj, mund të përgjigjeni si të dëshironi ju, se më duket se nuk po kuptohemi.

Jorida Tabaku – Atëherë, po filloj unë me pyetjet.

Sapo na informuat para një orë, në fakt, se ne vazhduam me procedurë, se keni qenë anëtar i komisionit si përfaqësues i bashkisë së Fierit. Në komisionin dy kanë qenë përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, dy të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe dy përfaqësues nga Bashkia e Fierit.

Zotëria ka qenë administrator, tashmë është në një pozicion tjetër.

Cili ishte roli juaj në komisionin e koncesionit?

Nuk kishit asnjë rol në komisionin e koncesionit?

Florian Muçaj – Edhe një herë, jua përsërita, çdo gjë në lidhje me këtë çështje, për të cilën unë kam dhënë dëshmi pranë SPAK-u, nuk do të kthej asnjë përgjigje në këtë komision. Kështu që ju mund të vazhdoni të bëni pyetjet tuaja, por nga unë nuk do të ketë më përgjigje.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Studimi i fizibilitetit, që është bërë si pjesë e ofertës së pakërkuar nga kompania e inceneratorit që unë e kam këtu, ka rënë sot poshtë. Ju e keni vlerësuar për studimin e fizibilitetit dhe keni dhënë një bonus.

Si e gjykoni që keni dhënë një bonus për një studim fizibiliteti që sot ka rënë poshtë dhe nuk është i zbatueshëm? Kompania është vlerësuar mbi atë studim fizibiliteti, që unë gjykoj se

është kontrata ndërmjet palëve, koncesionarit, shtetit, njëkohësit, është drafti mbi të cilin është bërë çdo gjë më pas. Ai është çelësi kryesor.

Kompania ka deklaruar se ka një plan biznesi (dhe ka marrë edhe pikë për këtë), në të cilin ka fondet e veta dhe kapitalet e veta, më pas kompania ka marrë dy kredi bankare për këtë çështje. Si e gjykoni faktin që kompania ka marrë dy kredi bankare dhe nuk ka pasur kapitalin e vet? Ju i keni dhënë pikë. Ka marrë 97 pikë kjo kompani për këtë koncesion. Si e gjykoni këtë fakt?

Kam këtu planvendosjen që është pjesë e studimit të fizibilitetit, që fillon me fshatin Plyk, vazhdon me fshatin Mbyet, pastaj përfundon në zonën Mbrostar – Urë – Mbrostar, zonë administrative.

Si e gjykoni faktin që kompania në studimin e fizibilitetit të bërë me fondet e saj ka deklaruar se kjo është zona e përshtatshme, më pas ka shkuar në dy zona të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, do të përfundoj unë, pastaj do të vazhdoni. Cili është roli i Bashkisë së Fierit, duke pasur parasysh që në përgjigjen, që ka sjellë zyra e administrimit të pasurive, që unë e kam këtu, prezente, jepen dhjetë opsione për tokë publike, ndërkohë që ju vendosni për të shkuar në një tokë private arë dhe e ktheni në një tokë industriale, duke e vlerësuar me dyfishin e çmimit. Kam këtu dhjetë opsionet që ka sjellë zyra e regjistrimit të pasurive.

Ju, si përfaqësues i bashkisë, keni pasur pikërisht rol për këtë. Cili është roli i bashkisë Fier dhe pse keni pranuar që të mos ketë një truall publik për këtë, por keni zgjedhur truallin pjesërisht privat dhe e keni dëmshpërblyer me një çmim dy herë më të lartë, sepse e keni kthyer nga një truall arë në një truall industrial? Si përfaqësues i bashkisë së Fierit, cili është roli juaj në këtë? Cili është roli i kryetarit të bashkisë, zotit Armando Subashi në këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Ja, të përfundoj.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit deklaroi këtu, në këtë komision, që nuk është kryer vlerësimi për ndikimin në mjedis, nuk ka pasur lejet përkatëse. Cili është roli juaj, si anëtar i komisionit të koncesionit, po njëkohësisht edhe i hartimit të kontratës më pas, për faktin që kompania nuk i ka pasur lejet. Kompania ka marrë një të drejtë koncesionare duke mos plotësuar kushtet e ligjit.

Në dosjen që ka sjellë zoti Armando Subashi, kam të gjitha shkresat dhe gjithë informacionin e zotit Subashi, në fakt deklarohet se nuk ka një gjendje mjedisore emergjence në bashkinë e Fierit, por i gjithë procesi ka nisur me një ofertë të pakërkuar të kompanisë për gjendjen e emergjencës mjedisore. Pse keni pranuar një ofertë të pakërkuar dhe keni nisur një proces koncesioni, kur nuk ka pasur gjendje të emergjencës mjedisore? Këtu kam shkresat e zotit Armando Subashi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lini ta përfundoj. Kam një grup pyetjesh.

Po, zoti Deliu.

Ju lutem, zoti Deliu, do të përfundoj unë grupin e pyetjeve, e pastaj do t'jua jap fjalën me shumë kënaqësi.

Denis Deliu – Vetëm një ndërhyrje të vogël kam.

Jorida Tabaku – Po.

Denis Deliu – Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po të ma kishe fjalën dhënë më përpara do të ishte më mirë. Në respekt...

Jorida Tabaku – Jam e sigurtë se do të iluminohem, siç i iluminohem sa herë që flet zoti Ajazi, i cili ka dijeni për ligjin, sepse ka edhe vëllain prokuror.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Denis Deliu – Kryetare, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryetare, ju lutem, kërkoj vëmendjen tuaj!

Në respekt të punës së këtij komisioni, në respektin tuaj dhe të të gjithë kolegëve, mos na bëni të ndjehemi keq në momentin kur ju drejtoni pyetje. Pra, ai është i vendosur, sepse ka marrë udhëzime nga Prokuroria Speciale, që të mos përgjigjet.

Jorida Tabaku – Jo.

Denis Deliu – Atëherë, unë mendoj se është e panevojshme që ne t'i bëjmë pyetje këtij dëshmitari. Unë për vete, së bashku me kolegët e mi, ndjehemi keq kur ju i bëni pyetje dhe ai nuk përgjigjet. Ky parlament ka votuar reformën në drejtësi me 140 vota dhe ne besojmë te Prokuroria Speciale e te Gjykata Speciale. Le të bëjnë punën e tyre. Sa u takon njerëzve që janë thirrur atje, unë mendoj se nuk duhet të vazhdojmë me marrjen në pyetje.

Ju faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Deliu, unë e thashë edhe një herë: më keq se unë nuk ndjehet askush këtu, por askush nuk na intimidon dhe nuk na pengon të zbatojmë ligjin. Secili këtu bën një interpretim të ligjit personal. Unë nuk jam juriste. Asnjëri nga ne nuk është jurist. Juriste është zonja Çupi. Juristët që i kemi konsultuar thonë se zotërisë nuk i është komunikuar një akuzë. Zotëria tha: kam bërë një deklaratë në SPAK.

Siç e citoj edhe zoti Xhafaj, në momentin kur mund të kishte një akuzë, sipas nenit 156 të Kodit të Procedurës Penale, zotëria nuk mund të fliste këtu, qeveria shqiptare nuk mund të vazhdonte t'i bënte pagesat ose do t'i vendoste në sekuestro. Unë kam këtu një dosje të tërë, që ekspozon kryetarin e bashkisë Fier. Kam një dosje të tërë, e cila ekspozon anëtarët e koncesionit për një procedurë korruptive. Unë kam një dosje të tërë, ku kompania thotë se kam bërë topografinë e zonës, duke thënë se mund të ndërtohet, ndërsa më vonë, pas dy muajsh, kompania thotë se në këtë zonë nuk mund të ndërtohet. Kemi dhënë një procedurë koncesionare, bazuar mbi një studim fizibiliteti, që nuk ka qenë studim fizibiliteti. Është mbledhur Këshilli i Ministrave dhe ka bërë një VKM mbi gënjeshtat që ka miratuar një komision i koncesionit dhe mbi atë që i ka çuar kryetari i bashkisë së Fierit. Po zbatohet një kontratë koncesionare, për të cilën janë harxhuar 23 milionë euro deri tani, për një procedurë korruptive.

Në qoftë ju më thoni se procedura është korruptive, atëherë ndaloni pagesat. Përndryshe, më lejoni të vazhdoj me pyetjet, sepse unë dua të ekspozoj për qytetarët implikimin e komisionit të koncesionit në dhënien e këtij koncesioni, po njëkohësisht edhe të kryetarit të bashkisë së Fierit për këtë koncesion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam shkresat.

Zoti Pëllumbi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më ka dhënë mundësinë maxhoranca, që ta kem këtë komision hetimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Kryetare, sigurisht që ne këtu, me aq njohuri sa kemi, mbështetur edhe në konsulencën e vyer të zonjës Çupi, e cila për momentin është e vetmja juriste në këtë komision, ne gjykojmë që mund t'i drejtonim disa pyetje dëshmitarit, pyetje që lidhen ngushtësisht me detyrën që ai ka mbajtur në atë kohë.

Dëshmitari ka zgjedhur të mos përgjigjet. Tashti, ne do të kemi plot raste të tjera. Për ato që ju mendoni se mund të implikojnë kryetarin e bashkisë së Fierit, ne kryetarin e bashkisë së Fierit e kemi të thirrur si dëshmitar. Kësisoj, nëse keni ndonjë bllok pyetjesh, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me funksionin që ka pasur zotëria, edhe pse nuk do të dëgjojmë përgjigjet, që është një gjë tjetër, ne kemi katër muaj që merremi me të gjithë dosjen e Fierit. S'kemi lënë gjë pa thënë për Fierin, administratorin e kishim këtu dhe gjithë ata njerëz të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta dëgjojmë edhe atë. Ne e dimë se me kërkesën tuaj, me dokumentet tuaja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Helidon!

Me kërkesën tuaj, me dokumentet tuaja, organi i akuzës, organi i ri SPAK, i specializuar në këtë çështje, është duke zhvilluar një hetim. Tashti, ne po bëjmë punën tonë, por e kemi thënë që ditën e parë, se askush nga ne nuk dëshiron që, me dashje apo pa dashje, të prishë një proces, i cili është më i rëndësishëm se ky procesi ynë këtu, sepse në fund fare ne do të bëjmë një raport, përmes të cilit do t'i rekomandojmë Kuvendit të Shqipërisë që të bëjë disa përmirësime në legjislacion, në rast se do të gjejmë boshllëqe të caktuara në këto procedura. Ndërkohë, organi i akuzës, është organ i specializuar për të bërë punën e vet.

Sigurisht, kjo është e përbashkëta e të gjithëve ne. Zotëria ka ardhur këtu, na ka respektuar. Është në cilësinë e personit të thirrur, në cilësinë e dëshmitarit, ka bërë betimin, e ka pranuar këtë gjë, nuk dëshiron të përgjigjet më. Unë e kuptoj që në rast se ju keni dokumente për të ekspozuar, që s'i paski ekspozuar akoma në këto katër muaj, në raport me Fierin, por e keni edhe traditën që më pas të dilni në televizion.

Kësisoj, nëse kemi ndonjë gjë specifike për zotërinë, le të vazhdojmë ta pyesim. Por që t'i paraqesim zotërisë çdo gjë që kemi për Fierin, kjo nuk më duket rentabël për komisionin, por nuk më duket as veprimi i duhur.

Jorida Tabaku – Po, zoti Bushati!

Helidon Bushati – Atëherë, zoti Muçaj ka ardhur këtu, por nuk ka dhënë asnjë informacion se për çfarë është thirrur. Mund të jetë thirrur për problemet e shumta që ka Albpetroli dhe s'kanë lidhje fare me objektin tonë të veprimtarisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Kësisoj, zotëria duhet të tregojë se për çfarë është thirrur nga SPAK-u, si dhe a ka zotëria udhëzime speciale nga Prokuroria Speciale? Sepse pastaj i takon të themi se qenkeni special.

Florian Muçaj – Atëherë, në fjalën time unë thashë se jam thirrur si anëtar i Komisionit të Koncesionit të Fierit. Biseda është e regjistruar, mund t’i ktheheni dhe ta dëgjoni.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Atëherë, pa pasur gjë me zotërinë, zoti Pëllumbi, ai nuk na ka respektuar ne, por ka respektuar veten...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, në raport me ligjin. Se tashti po e bëjmë kështu: shyqyr që erdhe, faleminderit që erdhe; nuk do, ik, faleminderit edhe për këtë!

Ai e ka të qartë statusin e vet në lidhje me një institucion shumë të rëndësishëm, që as ne nuk duam të cenohet fare në veprimtarinë e tij. Aq më tepër, ju e thatë se ky është një fakt i paraditur dhe puna e komisionit është ndërtuar duke e ditur këtë fakt, jo duke mos e ditur këtë fakt.

Ndërkohë, ju na ofroni nxjerrjen e dokumentacionit. Në disa mbledhje ne kemi paraqitur shqetësimin tonë për mosdërgimin e informacioneve të kërkuara, mosvënien në dispozicion të dokumentacioneve. Madje, po t’i lexoni ato shkresa, në disa rreshta kemi marrë edhe përgjigje cinike në lidhje me dokumentet që kemi kërkuar të na viheshin në dispozicion, me idenë se jemi privatë. I dini shumë mirë ju këto, duke nisur nga banka e duke vazhduar me shoqëritë private, që u kemi kërkuar informacion.

Me dokumentacion ne pengohemi, sepse nuk lejohet të nxirren të dhëna konfidenciale, ndërkohe që në një komision tjetër hetimor ishin nxjerrë të dhënat konfidenciale. Privati nuk i ofron, sepse janë të dhëna konfidenciale.

Tani dalim tek pjesa, që është thirrur dëshmitar. Po mirë, është shumë e thjeshtë: për gjëra që ai është pyetur, nuk mund të japë përgjigje dubël, sepse mund të cenohet edhe pozita e tij, edhe pozita e organit që heton, por pyetjeve të tjera, që nuk janë objekt dëshmie, ai mund t’u japë përgjigje. Është shumë e thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po kanë lidhje, sepse ne të dy një lidhje kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, ne nuk po rrahim ujë në havan, sepse të njëjtën çështje kemi: shkeljen e ligjit. Sepse ne, këtu në parlament, shkeljen e ligjit duam të evidentojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord pra, dakord! Ja, ta mbaroj! Duke mos dashur as ta mbroj, as ta intimidoj, unë personalisht, po të isha në pozitën e zotërisë, do të përgjigjesha për të gjitha pyetjet dhe do të jepja të njëjtat përgjigje, pa thënë fare se ku e kam dhënë këtë përgjigje. Unë e jap edhe në familje një përgjigje për një pyetje, e jap edhe në shoqëri për sqarim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, e kam fjalën: jap të njëjtën përgjigje, nuk gënjej. E kur unë nuk gënjej, nuk them fare se kjo intimidon, rregullon apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, pa cenuar, sepse e tha Dhurata shumë bukur: ju po merrni pozicionin sikur jeni pro SPAK, ndërsa ne sikur jemi për ta vënë SPAK-un në pozitë të vështirë. Në mënyrë absolute mos na vini përballë kësaj situatë. Ne kërkojmë të zbatohet ligji i komisioneve hetimore parlamentare. Është shumë e thjeshtë: është thirrur dëshmitar dhe nuk është nën hetim. Kaq. Ligji e thotë: nëse është nën hetim. Nëse është në hetim, dakord, kur personat kanë qenë nën hetim, nuk i kemi pyetur. Tani, është thirrur dëshmitar, është dëshmitar. Ju e kuptoni se ne jemi persona që marrim dijeni. Nesër mund të thirremi edhe ne si dëshmitarë. Çfarë te keqe ka? Ndhimojmë drejtësinë. Edhe ai po ndihmon drejtësinë në këtë rast. Nuk është person nën hetim ai, nuk intimidohet fare. Ai ndihmon drejtësinë, ndihmon zbardhjen e ligjit. Pozita e tij është shumë komode. Pse qenka kaq e vështirë si dëshmitar? Nuk është nën hetim.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, në Rregulloren që ne kemi miratuar në mënyrë unanime, në nenin 18 “Organizimi i seancave dëgjimore për të dëshmuar”, pika 3, dëshmitari informohet në mënyrë të posaçme për të drejtën për të refuzuar dëshminë, në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 158 të Kodit të Procedurës Penale. Dëshmia merret pas kryerjes së betimit nga personi i thirrur. Në fakt, ne kemi përdorur një standard, që dëshmitarëve të cilët ishin pjesë e dëshmisë në këtë komision, u kemi marrë një deklaratë...

Zonja kryetare, po regjistrohem? Po.

I kemi marrë një dëshmi dhe unë ju ftoj juve, si kryetare, që ne t'i marrim dëshmitarit një dëshmi, që ai nuk dëshiron të dëshmojë, sikundër operuam edhe me dëshmitarët e tjerë, të cilët ishin pjesë e Komisionit të Prokurimit të Inceneratorit të Elbasanit.

Dhurata Çupi – A mundem? Në vijim të asaj që tha zonja Dhima.

I nderuar zoti zyrtar, se s'po të them dëshmitar, meqë nuk po e pranon këtë status, neni 156 i Kodit të Procedurës Penale, të cilin na e nje ligji “Për komisionet hetimore” që t'i referohemi, është papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit. Ju pretendoni që plotësoni kushtet e pikës ‘b’ të nenit 156, ku thuhet: “Nuk mund të pyeten si dëshmitarë të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur, kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit të akuzës, çështjes ose dënimit, duke përfshirë edhe rastet e gjyqimit me marrëveshje dhe të urdhrimit penal të dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Theksojmë se keni bërë një betim. Nëse ju deklaroni këtu me shkrim, që plotësoni kushtet e nenit 156, pra papajtueshmërinë me detyrën e dëshmitarit, unë besoj se askush nuk merr përsipër të tejkalojë këtë kompetencë.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Tani, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, siç e tha secili prej anëtarëve këtu, nuk ka përgjegjësi kolektive, por përgjegjësi individuale, një përgjegjësi individuale, e cila është reflektuar edhe në vendime individuale të kryetarit të bashkisë. Unë e di se zonja Felaj tha: ne firmosim të gjithë dhe s'mbajmë asnjëri përgjegjësi, sepse përgjegjësia është kolegjiale.

E kuptoj çfarë doni të bëni.

Ndërkohë, në këtë rast, te Komisioni i Koncesionit, por edhe të hartimit të ofertave, është individuale, sepse zotëria, si përfaqësues i bashkisë, më datë 11. 11. 2016 ka dorëzuar një relacion, përmes të cilit, bazuar në informacionin e ZRPP-së, i ka sugjeruar kryetarit të bashkisë dhjetë vendndodhje. Në këto dhjetë vendndodhje, vetëm në njërin prej tyre shkruhet: privat. Është zgjedhur pikërisht kjo vendndodhja privat për inceneratorin e Fierit. Sigurisht, kjo është një shkelje shumë e rëndë, që lidhet me kryetarin e bashkisë së Fierit. Nga ana tjetër, ne kemi një sërë shkeljesh të zotërisë si individ, pjesë e komisionit të koncesionit dhe të hartimit të kontratës. Për shembull...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër! Ne gjykojmë se është një shkelje shumë e rëndë e kësaj procedure. Për shembull, po marr një rast shumë specifik: zotëria, si pjesë e Komisionit të Koncesionit, i ka dhënë një vlerësim të caktuar kompanisë koncesionare, që ka fituar koncesionin, sepse kishte kompaninë Energy 2 S.r.l pjesë të konsorciumit, dhe ka gjykuar se kjo ka eksperiencën për të bërë inceneratorin. Nga ana tjetër, kompania e ka shitur pas një jave, pasi është marrë kontrata koncesionare te Ndërtim Montim Patos.

Kishim këtu zotin Arenc Myrtezani, i cili tha: jo, asnjëri nga ne nuk merrte vesh nga incenerimi e nga mbetjet. Ndërtim-Montim Patosi nuk merrte vesh. Atëherë si ia keni dhënë një kontratë koncesionare ju, si anëtar i Komisionit të Koncesionit, dikujt që nuk i plotësonte kriteret? Kjo është një përgjegjësi individuale, përveç përgjegjësisë individuale të kryetarit të bashkisë, që ka të bëjë me vendin.

Unë kam këtu një sërë dokumentesh, të cilat lidhen me pozicionin tuaj individual, me faktin që është miratuar një studim fizibiliteti i papërshtatshëm, me faktin që është miratuar një plan biznesi, i cili nuk është zbatuar e që është shkelur. Kam këtu shkresa pafund për procedura shpronësimi, që duheshin bërë ndryshe dhe janë bërë ndryshe, gjë për të cilën mbahet përgjegjës jo vetëm si institucion, por njëkohësisht edhe si pjesë e anëtarëve të Komisionit të Koncesionit. Kam kontratën, që është hartuar në shkelje, ndryshe nga ajo që ka thënë Avokati i Popullit. Kemi një koncesion, që faktikisht sot, siç e pranoi edhe administratori, nuk mban mend asgjë se si janë shpenzuar lekët, si janë dhënë fondet. Unë kam një dosje të tërë këtu, një pjesë të së cilës e kemi çuar në SPAK, një pjesë tjetër do ta çojmë në SPAK pas përfundimit të punës së këtij komisioni, që sipas gjykimit tonë, sigurisht sipas gjykimit tonë, provon se kompania koncesionare që e fitoi nuk kishte asnjë dokumentacion ligjor, nuk kishte asnjë dokumentacion që provonte eksperiencën, nuk kishte dokumentacion që provonte mbajtjen e licencave dhe lejeve. Ka qenë edhe pa leje, edhe pa licenca kjo kompani, që ka bërë një sigurim kontrate, në rast të mospërputhjes me kushtet e kontratës.

Pra, ka një sërë elementësh në shkelje. Ka marrë kredi bankare kompania, ka vendosur garanci po kontratën koncesionare. Pra, këtu është çështje zbatimi. Ne e diskutuam me autoritetin kontraktues dhe me përfaqësuesin e koncesionarit, por është edhe çështja e dhënies së koncesionit, gjë për të cilën ju si individ, sipas gjykimi tonë, keni përgjegjësi, përveç përgjegjësisë individuale, që ka edhe kryetari i bashkisë.

Unë jam dakord me të gjithë kolegët, që sigurisht duhet të bazohemi mbi ligjin, dhe ne veç mbi ligjin jemi bazuar. Në qoftë se ju i konfirmoni këtij komisioni, që jeni në kushtet e nenit 156, që citoi zoti Etjen Xhafaj, siç na deklaruan kolegë të tjerë përpara jush, në një komision tjetër koncesioni, ne i ndalojmë përgjigjet e pyetjeve. Por në qoftë se nuk jeni në kushtet e atij neni, unë kam gjithë të drejtën që ta vazhdoj. Nuk kam asnjë mbivendosje me SPAK-un, sepse parlamenti është i pavarur. Kemi gjithë të drejtën që na ka dhënë ligji për ta vazhduar punën tonë.

Po, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Kryetare, unë në fakt nuk jam në dijeni, ndaj realisht doja t'ju pyesja: të gjitha këto dokumente, i keni dorëzuar në organin e akuzës, në padinë që keni bërë ju, si forcë politike, në lidhje me këtë që e konsideroni megaaferë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht po ju pyes: a i keni dorëzuar apo jo? Kjo sepse gjykoj...

Jorida Tabaku – Meqenëse më pyetët, a mund të përgjigjem?

Arben Pëllumbi – Ja, ta mbaroj mendimin!

Jorida Tabaku – Ah, kujtova se mbaruat.

Arben Pëllumbi – Sepse gjykoj që në rast se të gjitha këto dokument ju i keni dorëzuar në organin e akuzës, i takon organit të akuzës të veprojë në mënyrë profesionale për të thënë nëse të gjitha këto që ju përmendët, përbëjnë apo jo vepër penale, kanë apo jo shkelje të ligjit dhe të procedurave.

Ju këtu deklaroni të mirëqenë çdo letër që keni përpara, pra e merrni për të mirëqenë: “Kjo ka ndodhur, është bërë kështu; kjo ka ndodhur, është bërë ashtu”. Ne kemi 4 muaj që këto gjëra diskutojmë me njëri-tjetrin. Ju keni argumentet tuaja, ne kemi tonat. Ju keni bërë parashtrimin tuaj, ne kemi bërë tonin për të 3 këto vepra. Të mos i fillojmë përsëri nga e para. Pyetjet konkrete, që kishit për zotërinë në rolin që ka zhvilluar, urdhëroni, mbarojini. Zotëria e shprehu, që ai qëndron këtu, por nuk përgjigjet. Zonja Dhima tha: “E drejta e tij për të refuzuar dëshminë”.

Jorida Tabaku – Meqenëse zoti Pëllumbi më pyeti, në padinë dhe në kallëzimin penal që bëri Partia Demokratike për çështjen e inceneratorit të Fierit ne ngritëm disa dyshime si pjesë e punës së komisionit hetimor. Zoti Armando Subashi na i ka konfirmuar këto dyshime, na ka sjellë të gjitha dokumentet. Jemi në kushte të reja tani, sepse kemi marrë një informacion si

anëtarë të këtij komisioni. Kur të përfundojmë punën, do t'i dërgojmë dhe këto shkresa në SPAK, ndërkohë ato që ngritëm si shqetësime dhe akuza këtu e një vit e gjysmë më parë, sot me këto dokumente rezultojnë të vërteta, si për anëtarët individualë të komisionit hetimor, ashtu edhe për zotin Armando Subashi, individin, Armando Subashi me përgjegjësi individuale.

Antoneta Dhima – Sipas opinionit tuaj.

Jorida Tabaku – Zonja Dhima, unë nuk ju ndërpreva.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, ne gjykojmë.

Zoti Pëllumbi, nuk kam për t'ju hequr ndonjëherë mikrofonin!

Të lutem!

Arben Pëllumbi – Për të disatën herë ju thoni: “Sipas nesh; sipas mendimit tonë”, ju rezulton e vërtetë, nuk rezulton e vërtetë, se çfarë rezulton e vërtetë, do ta thotë organi i akuzës dhe në fund do ta thotë gjykata, jo ju.

Jorida Tabaku – Ne gjykojmë se dokumentet, që na kanë sjellë, konfirmojnë akuzat tona. Organi i akuzës, sigurisht, që do të bëjë akuzat konkrete ndaj personave të përfshirë në këtë çështje.

Zoti Pëllumbi, nuk kam për t'ju hequr ndonjëherë mikrofonin, por ju lutem, mos më ndërprisni! Është e disata herë. Kur je te ky vendi këtu, të kap edhe sindroma e keqe, mua të parës. Atëherë, unë gjykoj që ky komision hetimor ka boll prova dhe fakte që unë do t'i bëj publike sot në një konferencë për shtyp, pasi ne të përfundojmë dëshmitë.

Zotëria na konfirmoi se diçka të mirë e ka bërë Partia Demokratike, zotërinë e kanë marrë në pyetje për këtë çështje. Zoti Armando Subashi është marrë në pyetje për këtë çështje. Dokumentacionin që kam shtesë, do ta dërgoj në SPAK, do t'ia paraqesim për këtë çështje që, në gjykimin tonë, është një vepër penale. Sigurisht që nuk është në dorën tonë t'i çojmë njerëzit para drejtësisë, por informacionin, akuzat para drejtësisë do të vazhdojmë t'i çojmë.

Unë gjykoj që në rastin e inceneratorit të Fierit ne kemi shkelje shumë të rënda në dhënien e procedurës me koncesion, shkelje shumë të rënda në çështjen e zgjedhjes së pronës dhe shkelje shumë të rënda në zbatimin e kontratës, në të 3 rastet, në të 3 fushat kemi prova dhe fakte konkrete.

Nuk e di nëse ndonjë nga kolegët do të thotë diçka tjetër, do t'i jap zotit Muçaj mundësinë për të na firmosur një deklaratë, siç sugjeroi zonja Çupi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Xhafaj na lexoi nenin 156.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

T’i mund të lexosh çfarë të duash, por unë, bazuar mbi atë që më sugjerove...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë po themi edhe ne. Po diskutojmë diçka tjetër! Ju lutem, këtë po themi të gjitha palët. Zoti Pëllumbi, një sekondë!

Zotëria të na firmosë një deklaratë dhe të na thotë : “Unë jam në kushtet e neneve 156, 157, refuzoj të përgjigjem”, siç na e bëri ai i koncesionit të Elbasanit.

Mirë, keq, unë i dua ato letra.

Antoneta Dhima – Do ta japim kënaqësinë...

Do ta kesh pjesë të dosjeve që të shtohet volumi i dosjeve.

Jorida Tabaku – Fatkeqësisht nuk kam asnjë vëlla prokuror dhe nuk i di këto gjëra.

Bëjmë 5 minuta pushim.

Për procedurë, ndërkohë që sekretaria bën shkresën për zotërinë, zonja Dhima ka kërkuar fjalën për procedurë.

Antoneta Dhima – Zoti Gështenja për të disatën herë ka thënë pranë këtij komisioni që ne presim dokumente, informacione nga institucionet. Ne kemi mjaftueshëm materiale, informacione nga institucionet, nga individët, të cilët janë njoftuar me shkresa zyrtare, si nga ana jonë dhe nga ana juaj dhe data 25 është data përfundimtare e përfundimit të këtij komisioni. Kemi qenë disponibël nga dita e parë deri sot që ne t’i vazhdojmë të gjithë procedurat sipas vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.81/2021. Jemi këtu që brenda kësaj periudhe të përfundojmë procesin, të miratojmë raportin, si në komision, ashtu edhe në seancën plenare.

Së dyti, në vijim të punës së këtij komisioni, unë si sekretare e tij, duhet t’i sigloj të gjitha shkresat për informacione që u jepen si institucioneve, ashtu edhe individëve. Pak më parë nga kryetarja e këtij komisioni u kërkua një informacion nga sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, zoti Ëngjëll Agaçi, në lidhje me procesverbalet dhe materialet shoqëruese të mbledhjeve të muajit dhjetor të vitit 2014, të Këshillit të Ministrave, procesverbalet dhe materialet shoqëruese të muajit tetor dhe nëntor të vitit 2016 të Këshillit të Ministrave, procesverbalet dhe materialet shoqëruese të mbledhjeve të muajit gusht dhe shtator të vitit 2017 të Këshillit të Ministrave.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj, zonja kryetare, se, në zbatim të ligjit nr.9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neni 17 “Besueshmëria dhe solidarësia”, pika 2 “Vlerësime, debatet dhe raportet mbeten konfidenciale”. Prandaj unë nuk mund ta firmos këtë shkresë, pasi jam në shkelje të ligjit nr.9000/2003.

Jorida Tabaku – E ke gabim!

Zonja Neta, këto gjërat e solidaritetit lërja Partisë Socialiste, tani zbatojmë ligjin, siç është për t’u zbatuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lër ta përfundoj, ju lutem!

Antoneta Dhima – Unë nuk jam as motra, as shoqja jote. Unë jam zonja Antoneta Dhima, deputete e Kuvendit të Shqipërisë, deputete e qarkut të Fierit.

Jorida Tabaku – Zonja Dhima, me gjithë respektin maksimal ndaj jush, ligji nuk të jep asnjë të drejtë që t’i ndalosh shkresat e mia.

Ke të drejtë vetëm t’i kalosh. Nuk ke asnjë të drejtë të vlerësosh dhe të gjykosh. Unë njoftoj komisionin dhe ju përcilleni. Nuk e di që jeni bërë sekretare e Përgjithshme e Kryeministrit, nuk e di që e kanë hequr zotin Agaçi. Çoja zotit Agaçi shkresën, në momentin që zoti Agaçi gjykon që nuk përgjigjet, atëherë nuk përgjigjet dhe na e sjell ai me shkresë. Nuk e gjykoni dhe nuk e interpretoni dot ju kërkesën time.

Së dyti, mbledhjet e Këshillit të Ministrave janë rekord publik. Kanë qenë publike deri në vitin 2013 dhe janë në interesin publik. Ky komision ka të drejtë që t’i marrë ato. Nëse zoti Agaçi nuk do që t’i sjellë diskutimet e tjera, që bëni nëpër mbledhje, takime, kur thërret Rama në zyrë dhe i thotë: “Firmose”, thërret tjetrin në zyrë dhe i thotë: “ Firmose”, nuk më duhen. Këto janë ato gjërat e diskutimeve.

Antoneta Dhima – Zonja kryetare...

Jorida Tabaku – Jo, nuk kam përfunduar.

Ndërkohë që çështjet e procesverbaleve janë rekorde zyrtare të mbledhjeve, duhej të ishin publike, siç është publike çdo mbledhje tjetër.

Antoneta Dhima – Zonja Tabaku...

Jorida Tabaku – Ju lutem!

Nuk ke të drejtë të gjykosh fare. Të detyron ligji që ta përcjellësh. Lëre zotin Agaçi të më përgjigjet.

Antoneta Dhima – Zonja Tabaku, mbledhjet kanë qenë publike edhe për 21 janarin. Nëse ju atëherë dhe Kryeministri, zoti Sali Berisha, e ka dhënë këtë informacion për institucionet....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, unë ju referova ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Juve, personalisht, si kryetare e këtij komisioni mund t’i drejtoheni sekretarit të Përgjithshëm që ta merrni këtë informacion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jorida Tabaku – Rifillojmë mbledhjen e komisionit hetimor.

Ne kishim thirrur për të dëshmuar zonjën Valbona Ballgjini, e cila nuk është këtu për arsyet e saj. Do të na njoftojë për një orar tjetër, pasi të koordinojmë me sekretarinë e komisionit.

Ndërkohë që i kishim dërguar një konfirmim për një takim të dytë zonjës Ariola Kodra. Zonja Ariola Kodra nuk e ka marrë akoma në dorëzim konfirmimin e dytë. Ne do të lëmë 48 orë, siç na e kërkon ligji, ditën e hënë në mëngjes do t’u kërkoj anëtarëve të komisionit që të vijmë këtu në orën 10:00 për zonjën Ariola Kodra. Ditën e hënë, nëse zonja Kodra nuk vjen, do t’u kërkojmë shërbimeve të Policisë së Shtetit, do të zbatojmë ligjin.

Ndërkohë që ishim këtu në komision, kanë ardhur lajme shumë të mira nga SPAK-u, që disa nga personat, që ne po diskutojmë dhe debatojmë gjatë këtu, janë duke u marrë në pyetje nga SPAK-u. Nuk besoj se...

Antoneta Dhima – Këto thuaji te konferenca për shtyp.

Jorida Tabaku – Po!

Zonja Dhima, jua jap fjalën pas meje.

Nuk ka pasur komision tjetër hetimor kaq efektiv sa ky, sa përmendet emri këtu, shkon në SPAK direkt. Besoj se me punën tonë, aq e vogël, me aq pak që ndoshta kemi bërë, se nuk jemi të gjithë kaq heronj të mëdhenj sa na duket vetja, diçka kemi arritur, kemi vendosur përgjegjësinë, peshën politike, por edhe peshën e ligjit të SPAK-u për të vepruar. Faktet që po paraqiten këtu kanë bërë që kushdo të dëgjojë se çfarë ka ndodhur me aferën e inceneratorëve. Me përgjegjësi të plotë e them: në 80 % të rasteve të dëshmitarëve që ne kemi thirrur, në 80 % të rasteve kanë përgjegjësi për aferën e inceneratorëve.

Pa dashur t’i lodhim kolegët, sa ka qenë një ditë e gjatë, zonja Dhima nuk e nisi shkresën për sekretarin e Përgjithshëm të Kryeministrit, por unë do ta nis atë si kryetare e komisionit.

Më vjen keq që nuk biem dakord, që ta zbatoni ju ligjin, sepse unë e di se jam në anën e ligjit. U kërkoi anëtarëve të komisionit që ditën e hënë, në orën 10:00, të rimblidhemi për zonjën Ariola Kodra dhe të presim 48-orëshin për njoftimin, sepse ajo nuk e ka marrë ende njoftimin për mbledhjen e sotme. E konsiderojmë këtë njoftimin e tretë për zonjën Kodra, më pas do të zbatojmë ligjin për shoqërimin e saj.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, ne duhet t'u qëndronim larg deklarimeve politike në këtë komision, por nuk i shpëtojmë dot kësaj gjëje. Meqenëse mbyllja e komisionit bëhet si konferencë shtypi, atëherë po e bëj edhe unë pjesën time të deklaramit publik.

Më vjen shumë mirë që një përpjekje titanike e maxhorancës dhe e Partisë Socialiste, në veçanti për formësimin e konceptit të reformës dhe formësimin e të gjitha organeve të reja të drejtësisë, sot po pranohet publikisht nga të gjithë se ato janë organe të pavarura, organe të cilat veprojnë në bazë të ligjit, në bazë të të drejtës që ato kanë të miratuara nga ky Kuvend, me mbështetjen e fortë dhe të drejtpërdrejtë të maxhorancës socialiste. Këto janë organe të Republikës së Shqipërisë.

Më vjen shumë mirë që edhe për çështje të tillë, ne sot kemi njerëz të ndaluar, të arrestuar. E nxis t'u shkojmë deri në fund të kësaj çështjeve larg politizimit dhe gjetjen e së vërtetës.

Jorida Tabaku – Nuk do të bëja asnjë koment pas fjalës së zotit Pëllumbi.

Askush nga ne, asnjë koment pas fjalës së zotit Pëllumbi. Ju lutem, unë do të dal në konferencë për shtyp dhe do t'i kthej përgjigje edhe zotit Pëllumbi.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA